

SHPJEGIMI I LIBRIT
MËSIMETË RËNDËISHME
PËR POPULLIN E THJESHTË

Dijetari dhe imami Abdulaziz bin Abdullah bin Baz
(Allahu e mëshiroftë dhe e strehoftë në xhenetet e Tij të gjëra!)

Shpjegoi:
Shejh Hejthem bin Muhamed Xhemil Ferhan
(Allahu e ruajttë!)

Titulli i librit në arabisht:
“**Sherh metn Ed-Durus El-Muhimmeh Liamme El-Ummeh**”

Titulli në shqip:
“**Shpjegimi i tekstit: Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë**”

Autori:
Shejh Abdulaziz bin Abdullah Bin Baz
(Allahu e mëshiroftë!)

Shpjegoi:
Shejh Hejthem bin Muhamed Xhemil Ferhan
(Allahu e ruajttë!)

Përktheu:
Unejs SHEME

Redaktimi:
Albiona Olluri

<http://attasseel-alelmi.com>

Shpjegimi i parathënies së autorit

Shejhu dhe imami Abdulaziz bin Abdullah bin Baz (Allahu e mëshiroftë!) thotë: Falënderimet i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve, kurse ardhmëria (përfundimi i mirë) është për të devotshmit. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Profetin tonë Muhamedin, mbi familjen e tij dhe gjithë shokët e tij!

E në vazhdim.

Këto janë disa fjalë përmbledhëse në lidhje me sqarimin e disa obligimeve që duhet t'i njohë masa e gjerë rreth fesë Islame. E kam titulluar “**Mësime të rëndësishme për njerëzit e thjeshtë**”. Lus Allahun që t’u bëjë dobi muslimanëve me këtë dhe ta pranojë atë prej meje! Me të vërtetë Ai është Bujar i madh.

Abdulaziz bin Abdullah bin Baz

Përse ta mësojmë librin “Mësime të rëndësishme”?

Këto mësime, siç i ka quajtur dhe autori, janë të rëndësishme dhe dijetarët kanë këshilluar për mësimin e tyre.

Nëse dikush thotë: Po, ato janë të rëndësishme, porse janë për masën e gjerë, ndërsa unë jam nxënës dije dhe niveli im është më i lartë sesa niveli i masës së gjerë.

Përgjigje: E pyesim atë rreth mësimeve që përmban ky libër. Nëse ai nuk i di/njeh, atëherë njerëzit e thjeshtë janë më të mirë sesa ai. Prandaj, kërkohet nga nxënësi i dijes që të jetë i përlur (i thjeshtë), të mos bëhet arrogant ndaj dijes dhe dijetarëve dhe të ecën në rrugën e dijetarëve edukues. Në “Sahihun” e Buhariut përcillet se Muxhahidi ka thënë: “*Nuk ka për ta mësuar diturinë ai që ka turp (të pyesë) dhe mendjemadhi.*”

Çfarë përmban ky libër?

1. Rrugën e të parëve tanë të mirë me Kuranin, në leximin e tij, memorizimin, meditimin dhe punën me të.
2. Sqarimin e Islamit, besimit, ihsanit, teuhidit dhe llojet e shirkut.
3. Sqarimin e namazit.
4. Sqarimin e abdesit.
5. Zbukurimin me moralet dhe edukatën islame.
6. Paralajmërimin nga shirku dhe llojet e mëkateve.
7. Përgatitjen të vdekurit, faljen e namazit të xhenazes dhe varrosjen e tij.

Pse dijetarët i fillojnë librat e tyre me besmeleh?

Kjo, në ndjekje të Kuranit, profetëve dhe të dërguarve alejhim es-selam.

Kjo, duke u mbështetur (bazuar) në hadithin: “*Çdo çështje me rëndësi që nuk fillon me bismilab...*”, edhe nëse hadithi konsiderohet i dobët (daif).

Kjo, në ndjekje të shembullit të dijetarëve nga të parët tanë të mirë (Allahu i mëshiroftë!).

Kjo, në kërkim të begatisë duke filluar me emrin e Allahut të Lartësuar.

Mësimi i parë

Surja El-Fatiha dhe suret e shkurta

Mësimi i sures El-Fatiha dhe çfarë të mundesh prej sureve të shkurta, nga surja Ez-Zelzeleh deri të surja En-Nas. E kjo, duke mësuar shqiptimin dhe leximin e saktë të tyre, memorizimin dhe shpjegimin e atyre gjërave që duhen kuptuar.

Sqarim:

Kërkohet që të memorizohen- ashtu siç vepronin të parët tanë të mirë- çdo ditë nga dhjetë ajete. Kjo e shoqëruar me leximin dhe shpjegimin e tyre nga ndonjë tefsir i shkurtër/përmbledhës, si: tefsiri i Ibën Seadit (Allahu e mëshiroftë!) dhe duke kërkuar ndihmën e Allahun për të punuar me to (me ajetet e mësuara).

Me cilin tefsir duhet të fillojë nxënësi i dijes?

Nxënësi i dijes këshillohet që të fillojë me “**Tefsiru El-Kerim Er-rrahman fi Tefsiri Kelam El-Mennan**” i Shejh Abdurrahman bin Nasir Es-Seadi (Allahu e mëshiroftë dhe e faltë!).

Përse?

Për shkak të këshillës së dijetarëve dhe rëndësisë që ata i kanë kushtuar atij.

Ai është i shkurtër dhe përmbledhës dhe shumë i përshtatshëm për fillestarin (të riun në fe) që ta lexojë.

Shprehjet e tij janë të lehta dhe të qarta.

Ai ndihmon të punosh sipas asaj që thotë Kurani, me lejen e Allahut.

Ngase autori (Allahu e mëshiroftë!) fokusohet në teuhidin.

Si ndahen njerëzit në lidhje me Kuranin?

Njerëzit sa i përket Kuranit ndahen:

Ata që kanë kaluar në ekstrem (tefrit) që e kanë braktisur Kuranin. Braktisja e Kuranit bëhet duke:	Ata që kanë mangësi (ifrat): e lexojnë dhe e memorizojnë Kuranin, por pa medituuar rreth tij dhe nuk punojnë me të.	Ata që janë të mesëm: vazhdimisht e lexojnë Kuranin, e memorizojnë, meditojnë rreth tij dhe kërkojnë ndihmën e Allahut për të punuar me të. Kjo ka qenë dhe gjendja selefëve dhe pasuesve të tyre.		
mos e lexuar atë,	mos e memorizuar atë,	mos medituuar rreth tij,	mos punuar me të	dhe mosmjekimi me të.

Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe i Dërguari do të thotë: “O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urreyer”**. El-Furkan: 30. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: *“Prej pasardhësve të tij do të ketë njerëz që e lexojnë Kuranin, por ai nuk e kalon grykën e tyre. Ata vrasin muslimanët dhe i lenë idbujtarët dhe dalin prej Islamit ashtu siç del shigjeta prej gjabut. Nëse do i arrija ata, do t'i vrisja”*.

Fragmente nga “Tejsiru El-Kerim Er-Rrahman Fi Tefsiri Kelam El-Mennan” të dijetarit të madh Abdurrahman Es-Sidij (Allahu e mëshiroftë!) dhe pyetjet rreth tij

Komentimi i sures “El-Fatihah” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (1) الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ (2) الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ (3) مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ (4) إِيَّاكَ نَعْبُدُ
وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ (5) اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ (6) صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا
الضَّالِّينَ (7)

(1) “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit! (2) I gjithë lavdërimi i përket Allahut, Zotit të të gjitha botëve, (3) të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, (4) Sunduesit të ditës së llogarisë. (5) Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje. (6) Na udhëzo në rrugën e drejtë! (7) Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi, jo në të atyre që kanë merituar zemërimin (Tënd) dhe as të atyre të cilët kanë humbur!”

Ajeti 1: D.m.th.: Filloj me çdo emër të Allahut të Lartësuar, ngase fjala “ism-emër” është në numrin njëjës dhe përfshin të gjitha emrat e bukur. “Allahu” është i Adhuruari që meriton me të drejtë të veçohet me adhurim, për shkak të attributeve të Tij hyjnore, të cilat janë absolute. “**të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**” janë dy emra që tregojnë se Allahu i Madhëruar është zotëruesi i mëshirës së gjerë dhe të madhe, e cila ka përfshirë çdo gjë, çdo krijesë të gjallë. Këtë mëshirë Ai e ka caktuar për të devotshmit, pasuesit e profetëve dhe të dërguarve të Tij. Këtyre u takon mëshira e plotë, ndërsa të tjerët përveç tyre do të kenë (do i përfshijë) diçka prej saj (mëshirës). Dije se prej bazave të pranuara unanimisht mes të parëve të këtij umeti dhe imamave të tij është besimi në emrat e Allahut dhe atributet e Tij dhe në dispozitat që kanë të bëjnë me to (atributet). Ata besojnë se Ai (Allahu) është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, Zotëruesi i kësaj mëshire të madhe me të cilën është cilësuar. Prandaj, të gjitha mirësitë (begatitë) janë prej gjurmëve të mëshirës së Tij. Ky rregull vlen dhe për të gjithë emrat e tjerë. Në lidhje me emrin “El-Alim” thuhet se Ai është i Gjithëdituri me dije absolute që di çdo gjë. “Kadir” i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Ajeti 2: **“I gjithë lavdërimi i përket Allahut”** është lavdërim për Allahun me atributet e Tij të përsosura dhe veprat të Tij që sillen rreth mirësisë dhe drejtësisë (së Tij). Atij i përket lavdërimi i plotë në të gjitha aspektet. **“Zotit të të gjitha botëve”**, Er-Rabb është Ai që kujdeset për të gjitha botët. E atëherë Allahut- janë të krijuar nga Ai, i Cili ua ka mundësuar gjërat e nevojshme dhe i ka begatuar me mirësi të mëdha, të cilat nëse s’do i kishin, ata s’do të ekzistonin. Prandaj, nuk ka mirësi që ata e posedojnë, vetëm se ajo është prej Allahut të Lartësuar. Përkujdesja e Allahut ndaj krijesave të Tij është dy llojesh: **E përgjithshme** dhe **e veçantë**. **E përgjithshmja**: është krijimi i krijesave, furnizimi i tyre dhe orientimi i tyre drejt gjërave të dobishme, mbi të cilat mbështetet ekzistenca e tyre në jetën e kësaj bote. **E veçanta**: është përkujdesja e Tij për të dashurit e tij, duke rrënjosur besimin në zemrat e tyre, duke u dhuruar sukses në arritjen e tij, duke i plotësuar ata (me virtytet e larta) dhe duke larguar prej tyre çdo gjë që bëhet pengesë mes atyre dhe tij. Pra, përkujdesja në dhënien sukses për të arritur çdo mirësi dhe për t’u mbrojtur nga çdo e keqe. Ndoshta ky kuptim është dhe sekreti që shumica e lutjeve të profetëve drejtuar Allahut janë (fillojnë) me fjalën “Er-Rabb”, sepse të gjitha kërkesat (nevojat) e tyre përfshihen nën përkujdesjen e Tij të veçantë. Kështu që, fjala e Tij **“Zotit të të gjitha botëve”** tregon për veçimin e Tij në krijim, në sistemim, në begatimin me mirësi ndaj krijesave, se Ai është i pasur dhe i Panevojshëm për krijesat, se krijesat janë të varfra dhe nevojtare për Të në çdo aspekt.

Ajeti 4: **“Sunduesit të ditës së llogarisë”**- ‘El-Malik’ është Ai që është cilësuar me atributin e sundimit, prej gjurmëve të tij është se Ai urdhëron dhe ndalon, shpërblen dhe dënon dhe vepron me ato që ka në pronësinë e Tij, me të gjitha format që dëshiron. E ka përmendur sundimin me **“ditën e llogarisë”**, ngase ajo është dita e Kiametit, Dita në të cilën njerëzit do të shpërblehen për punët e tyre që i kanë vepruar, të mira dhe të këqija. Në këtë Ditë do t’u shfaqet plotësisht krijesave sundimi absolut i Tij, drejtësia dhe urtësia e Tij dhe do të shkëputet (asgjësohet) çdo pushtet që kanë zotëruar krijesat (në dynja), saqë në këtë Ditë Ai do të barazojë mbretërit me njerëzit e thjeshtë dhe robërit me të lirët. Të gjithë të nënshtruar ndaj madhësisë së Tij dhe të përulur ndaj Krenarisë së Tij duke pritur gjykimin e Tij për veprat që kanë punuar, duke shpresuar shpërblimin e Tij dhe të frikësuar nga dënimi i Tij. Prandaj, Ai e ka veçuar atë Ditë duke e përmendur. Në fund të fundit Ai (Allahu) është Sunduesi i Ditës së llogarisë dhe i ditëve të tjera.

Ajeti 5: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje”**- d.m.th. të veçojmë vetëm ty me adhurim dhe vetëm Ty të drejtohem për ndihmë dhe mbështetje. Sikur thotë “të adhurojmë Ty dhe nuk adhurojmë askënd tjetër pos Teje dhe kërkojmë ndihmë dhe mbështetje tek Ty dhe tek askush tjetër pos Teje”. Dhënia përparësi adhurimit ndaj kërkit të ndihmës dhe mbështetjes, është si puna e të përgjithshmes ndaj të veçantës. E kjo, për të treguar kujdes në dhënien përparësi të së drejtës së Allahut të Lartësuar ndaj të drejtës së robit të Tij.

‘El-Ibdaheh/Adhurimi’ është: *“Emri i përgjithshëm i çdo gjëje që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, prej punëve dhe fjalëve të dukshme e të brendshme”*.

‘El-Istianeh’ është *“Mbështetja dhe kërkitimi i ndihmës tek Allahu i Lartësuar në kërkitimin e të mirave dhe largimin e të këqijave duke qenë i bindur plotësisht për arritjen e saj”*.

Adhurimi ndaj Allahut dhe kërkitimi i ndihmës prej Tij është mjeti për arritjen e lumturisë së përjetshme dhe shpëtimit nga të gjitha të këqijat. Nuk ka rrugë tjetër për të shpëtuar përveçse me zbatimin e këtyre të dyjave (adhurimin dhe kërkitimin e ndihmës tek Allahu). Adhurimi quhet i tillë vetëm nëse merret nga i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke synuar me të Fytyrën e Allahut. Pra, me të dy këto çështje konsiderohet adhurim. E ka përmendur ‘El-Istianeh’ pas adhurimit, edhe pse el istianeh hyn në të, sepse njeriu ka nevojë që në të gjitha adhurimet e tij të kërkojë ndihmë tek Allahu i Lartësuar (për përmbushjen e tyre). Nëse Allahu nuk e ndihmon atë, s’ka për ta arritur atë që do prej zbatimit të urdhëresave dhe largimit nga ndalesat.

Ajeti 6: **Na udhëzo në rrugën e drejtë!**” d.m.th. na trego (oriento), na udhëzo dhe na jep sukses për në rrugën e drejtë, e cila është rruga e qartë, që të shpie tek Allahu dhe xhenetet e Tij, ajo është: *njohja e të vërtetës dhe të punuarit me të*. Pra, na udhëzo në rrugën e drejtë. Udhëzimi për në rrugën e drejtë bëhet duke u kapur fort pas fesë Islame dhe duke braktisur fetë e tjera. Udhëzimi në rrugën e drejtë përfshin udhëzimin për njohjen e të gjitha detajeve fetare me dije dhe punë. Kjo lutje është prej lutjeve më gjithëpërfshirëse dhe më e dobishmja për njeriun. Prandaj, është detyrë për njeriun që ta lusë Allahun me të në çdo rekat të namazit të tij, për shkak të nevojës së madhe të tij për këtë. Rruga e drejtë është:

Ajeti 7: **“Në rrugën e atyre të cilëve u ke dhuruar mirësi”** prej profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe vepërmirëve. **“jo në (rrugën) të atyre që kanë merituar zemërimin (Tënd)”** të cilët e njohën të vërtetën dhe e braktisën atë (nuk punuan me të), siç janë çifutët dhe të ngjashmit me ta, e as në rrugën **“e atyre të cilët kanë humbur”** të cilët e braktisën të vërtetën nga injoranca dhe humbja, siç janë të krishterët dhe të ngjashmit me ta.

Kjo sure edhe pse e shkurtër përmban gjëra që s'mund të gjenden te suret e tjera të Kuranit. Pra, kjo sure përmban tri llojet e teuhidit:

- teuhidin rububijeh, që përftohet nga fjala e Tij: **“Zotit të botëve”**,
- teuhidin uluhijeh, - veçimi i Allahut me adhurim- që përftohet nga Emri ‘Allah’ dhe fjala e Tij: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje”**,
- dhe teuhidin e emrave dhe attributeve të Allahut, që është pohimi i attributeve të plota të Allahut të Madhëruar të cilat Ai ka pohuar për veten e tij dhe i ka pohuar i Dërguari i tij sal-Allahu alejhi ue sel-lem, pa mohuar (ta'til), pa përngjasim (temthil) dhe pa krahasim (teshbih). Për këtë tregon dhe fjala ‘elhamdulilah’ siç e kemi përmendur më herët.

Kjo sure përmban pohimin e profetësisë në fjalën e Tij: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”**, ngase udhëzimi në rrugën e drejtë është gjë e pamundur pa profetët. Gjithashtu kjo sure pohon shpërblimin për veprat e kryera, bazuar në fjalën e Tij: **“Sunduesit të ditës së llogarisë”**. Dhe se ky shpërblim do bëhet me drejtësi, sepse ‘Ed-Din’ do të thotë shpërblim me drejtësi.

Kjo sure përmban dhe pohimin e kaderit dhe se robi është ai që në të vërtetë vepron/punon, në të kundërtën e asaj që thonë (dhe besojnë) kaderijet dhe xhebrijet. Madje, kjo sure përmban kundërpërgjigje ndaj të gjithë bidatçinjve dhe njerëzve të humbur, bazuar në fjalën e Tij: **“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”**, ngase ajo (rruga e drejtë) është njohja e së vërtetës dhe puna me të. Kështu që, çdo bidatçi dhe i humbur është kundërshtues i saj.

Kjo sure përmban sinqeritetin për Allahun e Lartësuar në adhurim, në kërkimin e ndihmës dhe në mbështetjen tek Ai. Kjo gjendet te fjala e Tij: **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Ty të kërkojmë ndihmë e mbështetje”**.

Komentimi i ajetit Kursij

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهٗ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

“Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij? Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që do Ai. Kursiju i Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh ruajtja e tyre (qiejve dhe Tokës). Ai është i Larti, Madhështori.”¹

Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem njofton se ky është ajeti më madhështor i Kuranit, për shkak të asaj që përmban prej teuhidit, çështjeve madhore dhe attributeve të Allahut të Lartësuar. Pra, ky ajet njofton se Allahu është Ai i Cili i meriton të gjitha domethëniet e uluhijes dhe se askush tjetër nuk e meriton uluhijen dhe përulësinë/nënshtimin përveç Tij. Uluhija e dikujt tjetër dhe adhurimi përkushtuar dikujt tjetër përveç Allahut është i kotë.

Ai është “i Përjetshmi” i Cili zotëron jetë të përsosur pa asnjë mangësi në dëgjim, shikim, fuqi, dëshirë etj., prej cilësive vetjake absolute. Te fjala: “**El-Kajjum/Mbajtësit të gjithçkaje**” bëjnë pjesë të gjitha cilësitë veprore, sepse Ai është El-Kajjum, i Cili është jonevojtar për të gjitha krijesat e Tij dhe i Cili ka krijuar çdo gjë që ekziston e u siguroi atyre gjithçka që u duhet në ekzistencën dhe mbijetesën e tyre.

Dhe prej të jetuarit dhe përjetshmërisë së Tij të përsosur është se “**Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi!**”, ngase dremitja dhe gjumi i përkasin krijesës të cilën e kaplon dobësia dhe pafuqia dhe assesi nuk i përket Atij të Cilit i takon Madhështia dhe Krenaria. Ai njofton se është Sunduesi i çdo gjëje që ka në qiej dhe në tokë, të gjithë janë robër të Allahut dhe askush nuk del jashtë kësaj, ngase “**S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit**”. Pra, Ai është Sunduesi i gjithçkaje, të Cilit i përkasin cilësitë e sundimit.

Prej sundimit të plotë të Tij është se nuk **“mund të ndërmjetësojë tek Ai”** askush **“vetëm se me lejen e Tij”**. Të gjithë njerëzit me pozitë dhe ndërmjetësuesit janë robër të Tij, të cilët nuk mund të ndërmjetësojnë, për askënd, derisa Ai t’u japë leje atyre. **“Thuaju: ‘Ndërmjetësimi është i gjithi në duart e Allahut; Atij i takon pushteti i qiejve dhe i Tokës e pastaj tek Ai do të ktheheni’**”. Allahu nuk i jep leje askujt që të ndërmjetësojë vetëm se atij me të cilin është i kënaqur. Dhe Ai nuk është i kënaqur përveçse me atë i cili e veçon Atë në adhurim dhe pason të dërguarit e Tij. Kush nuk i posedon këto (teuhidin dhe pasimin e profetëve), s’ka pjesë në ndërmjetësim. Pastaj, Ai njofton se dija e Tij është e gjerë dhe përfshin çdo gjë. Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave prej gjërave të së ardhmes **“dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre”** nga gjërat e kaluara. Asgjë nuk mund t’i fshehet Atij, sepse **“Allahu e di shikimin e përvjedhur të syrit dhe atë që fsheh zemra”**. Kurse, krijesat nuk mund të përvetësojnë (posedojnë) asgjë nga dija e Tij **“përveç asaj që do Ai”**. Prej asaj që do Ai është: ajo që Allahu u ka treguar (shfaqur) disa prej krijesave të Tij prej çështjeve fetare. E kjo është gjë shumë e vogël (paktë) në krahasim me dijen e hollësishme dhe të madhe të Allahut. Të dërguarit dhe engjëjt, krijesat më të ditura për Allahun, kanë thënë: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti”**.

Më pas, Allahu njofton për madhësinë e Tij dhe se Kursiju i Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe se Ai i ruan ato dhe çfarë ka mes tyre prej krijesave, me shkaqe dhe rregulla që Ai i ka vendosur tek krijesat. E megjithë këtë, Atë nuk e lodh ruajtja (kujdesi) që ua bën atyre, për shkak të madhësisë absolute të Tij, fuqisë dhe urtësisë së madhe të Tij në vendimet e Tij.

“Ai është i Larti” me Qenien e Tij mbi të gjitha krijesat e Tij dhe **“Ai është i Larti”** me atributet madhështore të Tij. **“Ai është i Larti”** të Cilit i janë nënshtruar krijesat dhe i janë përlulur qafat.

“Madhështori” që ka përfshirë të gjitha cilësitë, si: Madhështori, Krenari dhe i Lavdishmi, të Cilin e duan zemrat dhe e madhërojnë shpirtrat. Të dijshtimit e dinë se madhështia e çdo gjëje, edhe nëse është shumë e madhe, nuk është asgjë përpara Madhësisë së të Lartësuarit, Madhështorit. Andaj, ajeti që përmban këto kuptime madhështore meriton të jetë ajeti më i madh në Kuran. Ndërsa, kush e lexon atë me meditim dhe duke e kuptuar, meriton t’i mbushet zemra me siguri, mirënjohje dhe besim, si dhe të jetë i ruajtur me këtë nga të këqijat e shejtanit.

Komentimi i sures “Idha Zulzileti” – sure Mekase

إِذَا زُلْزِلَتِ الْأَرْضُ زُلْزَالَهَا (1) وَأَخْرَجَتِ الْأَرْضُ أَثْقَالَهَا (2) وَقَالَ الْإِنْسَانُ مَا لَهَا (3) يَوْمَئِذٍ تُحَدِّثُ أَخْبَارَهَا (4) بِأَنَّ رَبَّكَ أَوْحَىٰ لَهَا (5) يَوْمَئِذٍ يَصْدُرُ النَّاسُ أَشْتَاتًا لِيُرَوْا أَعْمَالَهُمْ (6) فَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ خَيْرًا يَرَهُ (7) وَمَنْ يَعْمَلْ مِثْقَالَ ذَرَّةٍ شَرًّا يَرَهُ (8)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

(1) Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit), (2) kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj (3) e njeriu të thotë: “Ç’po i ndodh asaj?!” (4) Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj, (5). sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë. (6) Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t’u tregohen veprat e tyre: (7) kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, (8) e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë”.

Ajetit 1-2: Allahu i Madhëruar njofton për atë që do të ndodhë Ditën e Kiametit dhe se toka do të dridhet e shkundet fort, derisa të shkatërrohet çdo ndërtesë që gjendet mbi të, malet dhe kodrat do të rrafshohen, ndërsa ajo (toka) do të jetë e gjitha e sheshtë pa gropa. “kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj” d.m.th. çdo gjë që ka në brendësinë e saj prej të vdekurve dhe thesareve.

Ajeti 3: “e njeriu të thotë” pra, kur të shohë se çfarë do t’i ndodhë asaj (tokës), njeriu do të thotë “Ç’po i ndodh asaj?!” d.m.th.: çfarë po ndodh me të?!

Ajetet 4-5: “Atë Ditë ajo (toka) do të tregojë lajmet e saj” d.m.th. do të dëshmojë ndaj njerëzve për atë që ata kanë vepruar mbi sipërfaqen e saj, të mira apo të këqija. Toka është prej atyre që do dëshmojnë ndaj robërve me veprat që ata kanë punuar. E kjo “sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë”, pra e ka urdhëruar atë që të dëshmojë për çka është vepruar mbi sipërfaqen e saj, ndërsa ajo assesi nuk e kundërshton urdhrin e Tij.

Ajeti 6: “**Atë Ditë njerëzit do të paraqiten**” në vendin e tubimit Ditën e Kiametit (ku Allahu do gjykojë mes tyre), “**grupe-grupe**” d.m.th. të ndarë në grupe të ndryshme, “**që t’u tregohen veprat e tyre**” d.m.th. Allahu t’iu tregojë atyre ato që punuan në jetën e kësaj bote, prej të këqijave dhe të mirave, e secilit do i jepet shpërblimi i merituar në varësi të asaj që ka punuar.

Ajeti 7-8: “**kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë**”. Kjo është gjithëpërfshirëse, si për të mirat ashtu dhe për të këqijat. Nëse personi sheh se edhe për grimcën më të vogël e cila është gjëja më e parëndësishme/pavlerë do merret në llogari, atëherë çdo gjë sipër saj (më e madhe sesa kjo) është më parësore dhe më e mundshme. Siç thotë i Madhëruari: “**ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë largësi të madhe**”.¹ “**Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar**”.¹ Në këtë ka nxitje për bërjen e veprës së mirë, qoftë dhe e paktë, dhe kërcënim për bërjen e të keqes, edhe nëse është e vockël.

Komentimi i sures “El-Adijati” - sure Mekase

وَالْعَادِيَاتِ ضَبْحًا (1) فَالْمُورِيَاتِ قَدْحًا (2) فَالْمُعِيرَاتِ صُبْحًا (3) فَأَنْزَلَ بِهِ نَفْعًا (4) فَوَسَطْنَ بِهِ جَمْعًا (5) إِنَّ
الْإِنْسَانَ لِرَبِّهِ لَكَنُودٌ (6) وَإِنَّهُ عَلَىٰ ذَلِكٍ لَّشَهِيدٌ (7) وَإِنَّهُ لِحُبِّ الْخَيْرِ لَشَدِيدٌ (8) أَفَلَا يَعْلَمُ إِذَا بُعِثَ رَمًا فِي الْقُبُورِ (9)
وَحُصِّلَ مَا فِي الصُّدُورِ (10) إِنَّ رَبَّهُمْ بِهِمْ يَوْمَئِذٍ لَّخَبِيرٌ (11)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Beto hem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur, (2) që nxjerrin xixa nga thundrat (3) dhe trokojnë për sulm në mëngjes, (4) duke çuar re pluhuri, (5) ndërsa çajnë armikun në dysh, (6) se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet, (7) dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon. (8) Vërtet, ai është i babëzitur për pasuri. (9) Vallë, a nuk e di ai se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre (10) dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse, (11) Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!”

Ajeti 1: Allahu i Lartmadhëruar betohet në kuajt për shkak se në ta ka prej argumenteve të Tij të mrekullueshme dhe mirësive Tij të dukshme që janë të ditura për njerëzit. Allahu betohet në ta duke përmendur një gjendje të tyre, ku asnjë prej llojeve të kafshëve nuk janë si ata (kuajt), dhe thotë: **“Beto hem për ata (kuaj) që vrapojnë duke dihatur”** d.m.th. kuajt që vrapojnë fuqishëm dhe gjatë vrapimit ata hingëllinë kur rreziku shtohet. **“me thundrat”** me potkonjtë e tyre të fortë shkelin nëpër gurë dhe **“nxjerrin xixa”** nga fortësia e thundrave të tyre. **“dhe trokojnë për sulm”** kundër armikut **“në mëngjes”**, ngase në të shumtën e rasteve lufta fillon në mëngjes.

Ajetet 4-5: **“duke çuar re pluhuri ndërsa çajnë armikun”** d.m.th. ngrënë pluhurin me vrapin dhe sulmin e tyre dhe depërtojnë midis turmës së armikut me kalorësit hipur mbi ta.

Ajeti 6: Shkaku i betimit tregohet te fjala e Tij **“se njeriu është vërtet mosmirënjohës ndaj Zotit të vet”**, pra nuk është mirënjohës ndaj Allahut për mirësitë që ia ka dhuruar. Njeriu nga natyra e tij është dorështrënguar dhe nuk pranon që t'i plotësojë detyrimet e tij. Përkundrazi, nga natyra e tij ai është dembel dhe koprrac ndaj detyrimeve pasurore dhe trupore, përveç atij që Allahu e ka udhëzuar dhe i përmbush detyrimet me të cilat është ngarkuar.

Ajeti 7: **“dhe ai, pa dyshim, këtë e dëshmon”**, d.m.th. njeriu është dëshmues për këtë koprraci e mosmirënjohje dhe s'e mohon diçka të tillë, sepse çështja është mëse e qartë dhe e dukshme. Mendohet se përemri vector **‘ai’** kthehet tek Allahu i Lartësuar. Pra, me të vërtetë robi ndaj Zotit të tij është mosmirënjohës dhe Allahu është dëshmues për këtë gjë. Në këtë ajet ka kërcënim të ashpër për atë që është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij, sepse Allahu është dëshmues.

Ajeti 8: **Vërtet, ai**” d.m.th. njeriu **“është i babëzitur”** për pasuri dhe e do shumë atë. Kjo dashuri e madhe për pasurinë e shtyu atë të lë përmbushjen e detyrimeve me të cilat është ngarkuar, duke i dhënë përparësi plotësimi të dëshirave të vetvetes ndaj kënaqësisë së Zotit të tij. E gjithë kjo për shkak të fokusimit të tij te jeta e kësaj bote dhe shkujdesjes ndaj botës tjetër.

Ajetet 9-10: Prandaj, Allahu për të nxituar tek ai frikën për Ditën e Premtuar thotë “**Vallë, a nuk e di**” ky i mashtruar “**se kur të nxirren jashtë ata që gjenden në varre**”, pra kur Allahu t’i nxjerrë të vdekurit nga varret e tyre për t’i ringjallë dhe tubuar ata “**dhe, kur të dalë në shesh ajo që është në gjokse**”, do të shfaqet haptazi çdo gjë që fshihet në to (gjokse) prej të mirave dhe të këqijave. Kështu e fshehta do të bëhet publike, do të shfaqet (del në pah) brendësia dhe të gjithë do shijojnë rezultatin e veprave të tyre.

Ajeti 11: “**Zoti i tyre, me siguri, atë Ditë di çdo gjë për ta?!**” d.m.th. është i Dijshëm për veprat e tyre të dukshme dhe të fshehta, të vogla dhe të mëdha, për të cilat Ai do i shpërblejë ata. Është specifikuar njoftimi për këtë Ditë, edhe pse Allahu i Lartësuar është i Gjithëdijshëm rreth robërve të Tij në çdo kohë dhe moment.

Komentimi i sures “El-Kariah” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

الْقَارِعَةُ (1) مَا الْقَارِعَةُ (2) وَمَا أَذْرَاكَ مَا الْقَارِعَةُ (3) يَوْمَ يَكُونُ النَّاسُ كَالْفَرَاشِ الْمَبْثُوثِ (4) وَتَكُونُ الْجِبَالُ كَالْعُيُوفِ الْمُنْفُوسِ (5) فَأَمَّا مَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ (6) فَهُوَ فِي عِيشَةٍ رَاضِيَةٍ (7) وَأَمَّا مَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ (8) فَأُمُّهُ هَاوِيَةٌ (9) وَمَا أَذْرَاكَ مَا هِيَةٌ (10) نَارٌ حَامِيَةٌ (11)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Gjëmimi i tmerrshëm! (2) Ç’është Gjëmimi i tmerrshëm? (3) Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm? (4) Atë Ditë njerëzit do të jenë si fluturat e shpërndara, (5) kurse malet si leshi i shprishur. (6) Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore, (7) ai do të ketë një jetë të kënaqur (në Xhenet). (8) E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore, (9) Ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit). (10) Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Humnera (e Xhehenemit)? (11) Ajo është një Zjarr i vrullshëm”.

Ajetet 1-3: **“Gjëmimi i tmerrshëm!”**- El-Kariah është prej emrave të ditës së Kijametit. Është quajtur me këtë emër sepse ajo trondit njerëzit dhe i frikëson me tmerret e saj. Prandaj, Allahu për të treguar madhësinë dhe rëndësinë e saj thotë: **“Gjëmimi i tmerrshëm! Ç’është Gjëmimi i tmerrshëm? Kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është Gjëmimi i tmerrshëm?”**

Ajeti 4: **“Atë Ditë njerëzit”** prej tmerrit dhe panikut të madh **“do të jenë si fluturat e shpërndara”** d.m.th. si karkaleca të shpërndarë dallgë-dallgë njëri mbi tjetrin. Fluturat (el-ferash) janë insektet që lëvizin (fluturojnë) natën dallgë-dallgë njëri mbi tjetrin duke mos e ditur nga të drejtohen. Nëse ndizet ndonjë zjarr ato turren drejt tij pa e ditur se çfarë i pret. Kështu do të jetë dhe gjendja e njerëzve atë Ditë.

Ajeti 5: Sa u përket maleve, ata do të jenë **“si leshi i shprishur”**, d.m.th. malet do të bëhen si leshi i shprishur të cilin e merr tutje edhe era më e lehtë (vogël). Allahu i Madhëruar thotë: **“Ti i shikon malet e mendon se janë të palëvizshme, por ato do të lëvizin si retë”**. En-Neml: 88. Pas kësaj ato (malet) do të bëhen pluhur dhe prej tyre nuk mbetet asgjë që mund të shihet. Atë ditë do të vendosen peshoret dhe njerëzit do të ndahen në dy grupe: të lumturit dhe të dëshpëruarit.

Ajetet 6-7: **“Sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit do të rëndojnë në peshore”** d.m.th. ana e veprave të mira rëndon (peshon) më shumë sesa të këqijat **“ai do të ketë një jetë të kënaqur”** në xhenetet e begata.

Ajetet 8-11: **“E sa i përket atij, veprat e (mira të) të cilit nuk do të rëndojnë në peshore”**, pra ai që s’ka shumë vepra që mira që t’ia fshijnë të këqijat **“ai do të ketë si strehim Humnerën (e Xhehenemit)”**, d.m.th. vendi dhe strehimi i tij është zjarri, prej emrave të të cilit është **“El-Havijeh”**. Zjarri do të jetë i përhershëm për të, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“me të vërtetë, dënimi i tij është i përjetshëm”**. El-Furkan: 65. Kanë thënë se kuptimi është se ai do të hidhet me kokë poshtë në zjarr. **“Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Humnera (e Xhehenemit)?”** Kjo për të treguar madhësinë e tij (zjarrit). Pastaj e ka sqaruar atë me fjalën e Tij **“Ajo është një Zjarr i vrullshëm”** d.m.th. shumë i nxehtë dhe përvëlues. Nxehtësia e tij në krahasim me nxehtësinë e zjarrit të kësaj jete (që përdorim ne) është shtatëdhjetë herë më e madhe. I lutemi Allahu që të na mbrojë prej tij (zjarrit të xhehenemit)!

Komentimi i sures “Et-Tekathur” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلْهَأَكُمُ التَّكَاثُرَ (1) حَتَّىٰ زُرْتُمُ الْمَقَابِرَ (2) كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ (3) ثُمَّ كَلَّا سَوْفَ تَعْلَمُونَ (4) كَلَّا لَوْ تَعْلَمُونَ عِلْمَ الْيَقِينِ (5) لَتَرَوُنَّ الْجَحِيمَ (6) ثُمَّ لَتَرَوُنَّهَا عَيْنَ الْيَقِينِ (7) ثُمَّ لَتُسْأَلُنَّ يَوْمَئِذٍ عَنِ النَّعِيمِ (8)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Ju ka hutuar rivaliteti për të shtuar** (2) **derisa të shkoni në varre.** (3) **Gjithsesi, do ta merrni vesh!** (4) **Madje, së shpejti do ta merrni vesh!** (5) **Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!** (6) **Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!** (7) **Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë.** (8) **Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë** (e kësaj bote)!”

Ajeti 1: I Lartësuari, duke i qortuar robërit e Tij për shkak të preokupimit të tyre në tubimin e pasurisë dhe duke harruar shkakun për të cilin u krijuan- që të adhurojnë Atë, një të vetëm e të Pashoq- si dhe njohjen e tij, kthimin tek Ai me pendim dhe dhënien përparësi dashurisë së Tij para çdo gjëje, thotë: **“Ju ka hutuar”**, nga e gjithë kjo që u përmend, **“rivaliteti për të shtuar”** dhe nuk përmend se për çfarë shumimi bëhet fjalë, në mënyrë që kjo të përfshijë çdo gjë për të cilën njerëzit garojnë në shtimin e saj dhe çdo gjë me të cilën ata mburren. Këtu përfshihet garimi në shtimin e pasurisë, fëmijëve, përkrahësve, ushtarëve, shërbëtorëve, reputacionit dhe çdo gjë tjetër me të cilën synohet garimi me të tjerë dhe nuk synohet arritja e kënaqësisë së Allahut.

Ajeti 2: Ky angazhim dhe argëtim i juaj do të vazhdojë **“derisa të shkoni në varre”**, e atë ditë do t’u largohet perdja nga sytë dhe do të shihni qartë. Por, pas kësaj ju s’do të keni mundësi të ktheheni (përsëri) prapa (në jetën e dynjasë). Fjala e Tij **“derisa të shkoni në varre”** tregon se Berzahu (jeta e varrit) është vendbanimi i ndërmjetëm mes jetës së kësaj bote dhe botës tjetër, sepse Allahu ata i ka quajtur “vizitorë” dhe nuk i quajti “banorë”. Kjo tregon për ringjalljen (nga varret) dhe shpërblimin për veprat e bëra në vendbanimin e përgjeshëm.

Ajetet 3-6: Për këtë arsye, atyre u është premtuar se **“Gjithsesi, do ta merrni vesh! (4) Madje, së shpejti do ta merrni vesh! Kujdes! Ah, sikur ta dinit të vërtetën me siguri!”**, d.m.th. nëse do e dinit se çfarë ju pret, me një dije të sigurtë e cila depërton në brendësinë e zemrave, atëherë nuk do të rropateshit dhe harroheshit pas shtimit të pasurive. Përkundrazi, do të shpejtonit në kryerjen e veprave të mira. Por, mungesa e dijes së vërtetë bëri që të jepeshit pas asaj që shihni prej stolive të dynjasë. **“Sigurisht që do ta shihni Zjarrin flakërues!”** d.m.th. keni për ta parë (përjetuar) Kiametin dhe keni për ta parë Zjarrin flakërues të cilin Allahu e ka përgatitur për jobesimtarët.

Ajeti 7: **“Pastaj, me të vërtetë, do ta shihni atë me syrin e sigurisë”** d.m.th. keni për ta parë me sytë tuaj. Siç thotë i Madhëruari: **“Të ligjtë do të shohin zjarrin dhe do të binden, se me të vërtetë, do të bien në të dhe nuk do të gjejnë largim prej atij”**. El-Kehf: 53.

Ajeti 8: **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”,** të cilat i keni shijuar në jetën e dynjasë, se a e falënderuat Allahun për to, se a e përmbushët të drejtën e Allahut me to, apo i shfrytëzuat për të bërë mëkate ndaj Tij. Nëse jeni treguar falënderues ndaj Allahut për këto mirësi dhe i keni shfrytëzuar ashtu siç Ai ka urdhëruar, atëherë Ai do t’ju dhurojë mirësi të shumta dhe më të mrekullueshme se ato; apo u mashtruar me to, nuk e falënderuat Allahun për mirësitë e dhuruara, madje i shfrytëzuat ato për të kryer mëkate, atëherë Ai do ju dënojë për këtë. I Lartësuari thotë: **“Ditën, kur ata që kanë mohuar do të vihen para Zjarrit (do t’u thuhet): “Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj të dynjasë dhe jeni kënaqur me to, ndërsa sot do të ndëshkoheni me dënim poshtërues...”** ajeti. El-Ahkaf: 20.

Komentimi i sures “El-Asr” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَالْعَصْرِ (1) إِنَّ الْإِنْسَانَ لَفِي خُسْرٍ (2) إِلَّا الَّذِينَ آمَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ وَتَوَّصُوا بِالْحَقِّ وَتَوَّصُوا بِالصَّبْرِ (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Për kohën! (2) Me të vërtetë, njeriu është në humbje, (3) përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin”.

Ajetet 1-3: Allahu i Madhëruar betohet në kohën e cila është nata dhe dita dhe vendi i kryerjes së veprimeve dhe punëve të robërve, se me të vërtetë secili njeri është i humbur. Humbësi është i kundërti i fituesit. Humbja është në grada të ndryshme. Ndodh që njeriu të jetë në humbje të plotë, siç është gjendja e atij që ka humbur dynjanë e botën tjetër dhe që i kanë ikur shpërblimet e xhenetit dhe kështu meriton zjarrin e xhehenemit. Ndodh që njeriu të jetë në humbje në disa aspekte. Prandaj dhe Allahu e ka përgjithësuar humbjen për secilin njeri, përveç atyre që kanë katër cilësi:

-Besimin në atë që ka urdhëruar Allahu të besohet. Besimi nuk mund të jetë pa dituri, sepse ai është pjesë (degë) e tij dhe nuk plotësohet vetëm se me të.

-Veprën e mirë. Kjo është e përgjithshme për veprat e mira të dukshme dhe të fshehta dhe ato që lidhen me të drejtat e Allahut dhe të drejtat e robërve të Tij, që janë vaxhib (detyrë) dhe mustehab (e pëlqyeshme).

-Këshillimin ndaj njëri-tjetrit për të vërtetën, e cila është besimi dhe vepra e mirë. Pra, e këshillojnë njëri-tjetrin me këtë dhe nxisin drejt saj.

-Këshillimin ndaj njëri-tjetrit për bërjen durim ndaj bindjes së Allahut, për durim ndaj gjynaheve për mos t'i kryer ato dhe për durim ndaj përcaktimeve të dhimbshme të Allahut.

Me të dy gjërat (cilësitë) e para njeriu përsos veten e tij, kurse me dy cilësitë e tjera ai përmirëson (përsos) të tjerët. Ndërsa, duke i plotësuar të katërta ato (cilësitë), ka shpëtuar prej humbjes dhe ka arritur fitoren e madhe.

Komentimi i sures “El-Humezeh” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

وَنُؤَلِّ لِكُلِّ هُمَزَةٍ لَمَزَةٌ (1) الَّذِي جَمَعَ مَالًا وَعَدَّدَهُ (2) يَحْسَبُ أَنَّ مَالَهُ أَخْلَدَهُ (3) كَلَّا لَيُنْبَذَنَّ فِي الْحُطَمَةِ (4) وَمَا أَدْرَاكَ مَا الْحُطَمَةُ (5) نَارُ اللَّهِ الْمَوْقَدَةُ (6) الَّتِي تَطَّلِعُ عَلَى الْأَفْئِدَةِ (7) إِنَّهَا عَلَيْهِمْ مُّؤَصَّدَةٌ (8) فِي عَمَدٍ مُّمدَّدَةٍ (9)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Mjerë për çdo përqeshës - shpifës, (2) që grumbullon pasuri dhe e ruan, (3) duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm! (4) Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. (5) E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? (6) Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, (7) i cili depërton deri në zemrën e njeriut. (8) Ai do t'i rrethojë ata nga çdo anë, (9) në shtylla të gjata flakërruese”.

Ajeti 1: **“Uejlun – mjerë”** d.m.th. kërcënim, përfundim i keq dhe dënim i ashpër, **“për çdo përqeshës – shpifës”** d.m.th. ai që i përqeshë njerëzit me veprime dhe i tall ata me fjalë. ‘El-Hummaze’ është ai që fyen dhe i tall njerëzit me anë të veprimeve të tij, kurse ‘El-Lummaze’ është ai që i përqesh dhe tall me fjalë.

Ajeti 2: Prej cilësive të përqeshësit dhe tallësit me fjalë e veprime është: ai ka preokupim dhe shqetësim të tij të vetëm tubimin dhe shtimin e pasurisë, ruajtjen e saj që të mos pakësohet dhe mburrjen me të. Ai assesi nuk dëshiron ta shpenzojë atë për bamirësi, për mbajtjen e lidhjeve farefisnore dhe gjërave të ngjashme.

Ajeti 3: **“duke menduar”** me injorancën e tij **“se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!”** në dynja. Prandaj, të gjitha përpjekjet e tij i harxhon për grumbullimin e pasurisë duke menduar se ajo (pasuria) do t’ia zgjasë jetën. Por, a nuk e di ai se koprracia ia shkurton jetën dhe ia shkatërron dynjanë r botën tjetër, kurse bamirësia ia shton jetën?!

Ajetet 4-7: **“Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese?”**, është torturë shkatërruese për shkak të tmerrit të madh të tij zjarrit. Pastaj e shpjegon atë me fjalën e Tij: **“Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort”**, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. **“I cili”** prej nxehtësisë së tij të madhe **“depërton deri në zemrën e njeriut”**, pra prej trupave depërton në thellësi të zemrave.

Ajeti 8: E megjithë këtë nxehtësi përvëluese, ata do jetë të burgosur në të pa ndonjë shpresë se mund të dalin prej zjarrit. Prandaj Allahu thotë: **“Ai do t’i rrethojë ata nga çdo anë”**, d.m.th. të mbyllur **“në shtylla të gjata”** pas dyerve **“flakëruese”**, në mënyrë që mos të dalin prej tij. **“Sa herë që do të duan të dalin nga ai, do të kthehen në të dhe do t’u thuhet: “Shijoni dënimin e zjarrit, të cilin e mohoni!”** Es-Sexhde: 20. I kërkohet mbrojtje Allahut prej kësaj dhe e lusim Atë të na ruajë nga çdo e keqe në këtë botë dhe tjetrën!

Komentimi i sures “El-Fil” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (1) أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ (2) وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ (3) تَزِمِيهِمْ
بِحِجَارَةٍ مِنْ سِجِّيلٍ (4) فَجَعَلَهُمْ كَعَصِفٍ أَمَاكُورٍ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?
(2). A nuk ua prishi atyre kurthin, (3) duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh, (4) të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur? (5) Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë”.

Ajetet 1-5: A nuk e ke parë fuqinë e Allahut dhe madhësitinë e Tij, mëshirën e Tij me robërit e Tij dhe argumentet që tregojnë për njësimin e Tij dhe vërtetësinë e të Dërguarit të Tij, Muhamedit sal-Allahu alejhi ue sel-lem, se çfarë bëri Allahu me ushtrinë e Elefantit, të cilët synonin të shkatërronin Shtëpinë e Tij të Shenjtë (Qabenë)? Për shkak të saj (prishjes së Qabes) ata u përgatitën dhe morën me vete elefantë për ta shkatërruar atë. Ata erdhën tek arabët me një ushtritë të tillë që në mesin e saj kishte luftëtarë nga Abisinia dhe Jemeni dhe ata (arabët) nuk mund t'i bënin ballë asaj. Kur iu afruan Mekes dhe arabët nuk kishin mundësi ta mbronin atë, banorët e saj dolën prej saj të frikësuar për vetët e tyre. Allahu i Lartësuar u dërgoi atyre (ushtrisë së elefantit) tufa zogjsh të cilët bartnin gurë prej baltës së pjekur dhe u gjuajtën me to nga i pari deri tek i fundit dhe u shkatërruan plotësisht duke bërë që (ata) të ngjanin si byk i ngrënë. Kështu Allahu e largoi sherrin e tyre dhe kurthet e tyre ua ktheu vet atyre. Historia e ushtrisë së Elefantin është shumë e njohur. Kjo ka ndodhur në vitin në të cilin u lind i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ue sel-lem. Prandaj, kjo ngjarje e madhe është bërë pararendëse e thirrjes së tij dhe prej argumenteve madhështore të mesazhit të tij. Për të gjithë këtë lavdia dhe falënderimet janë vetëm për Allahun!

Komentimi i sures “El-Kurajsh” – sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ (1) إِيلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ (2) فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (3) الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِنْ خَوْفٍ (4)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) për të mbrojtur fisin Kurejsh, (2) për t’i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë. (3) Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabes), (4) i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike”.

Ajetet 1-4: Shumica e komentuesve të Kuranit kanë thënë se këto ajete kanë lidhje me suren para saj. Pra, Ne bëmë atë që bëmë (vepruam) me njerëzit (ushtrinë) e Elefantit për shkak të kurajshëve. E kjo, për t’i siguruar udhëtimet (karvanët) e tyre tregtare gjatë stinës së dimrit drejt Jemenit dhe gjatë stinës së verës drejt Shamit. Kështu Allahu i shkatërroi ata që dëshironin t’u bënin keq atyre dhe e lartësoi në zemrat e arabëve shenjtërinë e Qabesë dhe banorëve të saj, aq sa të gjithë i nderonin dhe nuk i preknin në udhëtimet që ata ndërmermin.

Për shkak të gjithë kësaj, Allahu i urdhëroi që të jenë falënderues ndaj Tij për mirësitë e shumta që u ka dhuruar dhe tha: “**Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë)**”, d.m.th. ta njësojnë Atë dhe adhurimin ta kryejnë me sinqeritet për Të.

“**i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike**”. Furnizimi dhe siguria prej frikës janë prej mirësive më të mëdha të jetës së kësaj bote, të cilat e bëjnë detyrë falënderimin ndaj Allahut të Lartësuar. Ty, o Allah, të takon lavdia dhe falënderimi për mirësitë e Tua të dukshme dhe të padukshme! Allahu e ka veçuar Qabenë duke përmendur se Ai është Zoti i Shtëpisë (Qabesë), për të treguar vlerën dhe rëndësinë e saj, edhe pse Ai është Zoti i gjithçkaje.

Komentimi i sures “El-Maun” – sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالذِّينِ (1) فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ (2) وَلَا يَحْضُ عَلَى طَعَامِ الْمَسْكِينِ (3) فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (4)
الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (5) الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ (6) وَيَمْتَعُونَ الْمَاعُونَ (7)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?** (2) **Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët** (3) **dhe nuk nxit që t’i jepet ushqim të varfrit.** (4) **Mjerë për ata, të cilët kur falen,** (5) **janë të pakujdesshëm për namazet,** (6) **të cilët duan vetëm që të duken** (7) **dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve”.**

Ajeti 1: I Lartësuari duke qortuar atë që lë të drejtat e Tij dhe të drejtat e robërve të Tij, thotë: “**A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?**”, d.m.th. mohon ringjalljen dhe shpërblimin. Pra, ai nuk beson atë me të cilën kanë ardhur të dërguarit.

Ajeti 2: “**Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët**” d.m.th. e largon atë me ashpërsi dhe nuk tregon mëshirë ndaj tij për shkak të ngurtësimit së zemrës së tij, ngase ai nuk shpreson në shpërblimin e Allahut dhe nuk i frikësohet dënimit të Tij.

Ajeti 3: “**dhe nuk nxit**” të tjerët “**që t’i jepet ushqim të varfrit**”. Pra, i pengon të tjerët të ushqejnë të varfrit dhe as vetë nuk i ushqen ata.

Ajetet 4-5: “**Mjerë për ata, të cilët kur falen**” d.m.th. e kanë detyrë faljen e namazit, porse “**janë të pakujdesshëm për namazet**” duke e humbur atë, duke mos e falur në kohën e tij dhe duke mangësuar shtyllat e tij. E gjithë kjo vjen si rezultat i mosdhënies rëndësi urdhrit të Allahut, e kështu tregohen të pakujdesshëm ndaj namazit i cili është adhurimi më i rëndësishëm. Ai që tregohet i pakujdesshëm ndaj namazit me vetëdije meriton të qortohet dhe të fajësohet. Ndërsa, pakujdesia për shkak të harresës është diçka që u ndodh të gjithëve. Madje, kjo i ka ndodhur edhe Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Ajetet 6-7: Prandaj, Allahu i ka përshkruar ata me syfaqësi, me ngurtësi në zemër dhe të pamëshirshëm, duke thënë: “**të cilët duan vetëm që të duken**”, pra i bëjnë veprat sa për t’u dukur në sy të njerëzve, “**dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve**” d.m.th nuk japin diçka, dhënia e të cilave nuk të dëmton, siç është dhënia e enës, kovës, sëpatës e të ngjashme me to, të cilat janë prej traditës së njerëzve që t’i japin dhe falin (dhurojnë). Kjo specie e tillë e njerëzve, derisa tregohen koprracë në dhënien e gjërave të tilla, imagjino se si veprojnë me gjërat më të mëdha dhe më me vlerë?! Në këtë sure ka nxitje për ushqimin e jetimit dhe të varfërve, për kujdesin ndaj namazit që të falet në kohën e tij e të kryet (falet) me sinqeritet për Allahun dhe jo për t’u dukur në sy të njerëzve, si dhe që të gjitha veprat t’i bëjmë me sinqeritet. Gjithashtu kjo sure nxitë për kryerjen e veprave të mira dhe në dhënien e gjërave të vogla, si: tenxhere, kovë, libër e të ngjashme me to, ngase Allahu e ka qortuar ashpër atë që s’e bën një gjë të tillë. Allahu i Lartësuar e di më së miri!

Komentimi i sures “El-Keuther” e cila është Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 إِنَّا أَغْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (1) فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَحْزِرْ (2) إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira**, (2) **andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!** (3) **Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë**”.

Ajeti 1: Allahu i Lartësuar duke i përkujtuar mirësitë e shumta që atij ia ka dhuruar Profetit të Tij, Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i thotë: “**Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira**”. Pra, mirësi të shumta, e prej tyre është dhe lumi që Allahu i Lartësuar do t’i japë Profetit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ditën e Kiametit, emri i të cilit është El-Keuther dhe Haudi, gjatësia dhe gjerësia e tij është sa ecja një muaj, uji i tij është më i bardhë sesa qumështi, më i ëmbël sesa mjalti dhe enët e tij janë sa është numri i yjeve në qiell dhe shndrisin si to (yjet). Kush e pi prej tij një grusht të vetëm, s’ka për të ndjerë më etje kurrë.

Ajeti 2: Pasi Allahu ia përkujtoi Profetit sal-Allahun alejhi ue sel-lem mirësitë që ia ka dhuruar, e urdhëron që ta falënderojë Atë për to, duke thënë: **“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!”** Allahu i ka veçuar me përmendje këto dy adhurime, sepse ato janë adhurimet më të mira dhe që të afrojnë më shumë tek Ai. Falja e namazit përmban nënshkrimin e plotë të zemrës dhe gjymtyrëve për Allahun, të cilat kalojnë nga njëri adhurim në tjetrin. Ndërsa, me bërjen e kurbanit njeriu afrohet tek Allahu me kurbanin më të mirë që posedon prej bagëtieve dhe me nxjerrjen e pasurisë e cila është shumë e dashur për shpirtrat, dashuri kjo e cila e bën atë të tregohet koprrac.

Ajeti 3: **“Sigurisht, ai që të urren ty”**, pra ai që të urren ty, që të fyen dhe të përmend për të keq për të të ulur pozitën **“ai vetë është fatprerë”**, fatprerë nga të gjitha të mirat, veprat do i asgjësohen dhe kurrë s’do të përmendet. Ndërsa, Muhamedi sal-Allahun alejhi ue sel-lem është i përsosur me cilësitë më të mira të një krijese, prej përmendjes së shumtë dhe do ketë shumë ndihmues dhe pasues.

Komentimi i sures **“El-Kafirun” - sure Mekase**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (1) لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (2) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (3) وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ (4) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ
 مَا أَعْبُدُ (5) لَكُمْ دِينُكُمْ وَلي دِين (6)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Thuaj: **“O ju jobesimtarë!** (2) **Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni** (3) **dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.** (4) **Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni** (5) **dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!** (6) **Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”** Ajetet 1-6: Thuaju jobesimtarëve haptazi dhe qartë **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”**, pra distancohu nga ajo çfarë ata adhurojnë përveç Allahut, haptazi dhe fshehtazi, **“dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”** për shkak të mos sinqeritetit tuaj në adhurimin tuaj ndaj Allahut. Kështu që, adhurimi juaj ndaj Tij i shoqëruar me shirk nuk quhet (konsiderohet) adhurim. Përsëritja (e shprehjeve në ajetet e sures) tregon së pari për mos ekzistencën e veprës dhe së dyti se kjo gjë është cilësi e pandashme. Për këtë arsye Ai bëri dallim mes dy grupeve (besimtarëve dhe jobesimtarëve) dhe tha: **“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”** Siç thotë i Lartësuari: **“Thuaj: “Çdokush sillet sipas mënyrës së vet”**. El-Isra: 84. Ju jeni të distancuar nga ajo që unë veproj dhe unë distancohem nga ajo që ju (o jobesimtarë) veproni.

Komentimi i sures “En-Nasr” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (1) وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (2) فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (3)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi** (i Mekës) (2) **dhe t’i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe grupe,** (3) **atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve**”.

Ajetet 1-4: Në këtë sure ka përgëzim, ka urdhër për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur ky përgëzim të përmbushet dhe ka një paralajmërim se çfarë vjen pas saj. Përgëzimi lidhet me ndihmën e Allahut për të Dërguarin e Tij, çlirimin e Mekës dhe hyrja e njerëzve “**në fenë e Allahut grupe grupe**”, shumica prej të cilëve do të jenë nga familja e tij dhe ndihmuesit e tij, pasi më herët kanë qenë armiqtë e tij. Dhe ashtu ndodhi. Urdhri ka të bëjë pas çlirimit të Mekës. Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që të jetë mirënjohës ndaj Allahut për këtë mirësi, ta madhërojë Atë, ta falënderojë dhe të kërkojë falje tek Ai.

Ajo se çfarë do të ndodhte më pas përfshin: përgëzimin se kjo fe do të vazhdojë të triumfojë dhe numri i pasuesve të saj do të shtohet duke u përhapur anë e mban botës. E kjo, pas madhërimit të Allahut, falënderimit dhe kërkimit të faljes nga i Dërguari i tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, sepse falënderimi i Allahut për mirësitë e dhuruara i shton ato. Allahu thotë: “**Nëse falënderoni, do t’ua shtoj (mirësitë)**”. Kjo ndodhi në kohën e katër prijësve të drejtë dhe pas tyre në këtë umet. Ndhma e Allahut për këtë fe vazhdon derisa Islami ka arritur aty ku s’ka arritur asnjë fe tjetër. Dhe aq shumë njerëz kanë hyrë në të sa në asnjë fe tjetër s’ka ndodhur diçka e tillë. Gjendja vazhdoi të ishte në këtë mirësi derisa në këtë umet filluan të shpikën në fe gjëra që bien ndesh me urdhrin e Allahut. Kështu ata u sprovuan me përçarje dhe ndodhi ajo që tashmë të gjithë e dimë. E megjithëkëtë, ky umet dhe kjo fe kanë mëshirën dhe mirësinë e Zotit, të cilën askush nuk mund ta marrë me mend.

Dhe e treta ishte se jetës së të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ishte afruar fundi. Jeta e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka qenë një jetë e begatë dhe fisnike, prandaj dhe Allahu është betuar në të. Allahu ka urdhëruar se gjërat e rëndësishme duhet të mbyllen me kërkim falje, siç është namazi, haxhi dhe gjërat e tjera. Kështu që, urdhri i Allahut për të Dërguarin e Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që ta falënderojë Atë dhe të kërkojë falje tek Ai në këtë rast, është tregues se jeta e tij po përfundon, andaj le të përgatitet për takimin me Zotin e tij dhe ta mbyllë jetën e tij në gjendjen më të mirë, salavatet dhe selamet e Allahut qofshin për të! Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke zbatuar (punuar me) Kuranin e shpeshonte në namazin e tij në ruku dhe sexhde thënien: “*Subhaneke Allahumme Rabbena ue bibamdik. Allahumme gfirli*”.

Komentimi i sures “El-Mesed” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (1) مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (2) سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ (3) وَأَمْرَأَتُهُ سَمَّالَةَ الْخَطَبِ (4) فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) **Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka!** (2) **Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera.** (3) **Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,** (4) **po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit,** (5) **në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme”.**

Ajeti 1: Ebu Lehebi është xhaxhai i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i cili ka qenë një armik i përbetuar ndaj tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe e mundonte. Ai as fenë nuk e pranonte për të e as ushqente ndjenjë fanatizmi për të prej lidhjes së gjakut. Allahu e shëmtoftë! Prandaj, Allahu e poshtëroi me këtë mallkim të madh që do të jetë për të deri në ditën e Kiametit. Allahu thotë: “**Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka**” d.m.th. u dëshpëroftë dhe u thaftë në gjithçka, kurrë mos fitoftë.

Ajeti 2: “**Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria**” që posedonte e cila është bërë shkak që të kalonte kufijtë, “**dhe as fitimet e tjera**” nuk e mbrojtën nga asgjë prej dënimit të Allahut kur zbriti mbi të.

Ajeti 3-5: **“Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara”** d.m.th. atë do ta përfshijë zjarri nga çdo anë; ai **“edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit”** e cila gjithashtu e mundonte shumë të dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ajo po ashtu e lëndonte shumë të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sle-lem dhe bashkëpunonte me bashkëshortin e saj në gjynah dhe armiqësi. Të dy ata përhapnin të keqen dhe përpiqeshin në maksimum për ta dëmtuar dhe munduar të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kështu, ajo me këto veprime e ngarkonte shpinën e saj me gjynahe njëjtë si personi që mban mbi shpinën e tij dru dhe në qafën e tij është i lidhur me litar (për të mbajtur peshën e druve) **“prej fijesh palme”**; ose në zjarr do të mbartë dru mbi shpinën e saj për të ndezur me to zjarrin e burrit të saj duke pasur në qafë një litar prej zjarri. Gjithsesi, në këtë sure ka një mrekulli prej mrekullive të Allahut, sepse Ai e ka zbritur këtë sure kur Ebu Lehebi dhe gruaja e tij ishin gjallë. Dhe njoftoi se ata të dy patjetër do të dënohen në Zjarr, gjë kjo që tregoi se ata të dy nuk do ta pranonin Islamin. Ndodhi ashtu siç lajmëroi i Gjithëdijshmi i të fshehtës dhe i të dukshmes.

Komentimi i sures “El-Ihlas” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1) اللَّهُ الصَّمَدُ (2) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3) وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! (2) Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. (3) Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. (4) Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”

Ajeti: **“Thuaj”** duke qenë i vendosur dhe i bindur në atë që thua dhe duke ia ditur asaj kuptimin, se **“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm”**, d.m.th. të qenit Një i vetëm është atribut ekskluziv i Tij. Ai është Një i Vetëm, përsosmëria është specifikë e Tij. Atij i përkasin emrat më të bukur dhe atributet më të larta, veprimet e Tij janë të pastra, Ai është i Pashembullt dhe i Pashoq.

Ajeti 2: “**Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**” d.m.th. Ai është synimi i të gjitha krijesave për nevojat e tyre. Të gjitha krijesat e qiellit e të tokës janë nevojtarë ndaj Tij dhe i luten Atij për plotësimin e nevojave të tyre. Vetëm Atij i drejtohen për çdo gjë që u duhet, sepse Ai është i Përsosur në atributet e Tij. Është i Gjithëdijshmi, dija e të Cilit është e përsosur në çdo aspekt, i Buti, butësia e të Cilit është e përsosur, është Mëshirëploti, mëshira e të Cilit është e përsosur, mëshira e Tij ka përfshirë gjithçka. Të këtilla janë të gjitha atributet e Tij.

Ajeti 3: Prej përsosmërisë së Tij është se “**Ai as nuk lind, as nuk është i lindur**”, sepse Ai nuk ia ka nevojën në mënyrë absolute krijesave të Tij.

Ajeti 4: “**Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!**”, as në emrat e Tij, as në cilësitë e Tij e as në veprat e Tij. Kjo sure përfshin teuhidin e emrave dhe cilësive të Allahut.

Komentimi i sures “El-Felek” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
فُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (1) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (2) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (3) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (4) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (5)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Thuaj: “**Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit, (2) që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar (3) dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri (4) dhe nga sherri i falltareve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji) (5) dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë**”.

Ajeti 1: Duke u mbrojtur “**Thuaj: “Kërkoj mbështetje**” d.m.th. strehohem, i drejtohem për ndihmë dhe mbrohem “**te Zoti i agimit**”, tek Ai që e bën farën të çelë dhe të mbijë dhe që e bën agimin të çelë.

Ajeti 2: “**që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar**”. Kjo përfshin çdo gjë që Allahu ka krijuar prej njerëzve, xhinëve dhe kafshëve. Pra, kërkohet mbrojtje dhe ndihmë tek Krijuesi i tyre nga sherri që gjendet në to.

Ajeti 3: Pas përgjithësimit Allahu specifikoi disa prej tyre dhe tha “**dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri**”, d.m.th. nga e keqja që gjendet në natë kur ajo mbulon njerëzit, sepse në këtë kohë dalin (përhapen) shumë prej shpirttrave të këqij dhe kafshëve të dëmshme.

Ajeti 4: “**dhe nga sherri i falltareve, që fryjnë në nyje** (duke bërë magji)”, d.m.th. nga e keqja e magjistarëve (falltarëve) të cilët fryjnë nëpër nyjat të cilat i lidhin gjatë magjisë që bëjnë.

Ajeti 5: “**dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë**”. Smirëziu është ai që dëshiron largimin e mirësisë nga tjetri, e për këtë, ai bën çfarë të mundet si e si që t’ia arrijë qëllimit. Prandaj, kërkohet strehim dhe mbrojtje tek Allahu nga e keqja e tij (smirëziut) dhe që t’i asgjësojë kurthet e tij. Te smirëziu hyn dhe syri i keq, sepse mësyshi nuk buron vetëm se nga smirëziu dashakeqës dhe shpirtlig. Kjo sure përmban kërkimin e mbrojtjes tek Allahu nga të gjitha llojet e së keqes në përgjithësi dhe nga ato që janë përmendur në veçanti. Po ashtu, kjo tregon se magjia është e vërtetë dhe duhet pasur kujdes nga dëmi i saj, duke kërkuar mbrojtje tek Allahu prej saj dhe atyre që e bëjnë atë (prej magjistarëve/eve).

Komentimi i sures “En-Nas” - sure Mekase

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (1) مَلِكِ النَّاسِ (2) إِلَهِ النَّاسِ (3) مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (4) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (5) مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (6)

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

“(1) Thuaj: “Kërkohet mbështetje te Zoti i njerëzve, (2) Sundimtari i njerëzve, (3) i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve, (4) nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt) (5) e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (6). (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!”

Ajetet 1-6: Kjo sure përfshinë kërkimin e mbrojtjes tek Allahu, Zoti i njerëzve, Sundimtari i tyre dhe i Adhuruari i tyre, prej shejtanit i cili është burimi i të gjitha të këqijave dhe esenca e tyre. Prej të keqes së tij (shejtanit) është se ai **“hedh dyshime në gjokset e njerëzve”** duke ua zbukuruar të keqen dhe i bën që ta shohin atë (të keqen/mëkatin) si diçka të bukur (të mirë), zgjon tek ta dëshirën për ta vepruar atë (të keqen) dhe i dekurajon ata nga e mira duke ua shfaqur në një imazh tjetër nga ajo që është në të vërtetë. Ai gjithmonë është në këtë gjendje, hedh cytje dhe pastaj largohet kur njeriu përmend Zotin e tij dhe mbështetet tek Ai për largimin e tij (shejtanit dhe cytjeve të tij).

Për këtë, njeriu duhet të kërkojë ndihmë, strehim dhe mbrojtje tek Allahu përmes atributit të Tij si Zot i të gjithë njerëzimit, ngase të gjithë njerëzit janë nën sundimin dhe pronësinë e Tij. Dhe se të gjitha krijesat janë nën zotërimin dhe pronësinë e Tij. Pra çdo krijesë është nën urdhërat e Tij dhe e obliguar që ta adhurojë vetëm Atë, gjë për të cilën edhe i krijoj. Kjo (të qenit adhures i Allahut) nuk plotësohet vetëm se duke larguar sherrin e armikut të tyre (shejtanit), i cili dëshiron t'i largojë nga ajo dhe të ndërhyjë mes tyre dhe asaj, duke i bërë pjesë e grupit të tij, për të qenë prej banorëve të zjarrit të xhehenemit. Cytjet siç ndodhin nga njerëzit po ashtu ndodhin (vijne) dhe nga xhinët. Prandaj Allahu thotë: **“prej xhindëve apo njerëzve!”**

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve në fillim e mbarim, haptazi dhe fshehtazi! E lusim Atë që t'i plotësojë (përmëshë) mirësitë e Tij ndaj nesh, të na i falë mëkatet, që kanë ndërhyrë mes nesh dhe shumë begative të Tij, dhe të na i fali gabimet dhe dëshirat që kanë hyrë në zemrat tona dhe janë bërë pengesë për meditimin në ajetet e Tij! Shpresojmë tek Ai të mos na privojë nga mirësia që gjendet tek Ai për shkak të së keqes sonë! Shpresën në mëshirën e Allahut s'e humbet askush, përveç jobesimtarëve dhe kush mund ta humbet shpresën nga mëshira e Zotit të vet përveç atyre që janë të humbur! Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin për të Dërguarin e Tij, për familjen e tij dhe për gjithë shokët e tij! Salati dhe salami i përhershëm dhe i vazhdueshëm qoftë mbi ta! Falënderimet i takojnë vetëm Allahut me mirësinë e të Cilit plotësohen veprat e mira!

Pyetje rreth parathënies së librit dhe tefsirit

1. Kush është autori i librit “**Mësime të rëndësishme**”? O Abdulaziz bin Bazi (Allahu e mëshiroftë!). O Muhamed bin Utthejmin (Allahu e mëshiroftë!). O Hejthem Serhan (Allahu e ruajttë!).
2. Përse e mësojmë librin “**Mësime të rëndësishme**”? O Janë mësime të rëndësishme. O Dijetarët kanë këshilluar t’i jepet rëndësi atij (librit). O Në të ka gjëra të rëndësishme për të cilat muslimani ka nevojë. O Të gjitha që u përmendën.
3. Në të gjendet (përfshihet): O Gjendja e muslimanit me Kuranin dhe teuhidin. O Namazi dhe abdesi. O Normat e sjelljes. O Tërheqja e vërejtjes ndaj mëkateve. O Përgatitja e të vdekurit për varrim. O Të gjitha që u përmenden.
4. Muslimani së pari fillon me saktësimin (përmirësimin) e leximit, memorizimin dhe shpjegimin e: O Sures El-Alak. O Sures El-Fatiha. O Sures El-Ihlas.
5. Njerëzit në lidhje me meditimin e Kuranit dhe punës me të ndahen në *tefrit, ifrat* dhe *uesetun*.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
6. Cilën prej librave të tefsirit duhet t’i lexojë së pari nxënësi? O Tefsirin e Ibën Kethirit. O Tefsirin e Ibën Sadij. O Tefsirin e Kurtubiut.
7. Nxënësi së pari fillon me librat e shkurtër/përmbledhës para librave të mëdhenj.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
8. Nxënësi fillon leximin në librave e tefsirit me suret që nxisin në vazhdimin e leximit dhe përsëritjes, si: surja El-Kasas, Merjem dhe El-Kehf.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
9. Nxënësi mund të dëgjojë librat e tefsirit të incizuara nëse leximi i sjell vështirësi (siç është programi i tefsirit i incizuar prej tefsirit të Shejh Es-Sadij).
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
10. Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka tërhequr vërejtjen ndaj atij që e lexon Kuranin dhe nuk mediton rreth domethënies së tij.
 1. E saktë.
 2. E gabuar

Pyetje rreth tefsirit të sures 'El-Fatiha'

11. Është quajtur surja me këtë emër ngase është e rrethuar me mur prej të cilit nuk del dhe hyn asgjë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

12. Është quajtur 'El-Fatiha', sepse:

.....
.....

13. Prej emrave të sures 'El-Fatiha' janë: O Ummul-Kuran. O Es-Seba El-Methanij. O Er-Rukjeh. O Es-Salah. O Të gjitha që u përmenden.

14. 'Istiadha' është detyrë para leximit, edhe pse gjendemi në adhurim (e jo në mëkat), cili është shkaku?

.....
.....
.....

15. Cili është kuptimi i fjalës 'euudhu'?

.....
.....

16. Shejtani është quajtur 'i mallkuar' sepse: O Është larguar nga mëshira. O Goditet me flakërim. O Sulmon njerëzit me epshe dhe dyshime. O Të gjitha që u përmenden.

17. Allahu është: O I Adhuruari që meriton të veçohet, duke e adhuruar me dashuri dhe madhërim. O Askush s'është quajtur me këtë emër përveç Tij. O Emri Allah është referencë për të gjitha emrat. O Thuhet se është emri më i madh i Allahut. O Nuk hiqet elifi (ﻝ) dhe lami (ﻝ) kur i lutemi Allahut. O Të gjitha që u përmenden.

18. Cili është dallimi mes dy emrave të bukur të Allahut 'Er-Rahman' dhe 'Er-Rahim'?

.....
.....

19. Përkujdesja e Allahut ndaj krijesave të Tij është dy llojesh. Cilat janë ato? O E përgjithshme dhe e veçantë. O E pakufizuar e kufizuar.

20. Shumica e lutjeve të profetëve alejhim selam drejtuar Allahut fillojnë me: O Allahumme (d.m.th.: O Allah). O Rabbi (d.m.th.: O Zoti im).

21. 'Jeumid-Din/Dita e llogarisë' është: O Dita e Kiametit. O Dita në të cilën njerëzit do të shpërblehen për veprat e tyre. O Të gjitha që u përmenden.

22. **“Na udhëzo në rrugën e drejtë”** është lutja më përmbledhëse dhe më e dobishme për njeriun.

1. E saktë.
2. E gabuar.

23. **‘Ed-Din’** nënkupton: O Shpërblimin. O Punën/veprën. O Herë shpërblimin e herë punën/veprën.

24. Nga përmendja e shpërblimit të veprës para vepruesit përfitohet: O Kufizim. O Nuk ka asnjë dobi.

25. Dhënia përparësi adhurimit ndaj kërkimit të ndihmës dhe mbështetjes është:

O Si puna e të përgjithshmes ndaj të veçantës.

O E drejta e Allahut mbi robërit e Tij.

O Të gjitha që u përmendën.

26. Përse ka ardhur në shumë ajeti **“Vetëm Ty të adhurojmë”**?

.....
.....

27. **‘El-Ibadeh’** është: O Emri i përgjithshëm i çdo gjëje që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, prej punëve dhe fjalëve të dukshme e të brendshme. O Nënshtrimi ndaj Allahut me kryerjen e urdhëresave dhe lënien e ndalesave, me dashuri dhe madhërim për Të. O Herë është për qëllim e para e herë e dyta.

28. **‘El-Hidajeh’** tek ajeti **“Na udhëzo”** është për qëllim: O Sqarimi i rrugës së drejtë dhe i udhëzimit (në të). O Dhënia e suksesit. O Të dyja së bashku.

29. Te fjala e Allahut **“në rrugën e atyre të cilët i begatove”** janë për qëllim: O Çdokush që ka besuar nga ky umet. O Ata që Allahu i ka begatuar, prej profetëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe të mirëve.

30. Ajeti **“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë”** përmban bashkimin mes legjislacionit dhe kaderit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

31. Cili nga ajetet e mëposhtme përmban çfarë nuk gjendet tek asnjë tjetër? O Surja El-Fatiha. O Ajeti El-Kursij. O Surja El-Ihlas.

32. Fjala e Allahut **“Na udhëzo në rrugën e drejtë”** përmban: O Pohimin e profetësisë. O Kundërpërgjigje ndaj të gjithë bidatçinjve dhe njerëzve të humbur. O Të dyja këto.

33. Fjala e Allahut **“Sundesit të ditës së Gjykimit”** nënkupton se:

- O Shpërblimi bëhet me drejtësi.
- O Njeriu është ai që vepron në të vërtetë.
- O Shpërblimi është vetëm për veprat.
- O Të gjitha këto që u përmenden.

Pyetje rreth komentimit të ajetit El-Kursij

34. Është quajtur Ajeti El-Kursij sepse në të përmendet Kursiju.

- 1. E saktë.
- 2. E gabuar.

35. Cili është ajeti më madhështor në Kuran? O Ajeti që flet për borxhin. O Ajeti që përmend dhjetë të drejtat. O Ajeti El-Kursij.

36. Kurani është madhështor në aspektin e kuptimeve që përmban.

- 1. E saktë.
- 2. E gabuar.

37. Sa prej emrave të bukur të Allahut gjenden tek ajeti El-Kursij? O Pesë. O Gjashtë. O Shtatë.

38. Emri i Allahut “**El-Hajju**” tregon se Ai është absolut: O Në Qenien e Tij. O Në pushtetin e Tij .

39. Emri i Allahut “**El-Kajjum**” tregon se Ai është absolut: O Në Qenien e Tij. O Në pushtetin e Tij.

40. Kur përmenden së bashku emrat “**El-Hajju**” dhe “**El-Kajjum**”, kjo tregon se Ai është absolut në Qenien dhe pushtetin e Tij.

- 1. E saktë.
- 2. E gabuar.

41. Emri i Allahut “**El-Hajju**” është përmendur pranë me emrin “**El-Kajjum**” në Kuran: O Në tri vende. O Në katër vende. O Në dy vende.

42. Duhet patjetër, sa i përket cilësive mohuese, t’i mohojmë për Allahun ato që Ai ka mohuar për Vetën e tij dhe që i ka mohuar i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke pohuar të kundërtën, ngase mohimi është dëlirësi, p.sh.: mohojmë për Allahun dremitjen dhe gjumin, për shkak të jetës absolute (të plotë) të Tij.

- 1. E saktë.
- 2. E gabuar.

43. Allahu nuk lejon askënd të ndërmjetësojë përveç atij me të cilin Ai është i kënaqur. Dhe Ai nuk është i kënaqur përveçse me:

- O Teuhidin.
- O Pasimin e të dërguarve.
- O Të gjitha që u përmendën.

44. Ato që Allahu ua ka treguar krijesave prej çështjeve sheriatike dhe kaderije janë:

- O Pak.
- O Shumë.

45. Ajeti “**Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave**” përfshinë të tashmen dhe të ardhmen. Kurse “**dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre**” përfshinë të shkuarën.

1. E saktë.
2. E gabuar.

46. Domethënia e emrit të Allahut “**El-Alijju/ i Larti**” është:

- O I Lartësuar me Qenien e Tij.
- O I Lartësuar me cilësitë e Tij.
- O Ai i Cili i ka nënshtruar të gjitha krijesat.
- O Të gjitha që u përmendën.

47. Kush e lexon atë natën është i mbrojtur nga Allahu dhe s’i afrohet shejtani derisa të gdhihet. Për kë bëhet fjalë?

- O Për dy ajetet e fundit të sures El-Bekare.
- O Për Ajetin El-Kursij.

48. Ajeti “**El-Kursij**” lexohet:

- O Në përfundim të namazeve obligative.
- O Kur bie për të fjetur.
- O Në mëngjes dhe në mbrëmje.
- O Të gjitha që u përmendën.

Pyetje rreth komentimit të sures “Ez-Zelzeleh”

49. Surja “**Ez-Zelzeleh**” është sure:

- O Mekase.
- O Medinase.

50. Te surja “**Ez-Zelzeleh**” ka: O Kërcënim. O Inkurajim. O Të dyja këto.

51. Fjala e Allahut “**Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit)**” është e ngjashme me fjalën “**ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje**”. Taha: 106-107.

1. E saktë.
2. E gabuar.

52. Fjala e Allahut “**kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj**” d.m.th.:

Malet dhe kodrat.

Të vdekurit dhe thesaret.

53. Toka është prej dëshmitarëve që do të dëshmojnë kundër njerëzve me punët e tyre.

1. E saktë.

2. E gabuar.

54. Fjala e Allahut “(njerëzit) **do të paraqiten**” d.m.th.: Një nga një. Të ndarë në grupe të ndryshme.

55. Fjala e Allahut “**kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë...**” është e ngjashme me fjalën e Tij “**Aty do të gjejnë të shënuar gjithçka që kanë punuar**”. El-Kehf: 49.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Adijati”

56. Surja “**El-Adijati**” është:

1. Mekase.

2. Medinase.

57. Fjala “**El-Adijat**” nënkupton: Kuajt. Çdo gjë që lëvizë. Të gjitha që u përmendën.

58. Surja “**El-Adijati**” përmban kërcënim për çdo kënd që nuk përmbush të drejtat obligative.

1. E saktë.

2. E gabuar.

59. Sqaro kuptimin e fjalëve të mëposhtme:

“**dabhan**”

“**kad’han**”

“**nek’an**”

“**lekenuud**”

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Kariah”

60. Surja “**El-Kariah**” është:

Mekase.

Medinase.

61. Prej qëllimeve të sures “**El-Kariah**” është paralajmërimi prej:

Tmerret e Ditës së Kiametit.

Sprovat e dynjasë.

62. “**El-Kariah**”: Janë ajetet kërcënuese. Është Dita e Kiametit

63. Sqaro kuptimin e fjalëve më poshtë:

“**Kelferashil-mebthuth**”

“**Kel’ihnin-menfuush**”

64. Peshoret e përmendura në këtë sure janë:

Peshore të vërteta.

Është metaforë e përdorur për drejtësinë (por s’ka peshore).

65. “**ai do të ketë një jetë të kënaqur**” d.m.th.: Në dynja. Në Xhenet.

66. “**Ai do të ketë si strehim Humnerën** (e Xhehenemit)” d.m.th.:

Zjarri do të jetë i përhershëm për të.

Ai do hidhet me kokë poshtë në zjarr.

Të dyja këto.

67. Fjala e Allahut “**Kush mund të ta shpjegojë ty se ç’është Humnera** (e Xhehenemit)?” përmban:

Njoftim për madhësitinë e tij (Zjarrit).

Pyetje për të.

68. Prej emrave të Zjarrit janë: El-Havijeh. Xhehenem. El-Hutameh. Ledha. Es-Seir. Sekar. Të gjitha që u përmenden.

69. Zjarri i xhehenmit sa herë më i nxehtë (madh) është krahasim me zjarrin e dynjasë?

Shtatëdhjetë herë. Nëntëdhjetë herë. Nëntëdhjetë e nëntë herë.

Pyetje rreth komentimit të sures “Et-Tekathur”

70. Surja “**Et-Tekathur**” është:

Mekase.

Medinase.

71. Kjo sure përmban:

Njoftimin për gjendjen e njerëzve.

Qortimin e njerëzve nga preokupimi me dynjanë dhe jo me atë për të cilin u krijuan.

72. Në këtë sure ka ndalim nga grumbullimi (i pasurisë apo gjërave të tjera) edhe nëse synohet me këtë Fytyra e Allahut.

1. E saktë.

2. E gabuar.

73. Shprehja “**u përcoll për në banesën e fundit**”: O Mohon ringjalljen. O Lejohet të përdoret (s’ka problem).

74. Te fjala e Allahut “**derisa të shkoni në varre**” janë quajtur ‘vizitorë’ dhe nuk janë quajtur ‘banues’ (në varre). Përse?

O Sepse Berzahu (jeta e varrit) është vendbanimi i ndërmjetëm mes jetës së kësaj bote dhe botës tjetër.

O Sepse ata kaluan nga shtëpitë e tyre (në dynja) për në varre.

75. Dituria ndahet në tri pjesë: “**ilmun jekin**”, “**ajnu jekin**” dhe “**hakku jekin**”.

1. E saktë.

2. E gabuar

Pyetje rreth komentimit të sures “**El-Asr**”

76. Surja “**El-Asr**” është:

O Mekase.

O Medinase.

77. Surja “**El-Asr**” përmban argument rreth katër çështjeve: dijes, punës/veprës, thirrjes së njerëzve (në fe) dhe durimit.

1. E saktë.

2. E gabuar.

78. Cila nga shprehjet e mëposhtme është e saktë sa i përket betimit në tjetër kënd përveç Allahut?

O Allahu betohet në këdo prej krijesave të Tij.

O Krijesat duhet të betohen vetëm në Allahun.

O Krijesat betohen edhe në dikë tjetër përveç Allahut.

O Përgjigja e parë dhe e dytë.

79. Durimi ndahet në: O Dy pjesë. O Tre pjesë. O Katër pjesë.

80. Surja përmban katër urdhëresa, me dy të parat njeriu përsos veten e tij, kurse me dy të tjerat përsos (përmirëson) të tjerët.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “**El-Humezeh**”

81. Kjo sure është:

O Mekase.

O Medinase.

82. Kuptimi i fjalës “**Uejlun-Mjerë**” nënkupton:

Luginë në Xhehenem.

Kërcënim që përfshinë luginën në Xhehenem dhe gjëra të tjera.

83. ‘**El-Hummaze**’ është ai që fyen dhe i tall njerëzit me fjalë, kurse ‘**El-Lummaze**’ është ai që i përqesh dhe i tall me veprime.

1. E saktë.

2. E gabuar.

84. Nga domethënia e fjalës së Allahut “**duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm**” përfitohet se bamirësia e shton jetën.

1. E saktë.

2. E gabuar.

85. Domethënia e fjalës së Allahut “**E kush mund të ta shpjegojë ty**” është se Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: E dinte atë. Nuk e dinte atë.

86. Te fjala e Allahut “**Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort**” lënda djegëse e të cilit janë: Njerëzit. Gurët. Të dyja së bashku.

87. Fjala e Allahut “**i cili depërton deri në zemrën e njeriut**” d.m.th.: Çfarë ti beson. Nga trupat depërton në zemra.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Fil”

88. Surja “**El-Fil**” është sure:

Mekase .

Medinase.

89. Në këtë sure ka mësim se kafsha më e madhe frikësohet të sulmojë shtëpinë (Qabenë) e Allahut. Kështu që, njeriu është më meritor që të frikësohet më shumë.

1. E saktë.

2. E gabuar.

90. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem lindi: Në vitin e Elefantit. Në vitin e pikëllimit. Në vitin Er-Ramadeh (e urisë).

91. Kjo sure është prej mrekullive që tregon për profetësinë e Profetit tonë sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

1. E saktë.

2. E gabuar.

92. Përmend kuptimin e shprehjeve të mëposhtme:

“**Tajran ebabil**” d.m.th.....

“Keasfim-me’kuul” d.m.th.....

Pyetje rreth komentimit të sures “Kurajsh”

93. Surja “**Kurajsh**” është sure:

O Mekase.

O Medinase.

94. Kjo sure ka lidhje me suren: O El-Fil. O El-Kafirun. O En-Nas.

95. Udhëtimet e kurajshëve ishin në dimër për në Sham, kurse në verë ishin drejt Jemenit.

1. E saktë.

2. E gabuar.

96. Allahu lartësoi shenjtërinë e Qabesë dhe banorëve të saj në zemrat e arabëve aq sa të gjithë i nderonin dhe nuk i preknin: O Në Meke. O Në Meke dhe udhëtim.

97. Allahu e ka veçuar Qabenë me përmendje se ‘është Zoti i Shtëpisë’ për të treguar vlerën dhe rëndësinë e saj, edhe pse Ai është Zoti i gjithçkaje.

1. E saktë.

2. E gabuar.

98. “**Rabbi hadhal-Bejt**”, në këtë rast krijesa i adresohet Krijuesit të saj në formë nderimi.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Maun”

99. Surja “**El-Maun**” është:

O Mekase.

O Medinase.

100. Kuptimi i fjalës “Ed-Din” te fjala e Allahut të Lartësuar: “**A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë**” është: O Ringjallja dhe shpërblimi për veprat e bëra. O Huamarrja dhe mohimi i të drejtave.

101. Kuptimi i fjalës “**Jed’uu**” është: O E lë. O E largon me forcë.

102. Jetim konsiderohet ai të cilit i ka vdekur: O Babai. O Nëna.

103. Jetim quhet ai/ajo: O Që nuk e ka arritur ende moshën e pjekurisë. O Edhe pasi ta ketë arritur.

104. Ai që tregohet i pakujdesshëm ndaj namazit me vetëdije, meriton të qortohet dhe të fajësohet. Ndërsa, pakujdesia nga harresa është diçka që u ndodh të gjithëve.

1. E saktë.
2. E gabuar.

105. Gjykimi për syfaqësinë është: E lejuar. E urryer. E ndaluar. Shirk i vogël. Shirk i madh.

106. Në këtë sure ka nxitje për kryerjen e veprave të mira.

1. E saktë.
2. E gabuar.

107. “**El-Maun**” në ajet nënkupton: Enët. Çdo gjë që njihet në traditë, që jepet e dhurohet.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Keuther”

108. Surja “**El-Keuther**” është:

- Mekase.
- Medinase.

109. “**El-Keuther**” nënkupton: Lumë. Mirësitë e shumta.

110. Allahu ka veçuar me përmendje dy adhurime, sepse ato janë adhurimet më të mira dhe që të afrojnë më shumë tek Ai.

1. E saktë.
2. E gabuar.

111. “**Shaanieke**” d.m.th.: Ai që të urren. Ai që të fyen. Ai që ta ulë pozitën. Të gjitha që u përmenden.

112. “**Huvel-ebter**” tregon se përmendja dhe lavdërimi ndaj Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do të vazhdojë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

113. Në këtë sure ka argument se ndihmuesit dhe pasuesit e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem do të jenë të shumtë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Kafirun”

114. Surja “**El-Kafirun**” është: Mekase. Medinase.

115. Surja “**El-Kafirun**” lexohet në rekatën e parë pas sures “**El-Fatiha**” në: Sunetet e sabahut. Sunetet e akshamit. Sunetet e tavafit. Në namazin e vitrit. Në të gjitha që u përmendën.

116. Adhurimi i shoqëruar me shirk është: Adhurim i mangët. Nuk quhet (konsiderohet) adhurim.

117. Me “**Kul-Thuaj**” i drejtohet: Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe të tjerëve.

118. Jobsimtarët janë: Të gjithë ata që u ka arritur thirrja e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe nuk kanë besuar në të. Siç janë Çifutët dhe të krishterët. Jobsimtarët e Mekes

119. Kjo sure përmban realizimin e distancimit nga shirku dhe idhujtarët, me zemër, gjuhë dhe gjymtyrë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

120. Përsëritja e ajetit në këtë sure: Është për përforsim. Tregon së pari për mos ekzistencën e veprimit dhe së dyti se kjo është cilësi e pandashme e tyre.

Pyetje rreth komentimit të sures “En-Nasr”

121. Surja “**En-Nasr**” është:

- Mekase.
- Medinase.

122. Kjo sure përmban përgëzim, njoftim dhe urdhrin për paralajmërim.

1. E saktë.
2. E gabuar.

123. Ky umet dhe kjo fe kanë mëshirën dhe mirësinë e Zotit që askush nuk mund ta imagjinojë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

124. Në këtë sure ka shenjë se të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ishte afruar vdekja.

1. E saktë.
2. E gabuar.

125. Duke punuar me këtë sure, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e shpeshonte në ruku dhe në sexhde thënien: “*Subhaneke Allahumme Rabbena ue bihamdik, Allahumme g'firl!*”.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Mesed”

126. Surja “**El-Mesed**” është:

Mekase.

Medinase.

127. Ebu Lehebi është: Xhaxhai i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Nuk ka lidhje farefisnore me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

128. Është i qortuar dhe i poshtëruar deri në ditën e Kiametit: Ebu Lehebi. Çdo kush që armiqëson Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

129. Përmend kuptimin e fjalëve më poshtë.

“**Tebbet**”.....

“**Ma kesebe**”.....

“**Xhidiha**”.....

“**Mesed**”.....

130. Në këtë sure ka një mrekulli prej mrekullive të Allahut të Lartësuar në lidhje me Ebu Lehebin dhe gruan e tij, (ku u nënkuptuar se) ata s’u bënë muslimanë.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Ihlas”

131. Surja “**El-Ihlas**” është:

Mekase.

Medinase.

132. Është quajtur me këtë emër sepse ajo: Përmban përshkrimin e sinqertë dhe të pastër të Allahut. Lexuesin e saj e shpëton nga shirku. Të dyja këto.

133. Kjo sure konsiderohet në shpërblim: Sa gjysma e Kuranit. Sa çereku i Kuranit. Sa një e treta e Kuranit.

134. Surja “**El-Ihlas**” lexohet në rekatën e dytë pas sures “**El-Fatiha**” në: Sunetet e sabahut. Sunetet e akshamit. Sunetet e tavafit. Në namazin e vitrit. Pas namazeve obligative. Kur bie për të fjetur. Të gjitha që u përmendën.

135. Surja “**El-Kafirun**” dhe “**El-Ihlas**” lexohen ditën dhe natën në mënyrë që të realizohen tri llojet e teuhidit.

1. E saktë.

2. E gabuar.

136. Në suren “**El-Ihlas**” gjendet: Teuhidi El-Uluhijeh (i adhurimit). Teuhidi Er-Rububijeh dhe teuhidi i emrave dhe attributeve të Allahut.

137. “**Kul-Thuaj**” nënkupton: Vetëm shprehjen me gjuhë. Shprehjen me gjuhë, punën me gjymtyrë dhe besimin me zemër.

138. Fjala e Allahut “**Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm**” d.m.th. i Vetëm në rububijeh, në uluhijeh dhe në emrat dhe atributet e Tij.

1. E saktë.

2. E gabuar.

139. Fjala e Allahut “**Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim**” d.m.th.:

Ai është synimi i të gjithë krijesave për nevojat e tyre.

Ai që s’ka nevojë për askënd dhe të tjerët janë të nevojshëm për Të.

Ai që është i Përsosur në rububijen e Tij, në uluhije dhe në emrat dhe cilësitë e Tij.

Të gjitha që u përmendën.

140. T’i adresosh Allahut djalë apo prind konsiderohet kufër i madh.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Pyetje rreth komentimit të sures “El-Felek”

141. Surja “**El-Felek**” është:

Mekase.

Medinase.

142. Surja “**El-Felek**” lexohet: Pas namazeve obligative. Kur bie për të fjetur. Të dyja këto.

143. Përmend kuptimin e fjalëve të mëposhtme:

“**Eudhu**”.....

“**El-Felek**”.....

“**Gasikin**”.....

“**En-Neffathatu**”.....

“**El-Ukad**”.....

“**Hasidin**”.....

144. Kjo suren përmban: Mbrojtjen dhe strehimin tek Allahu nga krijesat në përgjithësi dhe ato në veçanti. Magjia është e vërtetë. Të gjitha që u përmendën.

Pyetje rreth komentimit të sures “En-Nas”

145. Surja “**En-Nas**” është:

- Mekase.
- Medinase.

146. Surja “**En-Nas**” lexohet:

- Pas namazeve obligative.
- Kur bie për të fjetur.
- Të dyja këto.

147. Cili është kuptimi i fjalës “**El-Khannas**”?

.....

Shtyllat e Islamit

Sqarimi i pesë shtyllave të Islamit. E para e tyre dhe më e madhja është dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, shoqëruar me shpjegimin e kuptimit të saj dhe sqarimin e kushteve të fjalës La ilahe il-IAllah. Kuptimi i “la ilahe” është mohim i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut, ndërsa “il-IAllah” është pohimi i adhurimit për Allahun, Një të vetëm e të Pashoq. Kushtet e fjalës “La ilahe il-IAllah” janë:

1. Dija, e kundërta e saj është injoranca.
2. Siguria/bindja, e kundërta e saj është dyshimi.
3. Sinqeriteti, e kundërta e tij është shirku.
4. Vërtetësia, e kundërta e saj është përgënjeshtrimi.
5. Dashuria, e kundërta e saj është urrejtja.
6. Dorëzimi/nënshtrimi, e kundërta është refuzimi, braktisja.
7. Pranimi, e kundërta e tij është refuzimi.
8. Mohimi i asaj që adhurohet përveç Allahut.

Të gjitha këto janë përmbledhur në dy vargje:

“Dija, bindja, sinqeriteti dhe vërtetësia jote e shoqëruar me dashurinë, nënshtrimin dhe pranimin e saj. Shto dhe të tetën e saj, të mohosh çdo të adhuruar përpos Allahu, nga gjërat që adhurohen.”

Kjo, e shoqëruar me sqarimin e dëshmisë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, e cila përmban besimin në atë që ai njofton, bindjen ndaj tij në atë që urdhëron, largimin nga ajo që ai ka ndaluar dhe të mos adhurohet Allahu ndryshe përveçse me atë që ai e ka ligjësuar.

Pastaj, nxënësit i sqarohet pjesa tjetër e shtyllave të Islamit, të cilat janë: falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit në Shtëpinë e Shenjtë (Qabe) për atë që ka mundësi.

Shtyllat e fjalës La ilahe il-Allah

Mohimi “**la ilahe**”- mohimi i çdo gëje që adhurohet përveç Allahut (mohimi i tagutëve).

Pohimi “**il-Allah**”- pohimi i adhurimit për Allahun, një e të vetëm (besimi në Allahun).

Fjala e singëritetit (La ilahe il-Allah) ka dy shtylla, e ato janë: mohimi dhe pohimi. Prandja, memorizoi ato.

Shpjegimi i kushteve të fjalës “la ilahe il-Allah”

Kushtet e fjalës “**La ilahe il-Allah**” janë si shembull i “dhëmbëve (të çelësit)” për çelësin. Pra, fjala “**la ilahe il-Allah**” është çelësi i Xhenetit, ndërsa çelësi nuk e hap derën përveç nëse është i pajisur me dhëmbëza. Prandaj, çdo gjë që transmetohet në Kuran dhe Sunet, se kush thotë “**la ilahe il-Allah**” ka këtë apo atë shpërblim, s’mund të arrihet ai shpërblim përveçse duke përmbushur këto kushte. E ato janë tetë:

1. Dija rreth kuptimit të saj. E kundërta e saj (dijes) është injoranca rreth kuptimit të saj. Prandaj, kush s’e di kuptimin e fjalës *La ilahe il-Allah*, ai s’ka dobi prej saj. Nisur nga kjo, del si detyrë për atë që dëshiron të hyjë në Islam, që ta mësojë kuptimin e saj. I Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë: “*Kush vdes duke e ditur se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, do të hyjë në Xhenet.*” Shënon Muslimi.

2. Siguria/bindja e plotë (100%). Nëse personi dyshon një përqind (1%) në mohimin të tagutëve, ose heshtë, ose lëkundet, ai nuk konsiderohet njëgues. Nëse dyshon në kufrin e çifutëve dhe të krishterëve të cilëve u ka arritur thirrja e Muhamedit sal-Allahu alejhi ue sel-lem, ai nuk konsiderohet njëgues. Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem thotë: “*Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut. Njeriu nuk e takon Allahun me këto dy fjalë duke mos dyshuar (aspak) në to, vetëm se e shtie në Xhenet.*” Shënon Muslimi.

3. Singëriteti. Kush ka syfaqësi në thënien e kësaj fjale (duke e bërë sa për sy të njerëzve), ose bën shirk të madh, si ai që adhuron dikë tjetër përveç Allahut, ajo nuk i bën aspak dobi atij. Transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ka thënë: “Njeriu më i lumtur me ndërmjetësimin tim është ai që thotë *La ilahe il-Allah me singëritet nga zemra apo shpirti i tij.*” Shënon Buhariu

4. Vërtetësia. Kush e thotë këtë fjalë duke qenë përgënjeshtues, siç është munafiku, ajo s’i bën aspak dobi atij. Transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ka thënë: “Nuk ka njeri që dëshmon se s’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, me singëritet nga zemra e tij, vetëm se Allahu ia ndalon zjarrin atij.” Shënon Buhariu dhe Muslimi.

5. Dashuria- ta dojë Allahun dhe të mos e dojë dikë tjetër bashkë me Allahun, si dhe të dojë çdo gjë që Allahu ka urdhëruar për ta dashur. E kundërta e saj është urrejtja. Andaj, prej asgjësuesve të Islamit është: “Kush urren diçka nga ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, edhe nëse e punon atë, ai ka mohuar. I Madhëruari thotë: “**E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu**”.

6. Nënshtrimi. Patjetër duhet të punohet me të. Kush e lë punën me të, fjala *La ilahe ilAllah* nuk i bën aspak dobi atij. I Madhëruari thotë: “**Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht**”.¹

7. Pranimiti. Pra, fjala, vepra dhe bindja mos ta kundërshtojnë këtë fjalë. I Madhëruari thotë: “**Kur u thuhej atyre: “Nuk ka ka të adhuruar tjetër të vërtetë veç Allahut!” - ata tregoheshin mendjemëdhenj dhe thoshin: “Vallë, a t’i braktisim hyjnitë tona për shkak të një poeti të marrë?”**”¹

8. Mohimiti. D.m.th.: çdo gjë që adhurohet përveç Allahut adhurimi i tij është i kotë. Dhe askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut.

Kujdes! Fjala e singëritetit (*La ilahe il-Allah*) duhet patjetër të shoqërohet me fjalë, punë dhe besim.

Llojet e dashurisë

Të duash dikë tjetër bashkë me Allahun.

Kjo hyn te shirku i madh. I Madhëruari thotë: **“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu”**.

Dashuria për Allahun.

Kjo është detyrë (vaxhib). Madje, kjo është prej lidhjes më të fortë të besimit. I Madhëruari thotë: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre”**. Kjo dashuri përfshin katër gjëra:

Dashuria natyrore.

Kjo është e lejueshme, por me kusht që mos t'i paraprijë dashurisë ndaj Allahut (Allahun duhet ta duash më shumë se çdo gjë), p.sh. dashuria për prindërit dhe gruan. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Askush nga ju s'ka besuar derisa unë të jem më i dashur tek ai sesa fëmija e tij, prindërit e tij dhe njerëzit në përgjithësi.”*

Të duash punën me të cilën Allahu i Lartësuar është i kënaqur. E ajo është çdo gjë me të cilën ka ardhur feja, siç është teuhidi.

Të duash vepruesin e asaj pune (që e do Allahu), siç janë profetët, të dërguarit, engjëjt, sahabët dhe çdo njësuës.

Të duash kohët të cilat Allahu i Lartësuar i do, p.sh.: nata e Kadrit dhe një e treta e fundit e natës.

Të duash vendet që Allahu i Lartësuar i do, p.sh.: Meka dhe Medina.

**Cili është kuptimi i fjalës “është rob i tij”
te dëshmia “Muhamedi është i Dërguari i Allahut”?**

Kjo d.m.th.: Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk adhurohet, sepse ai nuk posedon asgjë prej veçorive të rububijes, uluhijes dhe esmau ues-sifat (emrave dhe attributeve të Allahut)

Dhe se ai ishte më i përlururi/nënshtruar ndaj Allahut në mesin e mbarë krijesave. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e realizoi përlulësinë/nënshtrimin në formën e përsosur.

Ndarja e përlulësisë ndaj Allahut

E përgjithshme:

E ajo është përlulësia/nënshtrimi ndaj Allahut, që ia bën çdo krijesë. I Lartësuar thotë: “S’ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit”. Në të hyn besimtari dhe jobesimtari.

E veçantë:

E ajo është përlulësia/nënshtrimi i atyre që i binden Allahut dhe e adhurojnë Atë. I Lartësuar thotë: “Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë...” Kjo përfshinë çdokënd që e adhuron Allahun e Lartësuar me sheriatin e Tij.

Më specifika:

E ajo është përlulësia/nënshtrimi i të dërguarve alejhim salam. I Lartësuar thotë: “Me të vërtetë ai ka qenë rob falënderues”. Përlulësia/nënshtrimi që i atribuohet profetëve është më specifiku, ngase askush s’mund të krahasohet me profetët për sa i takon përlulësisë/nënshtrimin të

Fragmente nga jetëshkrimi i Profetit ﷺ

Ai është Muhamed bin Abdullah bin Abdulmutalib bin Hashim. Hashimi është nga kurajshët, kurajshët janë prej arabëve, ndërsa arabët janë prej pasardhësve të Ismailit, birit të Ibrahimit alejhis-selam.

Prejardhja e
tij:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lindur në Meke, në muajin Rabi'u El-Evel në vitin e Filit. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem jetoj gjashtëdhjetë e tri vite, dyzet prej tyre para profetësisë dhe njëzet e tri i kaloi si Profet dhe i Dërguar. Ai u rrit jetim, babai i tij vdiq para se ai të lindte. Për të u kujdes gjyshi i tij, Abdulmutalibi, ndërsa pas vdekjes së gjyshit u kujdes xhaxhai i tij, Ebu Talibi.

Lindja e
tij:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërgua për xhinët dhe njerëzit. Prandaj, çdokujt që i arrin thirrja e tij dhe nuk beson në të, ai konsiderohet jobesimtar, kushdo qoftë ai.

Dërgimi i
tij:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ftoi në teuhid (në veçimin e Allahut në adhurim), në moralet e larta e në punët e mira dhe ndaloi nga shirku, nga moralet e punët e këqija.

Thirrja e tij
alejhis-
selam:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shkoi nga Meka për në Bejtul-Makdis, prej aty u ngjiti në qiellin e shtatë, ku Allahu i foli atij dhe u bë obligim falja e pesë namazeve.

Israja dhe
Miraxhi:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem migroi nga Meka për në Medine, qytet në të cilin edhe vdiq. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u varros në dhomën e nënës së besimtarëve, Aishes radijAllahu anha.

Hixhreti
dhe vdekja
e tij:

Allahu i Lartësuar me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e plotësoi fenë. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem qartësisht e përcolli fenë, e kreu amanetin, e këshilloi umetin e tij dhe luftoi në rrugë të Allahut me të gjitha format e xihadit.

Përcjellja e
Shpalljes:

Ato janë shtatë: Bedri, Uhudi, Hendeku, Hajberi, çlirimi i Mekës, Tebuku dhe beteja e Hunejnit.

Betejat më të rëndësishme të tij:

Kasimi, Ibrahim, Abdullahu, Zejnebe, Rukajeh, Ummu Kulthumi dhe Fatimja. Të gjithë, përveç Fatimes e cila vdiq gjashtë muaj pas vdekjes së tij, vdiqën gjatë jetës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata!

Shtatë fëmijët e tij:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka pasur dymbëdhjetë bashkëshorte (në kohë të ndryshme). E ato janë: Hadixhja radijAllahu anha, Aishja radijAllahu anha, Seudeh radijAllahu anha, Hafsa radijAllahu anha, Zejneb El-Hilalijeh radijAllahu anha, Ummu Selemeh Hindi radijAllahu anha, Zejneb bintu Xhahsh radijAllahu anha, Xhujejrieh bintu El-Harith radijAllahu anha, Safijeh bintu Hujejjin radijAllahu anha, Ummu Habibeh Ramleh radijAllahu anha, Rihaneh bintu Zejd radijAllahu anha dhe Mejmuneh bintu El-Harith radijAllahu anha.

Gratë e tij:

Nëna e tij Amineh bintu Uehb, robëresha e Ebu Lehebit (xhaxhait të Profetit) Theuejbeh dhe Halimeh bintu Ebi Dhuvejb Es-Seadijeh radijAllahu anha.

Gjdhënëset e tij:

Është fjala e Allahut të Lartësuar në suren 'El-Alak'; **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi, ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte”**.

Gjëja e parë që iu shpallë atij:

Prej burrave: Ebu Bekër Es-Siddiku radijAllahu anhu, ndërsa nga gratë është nëna e besimtarëve, Hadixhe bintu Huvelid radijAllahu anha. Prej fëmijëve është Ali bin Ebi Talib. Prej shërbyesve Zejd bin El-Harith radijAllahu anhu. Ndërsa, prej robërve është Bilal bin Rabah radijAllahu anhu.

Njerëzit e parë që i besuan atij alejhis-selam:

Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka kryer katër umra, të gjitha në muajin Dhulkade. Për sa i përket haxhit, ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bërë vetëm një haxh, i cili njihet si “*Haxhi i lamtumirës*”. Këtë e ka kryer në vitin e dhjetë të hixhretit.

Haxhi dhe umra e tij:

I Lartësuari thotë: “**Me të vërtetë ti** (o Muhamed) **je në shkallën më të lartë të moralit**”. Nëna e besimtarëve, Aishja radijAllahu anha, ka thënë: “*Morali i tij ishte Kurani.*”

Morali i tij alejhis-selam:

Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Përderisa lumturia e robit në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër është e lidhur me udhëzimin e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, atëherë për çdokënd që dëshiron të mirën për veten e tij, shpëtimin dhe lumturinë, del detyrë të njohë/mësojë udhëzimin e tij, historinë e tij dhe çështjet e tij alejhis-selam, aq sa të dalë nga grupi i të paditurve në këtë fushë e të hyjë në grupin e pasuesve të tij. Njerëzit në raport me këtë ndahen në të tillë që kanë pak njohuri, shumë (njohuri) dhe të privuar (s’kanë njohuri). E gjithë mirësia është në dorën e Allahut, i Cili ia jep kujt të dojë! Allahu është Dhuruesi i mirësive të pakufishme!”

Rëndësia e studimit të jetëshkrimit të tij:

Mësimi i tretë

Shtyllat e besimit

Shtyllat e besimit janë gjashtë: të besosh në Allahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij, në ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin (paracaktimin) se e mira dhe e keqja e tij janë nga Allahu i Lartësuar.

Përkufizimi i 'El-Iman' në legjislacionin Islam

Ai (besimi) është shprehje me gjuhë, besim me zemër, punë me gjymtyrë dhe shtyllë. Ai shtohet me bindje dhe pakësohet me mëkate. Argumenti:

Se besimi është shprehje me gjuhë është fjala e tij alejhis-selam: “*më e larta e tij (besimit) është fjala La ilabe il-Allah*”.

Se besimi është punë me gjymtyrë është fjala e tij alejhis-selam: “*më e ulëta e tij (besimit) është largimi i pengesës nga rruga*”.

Se besimi është puna e zemrës është fjala e tij alejhis-selam: “*edhe turpi është degë e besimit*”.

Se besimi shtohet është fjala e Allahut: “**Kujt prej jush do t'ia shtojë besimin...**”

Se besimi pakësohet është fjala e tij alejhis-selam: “*nuk kam parë më të mangëta në mendje dhe fe (sesa gratë)*”.

Shkaqet e shtimit të besimit

Mësimi i teuhidit dhe në veçanti tema e emrave dhe cilësive të Allahut.

Shtimi i veprave të mira.

Lënia e mëkateve.

Meditimi rreth krijesave të Allahut.

Shkaqet e pakësimit të besimit

Mosmësimi i teuhidit, e në veçanti i temës së emrave dhe cilësive të Allahut.

Lënia e veprave të mira.

Kryerja e mëkateve.

Mosmeditimi rreth krijesave të Allahut.

Gjashtë shtyllat e besimit

Besimi në Allahun.	Besimi në engjëjt.	Besimi në librat.	Besimi në të dërguarit	Besimi në ditën e Fundit.	Besimi në kaderin, të mirën dhe të keqen e tij.
--------------------	--------------------	-------------------	------------------------	---------------------------	---

Shtylla e parë Besimi në Allahun bën detyrë:

Besimi në ekzistencën e Allahut. E kjo është me katër gjëra:	Besimi në rububijen e Allahut të Lartësuar.	Besimi në uluhijen e Allahut të Lartësuar.	Besimi në emrat dhe atributet e Allahut të Lartësuar.
--	---	--	---

Me logjikë: Është e pamundur që mendja imagjinojë ekzistencën e krijesave pa Krijues.	Me shqisat: Njeriu kur përballët me ndonjë vështirësi të madhe i ngre duart drejt qiellit dhe thotë: ‘O Zot’. Dhe kjo vështirësi largohet me lejen e Allahut.	Fitra: Profeti alejhisselam thotë: <i>“Çdo njeri lind në natyrshmërinë e pastër, por janë prindërit ata që e kthejnë në fenë çifute, ose në fenë krishtere, ose në zjarrputist.”</i>	Me anë të fesë: Ibën El-Kajjimi (Allahu e mëhsiroftël) ka përmendur se s’ka ajet në librin e Allahut vetëm se në të ka argument për teuhidin.
---	---	--	---

Shtylla e dytë: Besimi në engjëjt

Engjëjt janë botë e fshehtë. Allahu ata i ka krijuar prej dritës. Engjëjt i binden Allahut dhe kurrë s’e kundërshtojnë Atë. Ata kanë shpirtira **“Shpirti i shenjtë”**, kanë trupa **“Lavdërimi qoftë për Allahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë”**, kanë logjikë dhe zemra: **“Kur t’u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë: “Çfarë tha Zoti juaj?”** Ne besojmë në ta dhe në atë që na ka treguar Allahu në lidhje me emrat e tyre, si Xhibrili, Mikaili dhe Israfil. Besojmë dhe në cilësitë e tyre **“të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ato”**. Po ashtu besojmë dhe në punët e tyre.

Disa prej punëve të engjëjve për të cilat jemi njoftuar

Prej tyre tetë janë që mbajnë Arshin (Fronin). Xhibrili është ngarkuar me Shpalljen, Mikaili me shiun etj. Besojmë në të gjithë ata dhe në njoftimet që kanë ardhur rreth tyre (engjëjve), në formë të përgjithshme dhe të hollësishme.

Shtylla e tretë: Besimi në librat

Është detyrë besimi se ato (librat) janë në të vërtetë fjala e Allahut, ato janë të shpallura dhe nuk janë të krijuar dhe se Allahu me çdo të dërguar ka zbritur (shpallur) dhe një libër. Ne besojmë në to dhe në atë që na ka njoftuar Allahu prej emrave të tyre (librave), njoftimeve të tyre dhe dispozitave të tyre në formë të përgjithshme dhe të hollësishme, përderisa nuk është abroguar. Besojmë se Kurani i ka shfuqizuar të gjitha librat e zbritur para tij. E ato janë: Tevrati, Ungjilli, Zeburi dhe Fletushkat e Ibrahimit dhe ato të Musait alejhim selam.

Shtylla e katërt: Besimi në të dërguarit

Është detyrë të besojmë se të dërguarit janë njerëz dhe nuk posedojnë asgjë prej veçorive të rububijes. Ata janë robër dhe nuk adhurohen. Allahu i ka dërguar ata dhe u ka shpallur dhe i ka ndihmuar me mrekulli. Ata e kryen amanetin, e këshilluan popullin dhe ia kumtuan shpalljen dhe luftuan në rrugë të Allahut. Besojmë në ta dhe në ata që na ka njoftuar Allahu prej emrave të tyre, cilësive të tyre dhe njoftimeve të tyre, në formë të përgjithshme dhe të hollësishme. I pari i profetëve është Ademi alejhis-selam, ndërsa i pari i të dërguarve është Nuhu alejhis-selam. Kurse, vula e profetëve dhe të dërguarve është Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Besojmë se të gjitha legjislacionet e mëparshme janë shfuqizuar me legjislacionin e Muhamedit sal-lAllahu allejhi ue sel-lem. Profetët më të zgjedhur (Ulul-Azmi) të cilët janë përmendur në dy sure “Esh-Shura” dhe “El-Ahzab” janë pesë: Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, Nuhu alejhis-selam, Ibrahim alejhis-selam, Musai alejhis-selam dhe Isai alejhis-selam.

Shtylla e pestë: Besimi në ditën e Fundit

Kjo përmban besimin në çdo gjë për të cilën ka njoftuar Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem, që do të ndodhë pas vdekjes, si: sprova e varrit, fryrja në Sur, dalja e njerëzve nga varret e tyre, vendosja e peshoreve, regjistrat (ku janë shënuar veprat), Ura (e vendosur mbi xhehenem), Haudi, ndërmjetësimi, Xheneti, Zjarri, shikimi tek Allahu nga ana e besimtarëve ditën e Kiametit dhe në Xhenet dhe të tjera prej gjërave të fshehta.

Shtylla e gjashtë:

Besimi në kaderin, të mirën dhe të keqen e tij

Ai është katër shkallë:

Dija	Shkrimi	Vullneti	Krijimi
Besimi se Allahu e ka ditur çdo gjë në formë të përgjithshme dhe të hollësishme. Argument është fjala e Tij: “Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve” .	Besimi se Allahu i ka shkruar kaderet e çdo gjëje deri në ditën e Kiametit. Argument për këtë është fjala e Tij: “S’ka asgjë të fshehtë në qiell dhe në Tokë, që të mos jetë e shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)” .	Besimi se atë që do Allahu ekziston dhe atë që s’e do, ajo nuk ekziston. Robi ka dëshirë, porse ajo është nën dëshirën e Allahut. I Madhëruari thotë: “Por ju s’mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut” .	Besimi se robi dhe punët e tij janë të krijuara. Po ashtu dhe të gjitha gjërat e tjera. Argument për këtë është fjala e Tij: “Allahu është Krijuesi i çdo gjëje” . Dhe “Allahu është Ai që ju ka krijuar juve dhe gjithçka që bëni” .

Pjesët e teuhidit dhe të shirkut

Sqarimi i pjesëve të teuhidit, e ato janë tri: teuhidi er-rububijeh, teuhidi el-uluhijeh dhe teuhidi esmau ues-sifat. **Teuhidi er-rububijeh** është besimi se Allahu i Lartësuar është Krijuesi i gjithçkaje, i Cili posedon dhe sistemon çdo gjë dhe është Një i vetëm dhe i Pashoq në të gjitha këto. **Teuhidi el-uluhijeh** është besimi se Allahu i Lartësuar është Ai që meriton të adhurohet me të drejtë dhe s'ka shok në këtë gjë. Ky është dhe kuptimi i fjalës La ilahe il-lAllah, ngase domethënia e saj është se s'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Të gjitha adhurimet, si: namazi, agjërimi etj., duhet të kryhen me sinqeritet vetëm për Allahun, Një e të vetëm dhe nuk lejohet që diçka prej tyre t'i përkushtohet dikujt tjetër përveç Tij. **Ndërsa, teuhidi esmau ues-sifat** është besimi në çdo gjë që ka ardhur në Kuran, apo në hadithet autentike prej emrave të Allahut dhe attributeve të Tij. Kështu që, pohoi ato për Allahun, Një e të vetëm ashtu siç i takon madhësisë së Tij pa i shtrembëruar, pa i mohuar, pa pyetur 'si' dhe pa i përngjasuar (me ato të krijesave). Duke punuar me fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”** Dhe me fjalën e Tij: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha”**.¹ Disa dijetarë e kanë ndarë në dy pjesë (teuhidin) duke e futur teuhidin esmau ues-sifat në teuhidin er-rububijeh. Nuk ka asgjë të keqe (paqartësi) në këtë, sepse qëllimi është mëse i qartë në të dy ndarjet. Pjesët e shirkut janë tri: **shirku i madh, shirku i vogël dhe shirku i fshehtë. Shirku i madh** i asgjëson të gjitha punët dhe bën që personi të jetë përgjithmonë në zjarr nëse vdes në këtë gjendje, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Por, nëse ata adhurojnë zota të tjerë, do t'u humbë çdo gjë nga ajo që kanë bërë”**.¹ I Madhëruari thotë: **“Nuk u takon idhujtarëve të përkujdesen për faltoret e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë”**.¹ Kush vdes në shirkun e madh, atij s'i falen gjynahet dhe i ndalohet hyrja në Xhenet, siç thotë Allahu i Madhëruar: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë”**. I Madhëruari thotë: **“Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t'ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës”**.

Prej llojeve të tij (shirkut të madh) është lutja drejtuar të vdekurve dhe idhujve, kërkimi i ndihmës prej tyre, zotimi për ta, bërja kurban për ta dhe gjëra të ngjashme. **Shirku i vogël** është ai që cilësohet në tekstet e Kuranit dhe Sunetit me emrin shirk, porse ai s'i takon shirkut të madh, siç është syfaqësia në kryerjen e disa veprave, betimi në dikë tjetër përveç Allahut, thënia “çfarë të dojë Allahu dhe filani” e të ngjashme me to. Bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “*Gjëja që më së shumti frikësohem për ju është shirku i vogël.*” Ai alejhis-selam u pyet për të dhe tha: “*Syfaqësia*”. Dhe në fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “*Kush beton në diçka tjetër përveç Allahut, ka bërë shirk*”. Dhe fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “*Mos thoni ‘Çfarë të dojë Allahu dhe filani’, por thoni: ‘Çfarë të dojë Allahu, pastaj filani.’*” Shënon Ebu Daudi me zinxhir të saktë nga Hudhejfe bin El-Jeman radijAllahu anhu. Ky lloj i shirkut nuk të nxjerrë nga Islami dhe as nuk e bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në zjarrin e xhehenemit. Porse, ai mohon përsosmërinë e teuhidit, gjë e cila është detyrë. Ndërsa, lloji i tretë është **shirku i fshehtë**. Argumenti për këtë është fjala e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “*Vini re! A t’ju njoftoj për atë që më së shumti frikësohem për ju sesa Mesihu Dexha!*” Thanë: “Sigurisht, o i Dërguari i Allahut.” Tha: “*Shirku i fshehtë. (Kjo është kur) Ngrihet personi për t’u falur dhe e zbuluron namazin e tij për shkak të shikimit të njerëzve që e shohin atë.*” Lejohet që shirku të ndahet në dy lloje: në të madh dhe në të vogël. Ndërsa, shirku i fshehtë përfshihet tek të dyja ato. Shirku i madh është si shirku i munafikëve, sepse ata e fshihnin besimin e tyre të kotë dhe shfaqin Islamin sa për sy e faqe duke u frikësuar për vetët e tyre. Ndërsa, shirku i vogël është, si: syfaqësia që u përmend më herët në hadithin e Mahmud bin Lebid El-Ensarij dhe në hadithin e Ebu Seid El-Hudrij. Allahu është dhuruesi i suksesit!

Ndarja e ndalesave

Shirku i madh: Ky është më i larti.

Shirku i vogël: Ky është më i vogël sesa shirku i madh dhe më i madhi nga mëkatet e mëdha.

Mëkatet e mëdha: Është çdo mëkat për të cilin parashikohet një ndëshkim i caktuar, si: mallkim, dëbim nga mëshira e Allahut, distancim nga vepruesi, ose që vepruesi është prej jobesimtarëve a idhujtarëve, apo nuk është prej besimtarëve, apo përngjasohet me kafshët më të këqija.

Mëkatet e vogla: Është çdo gjë që e ka ndaluar legjislacioni dhe s'ka lidhur (përmendur) me ndonjë dënim të veçantë.

Mëkatet e mëdha

<p>Numri i tyre: Nuk janë të kufizuar në numër, porse kufizohen sipas rregullit të përmendur më sipër.</p>	<p>Gjykimi për vepruesin e tyre:</p> <p>-Besimtar me besim të mangët, ose besimtar me besimin e tij dhe i prishur për shkak të mëkatit të madh që ka vepruar.</p> <p>-Ta duam në varësi të besimit që posedon dhe ta urrejmë në varësi të mëkatit të madh në të cilin ka rënë.</p> <p>-Nuk ulesh me të gjatë kohës së bërjes së mëkatit të madh.</p>	<p>Shkallët e tyre:</p> <p>Mëkatet e mëdha ndryshojnë nga njëra-tjetra.</p> <p>Bazuar në fjalën e Profetit alejhis-selam: “<i>Vini re! A t’ju njoftoj për mëkatet më të mëdha?</i>”</p>	<p>Gjykimi për to:</p> <p>Duhet patjetër pendim i sinqertë. Bazuar në fjalën e Profetit alejhis-selam: “<i>Vajtuesja nëse nuk pendohet para vdekjes së saj...</i>” Muslimi.</p> <p>Në një hadith tjetër ka thënë: “<i>Nëse u largohesh mëkateve të mëdha...</i>” Muslimi</p>
---	---	--	---

Dallimi mes shirkut të vogël dhe të madh

<p style="text-align: center;">Shirku i madh:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të nxjerrë nga feja. 2. I asgjëson të gjitha punët. 3. E bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në Xhehenem. 4. E bën të lejuar gjakun dhe pasurinë nga ana e prijësit. 5. Të ketë argument (nga Kurani e suneti) që tregon se është shirk i madh. 6. Nuk falet nëse personi vdes në atë gjendje. 7. Nëse personi pendohet Allahu ia pranon pendimin, përpos dy rasteve: kur dielli lind nga perëndimi dhe kur shpirti i vjen në fyt. 	<p style="text-align: center;">Shirku i vogël:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk të nxjerrë nga feja. 2. Nuk i asgjëson të gjitha punët, porse disa punë të veçanta. 3. Nuk e bën detyrë qëndrimin përgjithmonë në Xhehenem. 4. Nuk e bën të lejuar gjakun dhe pasurinë. 5. Të ketë argument (nga Kurani e suneti) që tregon se është shirk i vogël. 6. (Është shirk i vogël) Kur konsiderohet diçka si shkak, të cilin Allahu i Lartësuar s’e ka ligjësuar si të tillë. 7. Çdo mjet që të shpie drejt shirkut të madh konsiderohet se është shirk i vogël. 8. Çdo gjë që feja e ka konsideruar shirk apo kufër dhe s’ka ardhur me një shqese ‘el’, ajo konsiderohet shirk i vogël, përderisa s’ka diçka të afërt që tregon se është shirk i madh.
--	---

Mësimi i pestë

Ihsani

Shtylla e Ihsanit është: “Ta adhurosh Allahun e Lartësuar ashtu siç je duke e parë Atë, edhe pse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.”

Ihsani ka vetëm një shtyllë, por nën të janë dy shkallë

Kur adhurimi kryhet sikur je duke e shikuar Allahun.

Ai është adhurimi që kryet me dëshirë, me dashuri dhe përmallim për atë që gjendet tek Allahu i Lartësuar. Ky është adhurimi i profetëve dhe i të dërguarve, si fjala e tij sal-Allahu alejhi ue sel-lem: “*A mos të jem rob falënderues?*” Kjo shkallë nxitë në kryerjen e adhurimit duke e bërë me dëshirë, dashuri e përmallim, gjithashtu i shoqëruar me shpresë e frikë.

Kur adhurimi kryhet duke e ndier mbikëqyrjen e Allahut mbi ty.

Ai është adhurimi i kryer me frikë nga e cila nuk del muslimani.

Pyetje rreth teuhidit

1. Sa janë shkallët e fesë? Tri. Dy. Pesë.
2. Sa është numri i shtyllave të Islamit? Pesë. Gjashtë. Shtatë.
3. Islami është shkallë më e lartë se besimi:
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
4. Sa është numri i shtyllave të dëshmisë së singëritetit (La ilahe il-Allah)? Shtatë. Tetë. Dy.
5. Sa është numri i kushteve të fjalës ‘**La ilahe il-Allah**’? Tetë. Shtatë. Pesë.
6. Dituria është prej kushteve të fjalës ‘**La ilahe il-Allah**’. Cili është kuptimi i diturisë?
 Perceptimi i diçkaje në formën që është. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut.
7. Nëse dyshon në kufirin e atij që i ka arritur thirrja (e saktë Islame) dhe nuk beson, gjykimi ndaj tij është: Ka bërë kufër të madh. Nëse bindja është më e madhe sesa dyshimi, ai nuk konsiderohet jobesimtar
8. Pranimi është prej kushteve të fjalës ‘**La ilahe il-Allah**’ dhe me të është për qëllim: Fjala. Vepra. Besimi. Të gjitha që u përmendën.
9. Syfaqësia te fjala ‘**La ilahe il-Allah**’ është njësoj si syfaqësia në dhënien e lëmoshës, pra është prej shirkut të vogël.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
10. Kush thotë me gjuhën e tij ‘**La ilahe il-Allah**’ duke mos besuar me zemër, ai është:
 Njësues. Musliman, por jo besimtar. Jobesimtar që ka bërë kufër të madh. Me besim të dobët.
11. Nëse e do Profetin sal-Allahun alejhi ue sel-lem si dashuria që ke për Allahun (me dashuri të barabartë) kjo është: Kufër i madh. Kufër i vogël. Prej mëkateve të mëdha.
12. Sa lloje të dashurisë kemi? Katër. Tri. Dy.
13. Dashuria për Allahun është për veprën, vepruesin, kohën dhe vendin.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.

14. Gjykimi për atë që e do dikë tjetër bashkë me Allahun: Shirk i vogël. Detyrë. Shirk i madh.

15. Gjykimi i dashurisë për Allahun: E lejuar. Detyrë. Shirk i madh.

16. Sa është numri i ndarjes së ubudijes (të qenit rob i Allahut)? Dy. Tre. Katër.

17. Të gjitha krijesat janë robër të Allahut të nënshtruara me forcë, madje dhe jobesimtarët.

1. E saktë.

2. E gabuar.

18. Nëse personi thotë ‘**La ilahe il-Allah**’, por nuk vepron asnjë vepër, nuk falet dhe nuk bën asgjë prej adhurimeve, kjo gjë: I bën dobi. Nuk i bën aspak dobi.

19. Fjala ‘**abduhu ue rasuluhu**’ te dy dëshmitë, d.m.th.: rob që nuk adhurohet dhe i dërguar që nuk përgënjeshtrohet.

1. E saktë.

2. E gabuar.

20. Te dëshmia ‘**enne Muhameden abduhu ue rasuluhu**’ hyn ‘bindja ndaj tij në ato që urdhëron dhe besimi në ato që njofton...’ Kjo konsiderohet: Prej kuptimeve të saj. Prej përmbajtjes së saj.

21. Kush beson se Profeti sal-Allahun alejhi ue sel-lem ka diçka prej veçorive të rububijes, ai nuk ka dëshmuar se ai është rob i Allahut.

1. E saktë.

2. E gabuar.

22. Cilësimi i lartë që i është bërë Profetit sal-Allahun alejhi ue sel-lem është se ai: Është i Dërguari i Allahut. Është rob dhe i Dërguari i Allahut. Është vula e profetëve.

23. “Kush shpik në Islam një bidat duke e konsideruar të mirë, ai ka pretenduar se Muhamedi sal-Allahun alejhi ue sel-lem e ka tradhtuar Shpalljen, ngase Allahu i Lartësuar thotë: “**Sot përsosa për ju fenë tuaj**”. Prandaj, ajo që nuk ka qenë fe atë ditë nuk është fe as sot”. Këtë e ka thënë: Dijetari i Islamit Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!). Imam Maliku (Allahu e mëshiroftë!). Imam Ibën Bazi (Allahu e mëshiroftë!).

24. Profeti sal-Allahun alejhi ue sel-lem është prej pasardhësve të Profetit: Is’hak alejhis-selam. Ismail alejhis-selam.

25. Plotëso: Profeti sal-Allahun alejhi ue sel-lem u lind në vitin në qytetin e..... Ai jetoi, i kaloi para profetësisë dhe si Profet dhe i Dërguar. U bë Profet me dhe i Dërguar me

26. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u dërgua te: Populli i tij. Te njerëzit. Te xhinët dhe njerëzit.

27. Miraxhi është udhëtimi i Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga Mekja për në Bejtul-Makdis.

1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem migroi për në: Taif. Abisini. Medine. Në të gjitha që u përmendën.

29. Sa beteja kanë qenë më të rëndësishmet që ka bërë Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem? Një. Dy. Tre. Katër. Pesë.

30. Sa është numri i fëmijëve të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem? Tre. Katër. Shtatë.

31. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem bëri haxhin e lamtumirës. Kjo tregon se ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e kishte kryer haxhin dhe para tij (haxhit të lamtumirës).

1. E saktë.
2. E gabuar.

32. Studimi i jetëshkrimit të Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është: Detyrë. E pëlqyeshme. E lejuar.

33. Plotëso: Besimi në legjislacionin fetar është fjala me, besimi me dhe puna me Ai shtohet me dhe pakësohet me

34. Sa është numri i shtyllave të besimit? Gjashtë. Pesë. Katër.

35. Besimi në Allahun e bën detyrë besimin në disa gjëra. Sa është numri i tyre? Katër. Tre. Dy.

36. Argumentet e përgjithshme që tregojnë për ekzistencën e Allahut janë: Katër. Nuk mund të kufizohen.

37. Mikaili është engjëlli i ngarkuar me rënien e shiut.

1. E saktë.
2. E gabuar.

38. Vetëm bijtë e Ademit (njerëzit) kanë zemër, kurse engjëjt nuk kanë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

39. Sa është numri i librave qiellorë të cilat i njohim me emra? Gjashtë. Katër. Shtatë. Shumë.

40. Allahu i Lartësuar çdo të dërguari i ka zbritur (shpallur) libër.

1. E saktë.
2. E gabuar.

41. I Dërguari i parë është Ademi alejhis-selam.

1. E saktë .
2. E gabuar.

42. Muhamedi sal-Allahue sel-lem është i Dërguar dhe nuk është Profet.

1. E saktë.
2. E gabuar.

43. Sa është numri i ‘**Ulul-Azmi**’ prej të dërguarve? Pesë. Katër. Shumë.

44. Besimi në ditën e Fundit përmban besimin në çdo gjë që do të ndodhë pas vdekjes deri në daljen e njerëzve nga varret e tyre.

1. E saktë.
2. E gabuar.

45. Besimi në kada dhe kader ka disa shkallë, sa është numri i tyre? Katër. Pesë. Tre.

46. A i di Allahu gjërat para se ato të ndodhin? Po. Jo.

47. A di Allahu çdo gjë që dinë njerëzit? Po. Jo.

48. A e ka shkruar (paracaktuar) Allahu çdo gjë që njerëzit e dinë? Po. Jo.

49. Robi ka vullnet dhe dëshirë të pavarur dhe bën çfarë të dojë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

50. Teuhidi ndahet në: Dy pjesë. Tri pjesë. Nuk ka asnjë problem në këto ndarje (qoftë dy apo tre).

51. Përmend pesë dallime mes shirkut të madh dhe shirkut të vogël.

1.
2.
3.
4.
5.

54. Përmend pesë shembuj për shirkun e vogël dhe për shirkun e madh.

Shirku i madh:

.....
.....
.....
.....

Shirku i vogël:

.....
.....
.....
.....
.....

54. Nifaku në besim është shirk i vogël që nuk të nxjerrë nga feja.

1. E saktë.
2. E gabuar.

55. Ihsani përmban: Një shtyllë të vetme. Dy shtylla

Mësimi i gjashtë

Kushtet e namazit

Kushtet e namazit janë shtatë: **1.** Islami. **2.** Logjika. **3.** Dallimi. **4.** Marrja abdes ose gusël. **5.** Largimi i papastërtisë. **6.** Mbulimi i aurretit. **7.** Hyrja e kohës. **8.** Drejtimi kah Kibla. **9.** Qëllimi (nijeti).

Kushti i parë: Islami

E kundërta e tij është kufri (mohimi). Kështu që, nëse personi i cili shan Zotin, falet apo diçka prej adhurimeve ia përkushton dikujt tjetër përveç Allahut, namazi i tij është i kotë, përveç nëse ai pendohet sinqerisht tek Allahu i Lartësuar.

Kushti i dytë: Logjika

E kundërta e saj është çmenduria, ndërsa humbja e mendjes nga ana e pijanecit është më parësore.

Kushti i tretë: Dallimi

Nuk është për qëllim arritja e moshës së pjekurisë, por është për qëllim dallimi midis gjërave. Pra, njeriu të njohë pyetjen nga përgjigjja. Kjo s'ka një moshë të përcaktuar, por në të shumtën e rasteve personi arrin të bëjë dallim midis gjërave në moshën shtatë vjeçare. Kur e fal namazin fëmija i vogël? E fal kur është në gjendje të dallojë midis gjërave. Pra, të njohë pyetjen nga përgjigjja dhe dallimin midis zjarrit dhe ujit. Në të kundërtën, nëse s'është në gjendje të bëjë dallimin midis gjërave, namazi i tij është i kotë.

Kushti i katërt:
Marrja e abdesit ose gusulit
Në të hyn:

dhe largimi i papastërtisë së vogël (urinës, gazrave etj.) me anë të abdesit.

largimi i papastërtisë së madhe me larjen e tërësishme të trupit.

Kushti i pestë: Largimi i papastërtive

Largimi i papastërtive nga trupi, vendi i faljes dhe rrobat. Nëse personi falet duke pasur papastërti, duke qenë i vetëdijshëm për të dhe ka mundësi ta largojë atë, namazi i tij është i pavlefshëm. Largimi i papastërtive ndahet në tri pjesë:

Papastërtia e rëndë (mugaledhah): Ajo është papastërtia e qenit. Profeti sal-Allahu alejhi ue sellem ka urdhëruar që ena në të cilën pi qeni të lahet shtatë herë, e herën e parë të pastrohet me dhe'. Shënon Muslimi.

Papastërti e lehtë (muhafefeh): Kjo papastërti largohet me spërkatje pa e shtrydhur rrobën. Kjo veprohet në urinën e djalit të vogël i cili nuk ka filluar të hajë ushqim. Po ashtu el medhijde el menij (sperma) edhe pse konsiderohen të pastra, por Profeti alejhis-selam e spërkaste me ujë kur ishte e njomë dhe e gërryente kur ishte e thatë

Papastërti mesatare (mutevessitah): Kjo papastërti largohet me larje, me spërkatje dhe shtrydhje të rrobës. Kjo është si për mugaledhah dhe mutevesitah, si p.sh.: urina e burrit, urina e gruas e të tjera prej papastërtive.

Papastërtitë që janë të papastra më vete

Të tilla janë urina e njeriut, jashtëqitja e tij dhe urina e bajgat e kafshëve që nuk u hahet mishi. Të gjitha egërsirat konsiderohen të papastra, përveç atyre që është vështirë shmangia e tyre, siç është macja, mushka dhe gomari, gjaku i cili del nga kafsha pas therjes së saj, gjaku që del nga dy rrugët e jashtëqitjes dhe të ngordhurat. Përveç njeriut të vdekur dhe atyre që s'kanë gjak që u rrjedh, siç janë e ngordhura e detit dhe karkaleci.

Kushti i gjashtë: Mbulimi i auresit

Aureti është tre llojesh:

Muhaffefeh: Ai është aureti i fëmijës 7-10 vjeç. Në të përfshihen pjesët e turpshme (organi gjenital dhe pjesa mbrapa).

Mugaledhah: Ai është aureti i gruas së lirë dhe të rritur (që ka kaluar kohën e pubertetit). Detyrë për të është të mbulojë të gjithë trupin e saj përveç fytyrës. Por, në prani të personave të huaj ajo duhet ta mbulojë atë (fytyrën).

Mutevessitah: Ai është aureti, përveç atyre që u përmendën më sipër, i personit nga mosha dhjetë e sipër; aureti për të është nga kërthiza deri te gjunjët. Është e pëlqyeshme mbulimi i shpatullave duke marrë zbukurimin e plotë.

Kushti i shtatë: Hyrja e kohës

Nuk saktësohet namazi i falur para kohe dhe as pas saj (kohës). Përveç rastit kur personi me arsyetim bashkon mes dy namazeve. E nëse ai qëllimisht e vonon namazin nga koha e tij, ngarkohet me gjynah.

Kushti i tetë: Drejtimi kah Kibla

Nga kjo përjashtohet falja e namazit vullnetar (nafile) në udhëtim. Në këtë rast ai falet në atë drejtim që kthehet kafsha e tij. Njëjtë si kjo, në kohën tonë, është namazi i falur në avion. Po ashtu, nga kjo përjashtohet ai që s'ka mundësi të kthehet në drejtim të Kibles ose i frikësohet armikut.

Kushti i nëntë: Qëllimi (nijeti)

Vendi i qëllimit (nijetit) është zemra, ndërsa shqiptimi i tij me gojë është bidat. Nëse personi vjen disa momente para namazit apo bën thjesht nijetin (me zemër) për faljen e farzit të kohës, namazi i tij është i saktë.

Dy vërejtje të rëndësishme

1. Në lënien e ndonjë kushti, nuk pranohet: padituria, harresa apo vetëdija, përveç rastit kur njeriu falet duke pasur papastërti dhe nuk e di këtë, apo harron (ta largojë) atë, atëherë namazi i tij është i saktë, ngase kjo është prej *lënies* dhe jo prej *veprimit*.
2. Kushtet janë jashtë adhurimit dhe i paraprijnë atij. Prandaj, duhet patjetër ekzistenca e tyre (kushteve) deri në përfundim të adhurimit.

Mësimi i shtatë

Shtyllat e namazit

Shtyllat e namazit janë katërmbëdhjetë:

1. Qëndrimi (El-Kijjam) në këmbë duke pasur mundësi.
2. Tekbiri fillestar.
3. Leximi i sures El-Fatiha.
4. Rukuja.
5. Ngritja nga rukuja dhe qëndrimi drejt.
6. Bërja e sexhdes mbi shtatë gjymtyrë.
7. Ngritja nga sexhdja.
8. Ulja midis dy sexhdeve.
9. Qetësia në të gjitha veprimet e namazit.
10. Kryerja e shtyllave sipas radhës.
11. Teshehudi i fundit.
12. Ulja në të.
13. Dërgimi i salavateve për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sellem.
14. Dy selamet (dhënia selam në anën e djathtë dhe në anën e majtë).

Shtylla e parë: Qëndrimi në këmbë duke pasur mundësi

Në namazin obligativ: Qëndrimi në këmbë është shtyllë në namazin obligativ dhe bie nga ai që s'ka mundësi të qëndrojë në këmbë, ose ka mundësi të qëndrojë në këmbë por nuk përqendrohet në namaz (për shkak të dhimbjeve etj.). Nëse ka mundësi të qëndrojë në këmbë qoftë dhe pak, ai duhet të qëndrojë.

Në namazin vullnetar (nafile): Falja e namazit vullnetar ulur është i saktë, por personi merr gjysmën e shpërblimit të namazit të falur në këmbë. Po ashtu, namazi i falur shtrirë i kthyer anash, është i saktë dhe merr gjysmën e shpërblimit të namazit të falur ulur.

Shtylla e dytë: Tekbiri fillestar

Nuk lejohet asnjë shprehje tjetër përveç fjalës “Allahu ekber”.

Shtylla e tretë: Leximi i sures El-Fatiha

Është detyrë leximi i saj në çdo rekat të namazit, qoftë ai namaz pa zë apo me zë. Leximi i saj bëhet i plotë sipas radhës së ajeteve. Leximi i saj bie nga ai që e arrin imamin në ruku.

Shtylla e nëntë: Qetësia në të gjitha veprimet e namazit

Qetësia arrihet duke thënë dhikrin vaxhib në çdo shtyllë.

Vërejtje të rëndësishme

Shtyllat gjenden brenda adhurimit. Adhurimi nuk pranohet nëse lihet një shtyllë prej shtyllave, qoftë nga padituria, apo harresa, apo vetëdija. Shtylla e lënë nuk kompensohet (zëvendësohet) me bërjen e sexhdes së harresës, por personi urdhërohet ta përsërisë namazin aktual. Ndërsa, për namazet që ka falur duke lënë në to ndonjë prej shtyllave të namazit, ai është i justifikuar, ngase Profeti sal-llAllahu alejhi ue sel-lem nuk e urdhëroi atë që nuk u fal mirë që t'i përsëriste të gjitha namazet, por e urdhëroi ta përsëriste namazin aktual, edhe pse ai kishte lënë pa e plotësuar qetësinë (khushuu), e cila është prej shtyllave të namazit. Allahu e di më së miri!

Mësimi i tetë

Detyrat (vaxhibet) e namazit

Detyrat e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret, përveç tekbirit fillestar.
2. Thënia ‘SemiAllahu limen hamideh’ për imamin dhe atë që falet vetëm.
3. Thënia ‘Rabbena ue lekel-hamd’ për të gjithë.
4. Thënia ‘Subhane Rabbijel-adhim’ në ruku.
5. Thënia ‘Subhane Rabbijel-eala’ në sexhde.
6. Thënia ‘Rabbig firli’ ndërmjet dy sexhdeve.
7. Teshehudi i parë.
8. Ulja në teshehudin e parë.

Vërejtje e rëndësishme

Është detyrë që në ruku të thuhet tekstualisht: ‘*Subhane Rabbijel-adhim*’, pastaj është e pëlqyeshme që namazliu herë pas here të shtojë prej dhikreve që transmetohen. Po ashtu, dhe në sexhde duhet të thuhet tekstualisht: ‘*Subhane rabbijel-eala*’, pastaj mund herë pas here të shtojë prej dhikreve që transmetohen.

Sqarimi i teshehudit

Sqarimi i teshehudit është (që të thuhet): *“Et-tehijjatu lil-lahi ues-salauatu uet-tajjibatu, es-selamu alejke ejjuben-nebijju¹ ue rahmetullahi ue berakatuhu, es-selamu alejna ue ala ibadil-lahis-salihin, esh'bedu en la ilabe il-Allah, ue esh'bedu enne Muhammeden abdubu ue rasulubu”*.

Pastaj dërgon salavate për Profetin sal-Allahue alejhi ue sel-lem duke thënë: *“Allahumme sal-li ala Muhamedin ue ala ali Muhamedin, kema sal-lejte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid. Ue barik ala Muhamedin ue ala ali Muhamed kema barakte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid”*.

Pastaj në teshehudin e fundit i kërkon mbrojtje Allahut që ta ruajë nga dënimi i xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprova e jetës dhe e vdekjes dhe nga sprova e mesihut Dexhal.

Pastaj të zgjedhë çfarë të dojë prej lutjeve, e në veçanti ato që transmetohen nga Profeti sal-Allahue alejhi ue sel-lem. Prej tyre *“Allahumme ei'nni ala dhikrike ue shukrike ue husni ibadetike.” “Allahumme inni dbalemtu nefsi dhulmen kethiran ue la jagfirudh-dhunube il-la ente fagfirl magfiraten min indek uerhamni inneke entel-gafurur-rabim”*.

Ndërsa, në teshehudin e parë, personi ngrihet për në rekatin e tretë të namazit të drekës, ikindisë, akshamit dhe të jaxisë pas dy dëshmimeve. Por, nëse ai dërgon salavate për Profetin sal-Allahue alejhi ue sel-lem (në teshehudin e parë) kjo është më e mira, bazuar në përgjithësim e haditheve që kanë ardhur në lidhje me të. Pastaj ngrihet për në rekatin e tretë.

Mësimi i dhjetë

Sunetet e namazit

Sunetet e namazit janë:

1. Lutja e fillimit të namazit.
2. Vendosja e pëllëmbës së djathtë mbi të majtën mbi gjoks gjatë qëndrimit në këmbë, para rukusë dhe pas saj.
3. Ngritja e duarve deri në lartësinë e supeve ose të veshëve duke i pasur gishtat të bashkuar dhe të shtrirë. Duart ngrihen në tekbinin fillestar, kur shkon në ruku, kur ngrihesh nga rukuja dhe kur ngrihesh prej teshehudit të parë për në rekatin e tretë.
4. Thënia e dhikrit të rukusë dhe sexhdes më shumë se një herë.
5. Shtimi mbi “Rabbena ue lekel hamd” (thënia e dhikreve të tjera në vend të saj herë pas here, prej dhikreve që transmetohen të thuhesh në këtë pozitë) pas ngritjes nga rukuja dhe thënia më shumë se një herë e dhikrit ndërmjet dy sexhdeve.
6. Vendosja e kokës në një drejtim me trupin gjatë rukusë.
7. Largimi i dy krahëve në të dy anët, largimi i barkut prej kofshëve dhe largimi i kofshëve nga dy kërcinjët e këmbës në sexhde.
8. Ngritja e bërrylave nga toka gjatë sexhdes.
9. Ulja e namazliut mbi këmbën e tij të majtë të shtrirë dhe ngritja e këmbës së djathtë në teshehudin e parë dhe ndërmjet dy sexhdeve.
10. Et-Teverruk në teshehudin e fundit në namazin me katër dhe tre rekate. E ajo është duke i vendosur vithet në tokë, këmbën e majtë e futë poshtë të djathtës dhe e ngre të djathtën duke i ngulitur (në tokë) gishtërinjtë e këmbës të kthyer kah kibla.

11. Bërja me shenjë me gishtin tregues në teshehudin e parë dhe në të dytin, që nga ulja deri në përfundimin e teshehudit. Gishtin e levizë gjatë kohës kur lutesh.

12. Dërgimi i salavateve për Profetin sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, për familjen e tij, për Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit, në teshehudin e parë.

13. Lutja në teshehudin e fundit.

14. Leximi me zë në namazin e sabahut, në namazin e xhumasë, në namazin e bajramit, në namazin e kërkimit të shiut dhe në dy rekatet e para të namazit të akshamit e të jacisë.

15. Leximi pa zë (me zë të ulët, sa e dëgjon veten) në namazin e drekës, në namazin e ikindisë, në rekatën e tretë të namazit të akshamit dhe në dy raketet e fundit të namazit të jacisë.

16. Shtimi (i leximit të ndonjë sure apo ajeteve) pas leximit të sures El-Fatiha.

Kërkohet gjithashtu të tregohet kujdes (në zbatimin) e atyre që transmetohen prej suneteve në namazit (përpos atyre që përmendëm), e prej tyre janë: shtimi mbi thënien ‘Rabbena ue lekel-hamd’ pas ngritjes nga rukuja për imamin, xhematin dhe atë që falet vetëm, sepse kjo është sunet. Po ashtu, prej tyre është vendosja e duarve mbi gjunjë gjatë rukusë duke i hapur gishtërinjtë.

Lutja e fillimit të namazit

Lutja e fillimit të namazit thuhet pas tekbirit fillestar, prej atyre (lutjeve) që transmetohen nga Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, siç është: “*Allabumme ba'id bejni ue bejne kbatajaje kema ba'adte bejnel-meshrik uel-magrib. Allabumme nekkini minel-kbataya kema junekka eth-theubel-ebjedu mined-denes. Allabumme gsilni min kbatajaje bil-mai ueth-thelxb uel-berad*”, ose “*Subhaneke Allabumme ue bihamdike, ue tebarakesmuke, ue teaale xhed-duke, ue la ilahe gajruke*”.

Mësimi i njëmbëdhjetë

Gjërat që e prishin namazin

Gjërat që e prishin namazin janë tetë:

1. Të folurit qëllimisht, e jo nga harresa, duke e ditur se diçka e tillë e prishë namazin. Ndërsa, ai që flet nga harresa apo nga padituria (nuk e di gjykimin), namazi i tij me këtë nuk konsiderohet i pavlefshëm.
2. E qeshura.
3. Ngrënia.
4. Pirja.
5. Zbulimi i auresit.
6. Devijimi i shumtë nga ana e Kibles.
7. Lëvizje e shumta të një pas njëshme në namaz.
8. Prishja e abdesit.

E para: Të folurit qëllimisht, e jo nga harresa, duke e ditur se diçka e tillë e prishë namazin:

Nga kjo përjashtohet korrigjimi i imamit kur harron apo gabon në lexim.

Situatat e lëvizjeve në namaz

Lëvizjet që ndalohen.	Lëvizjet e urryera:	Lëvizjet e lejuara:	Lëvizjet e pëlqyeshme	Lëvizjet vaxhib:
Janë lëvizjet e shumta të një pas njëshme dhe të panevojshme, siç është ngrënia.	Janë lëvizjet e lehta, të panevojshme siç është kthimi i lehtë (paktë).	Janë lëvizjet e nevojshme, siç është fërkimi i mjekrës.	: Janë lëvizjet që lidhen me plotësimin e namazit, siç është mbyllja e hapësirave.	Janë lëvizjet që kanë të bëjnë me saktësimin e namazit, siç është largimi i papastërtisë.

Vërejtje e rëndësishme

Më parë kemi përmendur kushtet e namazit, shtyllat e tij, obligimet dhe sunnetet, andaj cili është dallimi midis tyre?

Kushti	Shtylla	Obligimi	Sunnetet
Ai që gjendet jashtë adhurimit (i paraprinë adhurimit).	Janë ato që gjenden brenda adhurimit		
Vazhdon në çdo adhurim.	Kufizohen në një pjesë prej pjesëve të adhurimit.		
Njeriu nuk arsyetohet në lënien e tij nga padituria, nga harresa dhe me vetëdije.	Njeriu arsyetohet për lënien e tij nga padituria, nga harresa, por nuk arsyetohet nëse e lë me vetëdije.	Njeriu arsyetohet për lënien e tij nga padituria, harresa dhe me vetëdije.	
Nuk ka për të sexhde të harresës.	Nuk kompensohet (zëvendësohet) me sexhde të harresës.	Kompensohet (zëvendësohet) me sexhde të harresës.	/

Sexhdja e harresës

Shkaqet e bërjes së sexhdes së harresës janë tri:

Shtimi: të shtojë një ruku, ose sexhde, ose qëndrimin në këmbë (kijjam), ose një ulje.

Mangësimi: të mangësojë një vaxhib prej vaxhibeve të namazit dhe t'i kalojë radha.

Dyshimi: të jetë në dyshim se sa rekate ka falur, tre apo katër. Kjo është dy lloje:

Dyshimi pas mbarimit të adhurimit:

Kësaj s'i jepet aspak rëndësi derisa të vijë bindja (siguria).

Dyshimi gjatë adhurimit:

Nëse është i shumtë, nuk i jepet rëndësi e nëse është i paktë, merret për bazë ajo në të cilën njeriu është më i bindur (sigurt). Nëse janë njësoj (si dyshimi dhe bindja), atëherë e merr për bazë atë më të paktën.

Shënime

-Nëse namazliu harron të bëjë sexhden e harresës, s'ka asgjë për të, dhe namazi i tij është i saktë.

-Nëse namazliu lë një shtyllë, namazi i tij nuk saktësohet derisa ta kryejë atë shtyllë dhe atë që vjen pas saj, e pastaj të bëjë sexhden e harresës.

-Nëse namazliu lë një vaxhib nga harresa dhe i kalon radha, ai bën sexhden e harresës.

Përmbledhja e formës së namazit e shoqëruar me foto

-Së pari, muslimani merr abdes në shtëpinë e tij dhe vesh rrobat më të bukura.

-Shkon në xhami- i lejohe të shkojë me mjet transporti- me qetësi në lëvizje dhe paraqitje. Pra, të mos nxitojë në ecje, të mos kthehet majtas-djathtas dhe të mos e ngrejë zërin.



-Kur të arrijë në xhami i heq këpucët dhe i vendos në vendin e caktuar. Bashkë me to (këpucët), e lë dhe dynjanë me preokupimet e saj. Ndalohet shit-blerja dhe kërkimi i gjësë së humbur në xhami.

-Në xhami hyn me këmbën e djathtë dhe thotë: *'Bismil-lah ues-salatu ues-selamu ala rasulilab. Allabumme iftabli ebvabe rahmetike'*. Ndërsa, kur del prej xhamisë, del së pari me këmbën e majtë dhe thotë: *'Bismil-lah ues-salatu ues-selamu ala rasulilab. Allabumme inni eseluke min fadlike'*.

-Burrat zënë rreshtin (safin) e parë, ndërsa gratë rreshtat (safat) e fundit.

-Nëse ikameti është thirrur, merr tekbinin fillestar (thua: Allahu ekber) dhe lidhesh pas imamit në atë pozitë që e gjen atë. Rekati llogaritet kur e arrin imamin në këmbë (kijam) dhe në ruku. Kur imami jep selam, namazliu plotëson atë që nuk mund të arrinte nga namazi.

-Nëse hyn në xhami dhe namazi nuk ka filluar, fali sunetet para farazit. Nëse namazi nuk ka sunete para, atëherë fal dy rekate si përshëndetje për xhaminë para se të ulesh.

-Të mos e nëpërkëmbësh shenjtërinë/etikën e xhamisë duke vështruar orën ose duke u kollitur në mënyrë që të falet namazi.

-Prej sunetit është që imami dhe ai që falet vetëm të falen duke pasur sutër para vetes. Ndërsa, në namazin me xhemat, sutra e imamit është sutër për xhematin.




-Këmbët i hap sa gjerësia e shpatullave, as më pak e as më shumë.



-Pasi ke plotësuar kushtet e namazit thua: ‘Allahu ekber’ duke i ngritur duart me gishtat e bashkuar (e të shtrirë drejtë) deri në lartësinë e majave të veshit ose deri në lartësinë e supeve. Brendësinë e pëllëmbës e drejton kah Kibla.



-Pastaj brendësinë e pëllëmbës së djathtë e vendos mbi shpinën e dorës së majtë, mbi kyç dhe parakrah, ose e kap atë (dorën e majtë me të djathtën).



-Shikimin e hedh në vendin e sexhdes dhe nuk shikon as majtas, as djathtas e as lart në qiell.



-Pëlqehet që lutjen e fillimit të namazit ta lexosh vetëm në rekatën e parë. Më parësore është që në namaze të thuash herë pas herë lutjet që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në fillim të namazit.

-Pastaj thua 'istiadhen', prej asaj që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. E prej tyre është '*udhu bil-lahi minesb-shejtani er-raxhim*'.

-Pastaj thua 'besmelen', e ajo është '*bismil-lahir-rrahmanir-rrahim*'.

-Pastaj lexon të plotë suren El-Fatiha.

-Është e pëlqyeshme që të lexosh atë që di dhe që e ke më të lehtë nga Kurani, pa e thënë 'istiadhen', por në fillim të sureve thua vetëm 'besmelen'.

-Pastaj i ngre duart siç i ngritë në tekbirin fillestar duke thënë 'Allahu ekber' dhe shkon në ruku.

-Në ruku i kap gjunjët me duar duke i pasur gishtërinjtë e hapur, ndërsa shpinën e mban në një drejtim me kokën (nuk e ulë më shumë e as nuk e ngre më shumë).

-Në ruku e ke detyrë të thuash një herë: '**Subhane Rabbijel-adhim**'. Pëlqehet që nganjëherë të thuash edhe dhikër tjetër në vend të saj prej dhikre (të rukusë) që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.



-Pastaj ngrihesh nga rukuja dhe para se të drejtohesh thua: **'SemiAllahu limen hamideh'**, duke i ngritur duart herë në lartësinë e të butave të veshëve ose në lartësinë e supeve.

-Pasi drejtohesh thua: **'Rabbena ue lekel-hamd'**. Pëlqehet që të thotë dhe dhikre të tjera që transmetohen nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të thuhen në këtë pozitë.

-Pastaj thua: **'Allahu ekber'**, duke mos i ngritur duart dhe bën sexhde mbi shtatë gjymtyrë: ballin bashkë me hundën, brendësinë e shputave të duarve, gjunjët dhe brendësia e gishtave të këmbës.

-Largon krahët nga dy anët, barkun prej kofshëve, kofshët prej dy kërcinjve të këmbës dhe krahët i ngre nga toka.



-Në sexhde thua: ‘**Subhane Rabbijel-cala**’ një herë, e kjo është vaxhib. Pëlqehet që të thuhet dhe dhikre të tjera prej asaj që transmetohen nga Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem (të thuhet në këtë pozitë). Po ashtu lejohet që në sexhde të lutesh me atë që dëshiron. Por, më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem.

-Pastaj thua: ‘**Allahu ekber**’ dhe ulesh mbi këmbën e majtë të shtrirë anash, ndërsa këmbën e djathtë e ngre duke e pasur brendësinë e gishtave të këmbës së djathtë të ngulitur në tokë dhe gishtërinjtë e saj në drejtim të kibles, kurse brendësinë e pëllëmbës i vendos në fund të gjunjëve. Kjo ulje veprohet në të gjitha uljet e namazit, përveç namazit me tri dhe katër rekate në teshehudin e fundit, në të cilin ulesh në formën *teverruk* ku këmbën e majtë e fut nën kërcirin e të djathtës.



-Pastaj thua: **'Allahu ekber'** dhe shkon në sexhde ashtu siç veprime në sexhden e parë.

-Pastaj thua: **'Allahu ekber'** dhe ngrihesh për në rekatin e dytë. Në rekatin e dytë vepron ashtu siç veprime në rekatin e parë, përveçse në rekatin e dytë s'ka tek bir fillestar dhe as lutje për fillimin e namazit.

-Pasi mbaron sexhden e dytë, ulesh në teshehud.


-Në teshehud bën shenjë me gishtin tregues, ndërsa me gishtin e madh dhe të mesit formon një rreth. Gishtin e lëvizë dhe lutesh.

-Thua teshehudin dhe thënia e tij është vaxhib.

-Nëse namazi është me dy rekate, atëherë lexon dhe salatet ibrahimijeh. Leximi i tyre është vaxhib. Pastaj i kërkon mbrojtje Allahut nga katër gjëra: *"Allabumme inni eudhu bike min adhabi xhebennem, ue eudhu bike min adhabil-kabr, ue eudhu bike min fitnetid-Dexhal ue eudhu bike min fitnetil-mehja uel-memat"*. Pas kësaj lutesh me atë që dëshiron, por më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, si: *"Allabumme e'inni ala dbikrike ue sbukrike ue busni i'badetike"*.



-Pastaj jep selam; në fillim nga ana e djathtë e pastaj nga ana e majtë, duke e kthyer vetëm kokën dhe jo shpatullat. Po ashtu, pa e lëvizur kokën lart-poshtë dhe duke mos bërë shenjë me duart.



-Nëse namazi është me tri apo katër rekate, ngrihesh pas leximit të teshehudit të parë, edhe pse pëlqehet leximi i salatit ibrahimijeh.

-Thua: **'Allahu ekber'** dhe fal rekatën e tretë, dhe pas kësaj ulesh në teshehud nëse namazi është me tri rekate. Po ashtu, nëse është me katër rekate, e fal dhe pastaj ulesh për në teshehudin e fundit.

-Lexon teshehudin dhe salatin ibrahimijeh dhe kërkon mbrojtjen e Allahut nga katër gjëra *"Allahumme inni eudhu bike min adhabil-xbehennem, ue eudhu bike min adhabil-kabr, ue eudhu bike min fitnetid-Dexhal ue eudhu bike min fitnetil-mehja uel-mema"*. Pas kësaj lutesh me atë që dëshiron, por më parësore është të lutesh me atë që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, si: *"Allahumme e'inni ala dhikrike ue shukrike ue husni i'badetike"*.

-Nëse është namaz obligativ, pëlqehet të thuash dhikrin që transmetohet pas namazit. Kështu, thua tri herë: *"estagfirullah"* pastaj: *"Allahumme entes-selamu ue minkes-selam, tebaarakte ja dheel-xbelali uel ikraam."*

-Pastaj thua *"SubhanAllab"*, *"El-hamdulilal"* dhe *"Allahu Ekber"* nga tridhjetë e tri herë, në total nëntëdhjetë e nëntë. Dhe e mbyll të njëqindtën herë duke thënë: *'La ilabe il lAllahu uahdebu le sheriike leb, lebul-mulku ue lebul-hamdu, ue huve ala kul-li shejin kadir'*.

-Pastaj lexon ajetin Kursij:

اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ

"Allahu! Nuk ka të adhuruar tjetër të denjë përveç Tij, të Përrjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në tokë. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij? Ai di gjithçka që ka ndodhur para krijesave dhe gjithçka që do të ndodhë pas tyre, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga dija e Tij, përveç asaj që do Ai. Kursijui Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atë nuk e lodh ruajtja e tyre (qiejve dhe Tokës). Ai është i Larti, Madhështori."

Suren El-Ikhlâs:

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (1) اللَّهُ الصَّمَدُ (2) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (3) وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (4)

“Thuaj: Ai, Allahu është Një! Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s'ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.”

Suren Felek:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (1) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (2) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (3) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (4) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (5)

“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit. Prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron.”

Dhe suren Nas:

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (1) مَلِكِ النَّاسِ (2) إِلَهِ النَّاسِ (3) مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (4) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (5) مِنَ الْغِيَّةِ وَالنَّاسِ (6)

“Thuaj: Mbështetem (mbrohem) me Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve. Të adhuruarin e njerëzve, Prej të keqes së cytësit që fshihet. I cili bën cytje në zemrat e njerëzve. Qoftë ai (cytësi) nga xhinët ose nga njerëzit.”

(Suret Ihlas, Felek dhe Nas pas çdo namazi lexohen nga një herë secila. Nuk ka argument në sunetin autentik që pas namazit të sabahut dhe të akshamit ato të lexohen nga tri herë. Sh.p.)

Vërejtje të rëndësishme

-Më herët kemi përmendur se prej kushteve të saktësisimit të namazit është mbulimi i auresit. Prandaj, namazliu le të ketë kujdes nga zbulimi i auresit gjatë namazit, sepse kështu namazi i tij konsiderohet i pavlefshëm.



-Nëse një person falet me imamin, ligjësohet të qëndrojë në të djathtën e tij dhe në një drejtim me të, e jo para apo pas tij. Kështu qëndron edhe me atë që ka përbri në namazin me xhemat.



Përmbledhje rreth namazit

Emri	Gjykimi	Koha	Numri	Forma
Namazi i xhumasë	Farz	Në kohën e drekës	Përbëhet nga dy rekate	Namazi i xhumasë falet me zë. Xhemati formohet me 3 veta e më shumë
Namazi i eklipsit	Farz kifajeh	Falet në kohën kur ndodh eklipsi	Përbëhet nga dy rekate	Namazi i eklipsit falet me zë, me dy ruku në çdo rekat.
Namazi i vitri	Sunet i fortë	Pas jacisë deri në hyrjen e kohës së namazit të sabahut	1-11 rekate	<p>Falet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> -një rekat. -Tri rekate së bashku, ku ulesh vetëm në rekatën e fundit; ose falen dy rekate, jep selam, pastaj fal dhe një rekat. -Pesë rekate, ku ulesh në teshehud vetëm në rekatën e pestë. -Shtatë rekate ku ulesh në teshehud vetëm në rekatën e fundit. -Nëntë rekate ku ulesh në rekatën e tetë dhe ngrihesh për rekatën e nëntë pa dhënë selam, pastaj qëndron në teshehud dhe jep selam. -Falet 2+2 rekate dhe e mbyll me një rekat tek.

Sunetet e sabahut	Sunet i fortë	Para farzit të sabahut.	Dy rekate	Në rekatën e parë lexon surën El-Kafirun dhe në të dytin surën El-Ihlas
Sunetet e drekës	Sunet	Katër rekate para drekës dhe dy pas saj	4/2	2+2 të ndara
Sunetet e akshamit	Sunet	Pas namazit farz të akshamit	Dy rekate	Në rekatën e parë lexon surën El-Kafirun dhe në të dytin surën El-Ihlas
Sunetet e jacisë	Sunet	Pas namazit të jacisë	2 rekate	
Namazi i teravive	Sunet	Pas namazit të jacisë deri kur hyn koha e namazit të sabahut	2-10 rekate	
Tehijjetul-mesxhid	Vaxhib	Kur hyn në xhami para se të ulesh	Dy rekate	
Namazi i duhasë	Sunet	Nga ngritja e diellit deri para zevalit	2-8 rekate	
Namazi i istiharës	Sunet	Në çdo kohë	Dy rekate	Lutjen e istiharës e bën para selamit
Namazi i istiskasë	Sunet kur është i nevojshëm	Nga ngritja e diellit një shtizë	Dy rekate	Në rekatën e parë thua shtatë tekbire bashkë me tekbirin fillestar, njëjtë si namazi i Bajramit, kurse në rekatën e dytë pesë tekbire.
Namazi i Bajramit	Sunet	Nga ngritja e diellit një shtizë	Dy rekate dhe dy hutbe	Në rekatën e parë thua shtatë tekbire bashkë me tekbirin fillestar, kurse në rekatën e dytë pesë tekbire.

Kohët në të cilën ndalohej falja e namazit vullnetar

1. Pas namazit të sabahut derisa të ngrihet dielli një shtizë.
2. Pas namazit të ikindisë deri në perëndimin e diellit.
3. Kur dielli arrin mesin e qiellit deri kur kalon kupën e qiellit dhe anon nga perëndimi.

Pyetje rreth namazit

1. Sa është numri i kushteve të namazit? Nëntë. Njëmbëdhjetë. Tetë.
2. Kushti i Islamit te kushtet e namazit është gabim, ngase nuk falet vetëm se muslimani.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
3. Et-Temejjiz është arritja e pjekurisë.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
4. Largimi i papastërtisë me anë të abdesit apo gusulit përfshinë trupin, vendin e faljes dhe rrobat.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
5. Papastërtia e derrit është: Mugal-ledhah. Mutevessitah.
6. El-Menij është i papastër për shkak se e bën obligim marrjen e gusulit pas daljes së tij.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
7. S'ka dallim mes spërkatjes me ujë dhe larjes.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
8. Të gjitha të ngordhurat janë të papastra.
 1. E saktë.
 3. E gabuar.
9. Në papastërtinë e qenit vlen larja me diçka tjetër përpos dheut.
 1. E saktë .
 2. E gabuar.
10. Ajo që është vështirë të shmanget për shkak të hyrje-daljes së shumtë (në shtëpi), siç është macja. Macja mund të konsiderohet e pastër tek disa njerëz kurse për disa të tjerë ajo është e papastër.

-E saktë.
-E gabuar.
11. Ai/ajo që s'ka Nefs që u rrjedh. Me Nefs këtu është për qëllim gjaku
-E saktë.
-E gabuar.

12. Gjaku i mbetur në vena (damar) është: I papastër. I pastër.
13. Sa është numri i shtyllave të namazit? Katërmbëdhjetë. Nëntë. Tetë.
14. Tekbiri ihram (fillestar) është ngritja e duarve.
1. E saktë.
 2. E gabuar.
15. Nëse personi lë një shtyllë nga harresa, ai duhet të bëjë vetëm sexhden e harresës.
1. E saktë.
 2. E gabuar.
16. Sa është numri i vaxhibeve të namazit? Tetë. Katërmbëdhjetë. Nëntë.
17. Personi në sexhde thotë ‘*Subbubun Kuddusun Rabbil-Melaikeitihî uer-Ruh*’ duke e ditur se është detyrë thënia ‘*Subhane Rabbijel-Eala*’ një herë të vetme. Kështu që, namazi i tij është i pavlefshëm.
1. E saktë.
 2. E gabuar.
18. Ligjësohet në namaz që personi ta vendosë brendësinë e pëllëmbës së dorës së djathtë mbi shpinën e të majtës, në kyç dhe parakrah.
1. E saktë
 3. E gabuar
19. Leximi me zë bëhet në dy rekatet e para të namazit farz, në namazin e natës dhe në ato namaze në të cilat ligjësohet tubimi i përgjithshëm, siç është namazi i bajramit.
1. E saktë.
 2. E gabuar.
20. Sa është numri i asgjësuesve të namazit? Tetë. Nëntë. Katërmbëdhjetë.
21. Ulja teverruk bëhet në teshehudin: E parë. Të fundit. Në të dytë.
22. Cili është gjykimi i shtesës ‘*uesh-Shukër*’ te fjala ‘*Rabbena lekel-hamd uesh-Shukër*’?
- Lejohet.
- Pëlqehet.
- Ndalohet.
23. Fjala ‘*Rabbi gfirli ue li ualidejje*’ midis dy sexhdeve është: E lejuar. E ndaluar. E urryer (mekruh).
24. Vendosja (shtrirja) e krahëve në tokë në sexhde është: E ndaluar. E pëlqyeshme. E urryer (mekruh).

25. Sa është numri i shkaqeve për bërjen e sexhdes së harresës: O Dy. O Tre. O Katër.

26. Dyshimi pas përfundimit të veprës nuk ndikon (te vepra). Po ashtu edhe nëse dyshimet janë të shumta.

1. E saktë.
2. E gabuar.

27. Sunetet e sabahut dallojnë nga sunetet e tjera në vlerë, në faljen lehtë të tyre, në lexim të veçantë (të sureve), në faljen e tyre edhe në udhëtim dhe shtrirje pas faljes së tyre në shtëpi.

1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Sqaro gjykimin për secilën nga çështjet e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Namazi i atij që shan fenë	
Namazi i pijanecit	
Namazi i personit me sëmundjen e Alzheimerit	
Namazi i fëmijës së vogël	
Namazi i falur pa abdes nga harresa	
U fal me rroba të papastra nga harresa	
Urina e lopës	
Urina e korbit	
U fal me gjunjë të zbuluar	
U fal para kohe nga harresa	
Namazi në avion	
Bëri nijet për farzin e kohës	
U fal ulur	
Harroi leximin e Fatihasë	
E arriti imamin në ruku	
Nxitimi në namaz	
Dyshimet e shumta pas namazit	

Dyshimi rreth abdesit pas tekbirin të ihramit	
Shtoi një ruku nga harresa	
La tekbirin fillestar	
La teshehudin e parë	
La teshehudin e fundit	
Dyshon a fali tre apo katër rekate	
Dyshimi pas namazit	
Dyshimi gjatë namazit	
Harroi te sexhdja e harresës	
Flet gjatë namazit nga harresa	
Falet me auret të zbuluar dhe nuk e mëson vetëm se pas namazit	
Marrja abdes në shtëpi para vajtjes për në namaz	
Shit-blerja në xhami	
Shkëmbimi i valutave në xhami	
E arrin imamin në teshehudin e fundit	
Sutra në namaz	
Kthimet e lehta në namaz	
Kthimet e shumta në namaz	
Bërja e lëvizjeve të namazit me shpejtësi	
Salati ibrahimijeh në teshehud	
Të folurit në namaz	
Lëvizjet në namaz	
Namazi i xhumasë	
Namazi i vitrit	
Tehijjetul-mesxhid	

29. Përmend dallimin mes kushtit, shtyllës, vaxhibit dhe sunetit.

Kushti	Shtylla	Vaxhibi	Suneti

Mësimi i dymbëdhjetë

Kushtet e abdesit

Kushtet e abdesit janë dhjetë: **1.** Islami. **2.** Logjika. **3.** Dallimi. **4.** Qëllimi (nijeti). **5.** Mos të bëjë nijet ndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet abdesi i tij. **6.** Ndërprerja që e bën detyrë abdesin. **7.** Pastrimi me ujë ose me gurë para marrjes së abdesit. **8.** Pastërtia e ujit dhe të qenit i tij i lejueshëm. **9.** Largimi i çdo gjëje që pengon arritjen e ujit në lëkurë. **10.** Hyrja e kohës së namazit për atë që ka papastërti të përheshme.

Shpjegimi i disa kushteve të abdesit

-Fjala e tij **“Mos të bëjë nijet ndërprerjen e abdesit derisa të plotësohet abdesi i tij”** d.m.th. nijeti të vazhdojë nga fillimi i abdesit deri në përfundimin e tij.

-Fjala e tij **“Ndërprerja që e bën detyrë abdesin”**, pra mos të marrë abdes duke ngrënë mish deveje ose duke urinuar. Por, duhet patjetër që të shkëputet nga ajo që e prishë abdesin para se të fillojë marrjen e tij (abdesit).

-Fjala e tij **“Pastrimi me ujë ose me gurë para marrjes së abdesit”**, nga kjo bën përjashtim kur abdesi merret për shkak të gazrave, gjumit, ose për shkak të ngrënies së mishit të devesë (pra, nëse merret abdes pas gazrave, gjumit dhe ngrënies së mishit, atëherë nuk është e nevojshme të pastrohet (poshtë) paraprakisht sikur pastrohet pas urinës apo jashtëqitjes para se të marrë abdes).

-Fjala e tij **“Pastërtia e ujit dhe të qenit i tij i lejueshëm”** d.m.th. mos të marrë abdes me ujë të papastër apo me ujë që e ka marr padrejtësisht.

-Fjala e tij **“Largimi i çdo gjëje që pengon arritjen e ujit në lëkurë”**, siç është brumi apo manikyri i thonjve, sepse këto janë pengesë për depërtimin e ujit te gjymtyrët.

Sunetet e fitrës

Sunetet e fitrës janë:

1. **Bërja synet.** Kjo është detyrë për burrat dhe sunet për gratë nëse e kanë të nevojshme.

2-5. **Shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjve, rruajtja e qimeve në pjesët intime dhe shkulja e qimeve nga nënsqetullat.** Transmetohet nga Enensi radijAllahu anhu se ka thënë: “*Na e ka përcaktuar (Profeti sal-LAllahu alejbi ue sel-lem) kobën për shkurtimin e mustaqeve, prerjen e thonjve, shkuljen e qimeve nga sqetullat dhe rruajtjen e qimeve në pjesët intime, (e ajo është:) që të mos i lëmë ato më shumë se dyzet ditë*”. Pra, nuk duhet që të lihen në trup më shumë se dyzet ditë.

6. **Lëshimi i mjekrës.** Gjykimi për të: lëshimi i mjekrës është vaxhib, kurse rruajtja e saj është prej mëkateve të mëdha.

7. **Përdorimi i misvakut.** Ai është përdorimi i një druri aromantik apo gjërave të ngjashme me të për pastrimin e dhëmbëve. Gjykimi i tij: përdorimi i misvakut është sunet në çdo kohë, si: kur merr abdes, para fillimit të namazit, kur hyn në shtëpi, para leximit të Kuranit, kur ngrihesh nga gjumi dhe kur ndryshon era e gojës.

Mësimi i trembëdhjetë

Farzet e abdesit

Farzet e abdesit janë gjashtë:

1. Larja e fytyrës. Në të hyn larja e gojës dhe e hundës.
2. Larja e duarve deri te bërrylat.
3. Dhënia mes' h gjithë kokës. Në të hyjnë dhe veshët.
4. Larja e këmbëve bashkë me kyçet.
5. Rradhitja.
6. Vijueshmëria.

Pëlqehet përsëritja e larjes së fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tri herë. Po kështu dhe larja e gojës dhe hundës. Larja e tyre nga një herë është obligim (farz). Ndërsa, nuk pëlqehet dhënia mes' h kokës disa herë, siç tregojnë për këtë hadithet autentike.

Vijueshmëria

Arrihet duke mos e vonuar larjen e njërës gjymtyrë aq sa të thahet ajo gjymtyrë që është larë para saj.

Gjërat që e prishin abdesin

Gjërat që e prishin abdesin janë gjashtë:

1. Çdo gjë që del nga dy organet (para dhe mbrapa).
2. Dalja e ndonjë gjëje të ndyrë dhe të papastër nga trupi.
3. Humbja e mendjes me anë të gjumit apo me diçka tjetër.
4. Prekja direkt e organit me dorë, qoftë para apo mbrapa, duke mos pasur asnjë pengesë.
5. Ngrënia e mishit të devesë.
6. Dalja prej Islamit.

Shënim i rëndësishëm: Larja e të vdekurit nuk e prishë abdesin, sipas fjalës më të saktë, e cila është fjala e shumicës së dijetarëve, kjo për shkak të mungesës së argumentit që tregon për diçka të tillë. Por, nëse personi që lanë të vdekurin prek organin e të vdekurit pa pasur ndonjë pengesë ndërmjet, në këtë rast e ka detyrë të marrë abdes. Ai e ka detyrë të mos e prekë organin e të vdekurit pa pasur ndonjë pengesë ndërmjet (dorashkë apo diçka të ngjashme). Po ashtu, prekja e gruas asnjëherë nuk e prishë abdesin, qoftë kjo prekje me epsh apo pa epsh, sipas fjalës më të saktë të dijetarëve, përderisa nga ai (burri) nuk del diçka (që e prishë abdesin). Profeti sal-Allah u alejhi ue sel-lem ka puthur dikë prej bashkëshorteve të tij dhe pastaj u fal duke mos marrë abdes. Ndërsa, te fjala e Allahut të Lartësuar: “**apo i prekni** (kontaktoni me) **gratë**”, sipas fjalës më të saktë të dijetarëve është për qëllim marrëdhënia intime. Kjo është fjala e Ibën Abasit radijAllahu anhumu dhe një grupi prej selefëve dhe të mëvonshmëve.

Shpjegimi i disa gjërave që e prishin abdesin

-Fjala e tij “Çdo gjë që del nga dy organet (para dhe mbrapa)” siç është urina, nevoja fiziologjike, el menijju, el mmedhij, el uedi, gazrat, gjaku, menstruacionet dhe lehonja.

-Fjala e tij “Dalja e ndonjë gjëje të ndyrë dhe të papastër nga trupi”, fjala më e saktë është se nuk e prishë abdesin, përveçse bën pjesë në kategorinë e urinës dhe nevojës fiziologjike.

-Fjala e tij “Humbja e mendjes me anë të gjumit apo me diçka tjetër”, gjumi në vetvete nuk e prishë abdesin, përveç nëse personi hamendëson se ka lëshuar gazra. E nëse ai është i vetëdijshëm dhe e ndjen se nuk ka dal diçka prej tij, atëherë gjumi nuk e prishë abdesin.

-Fjala e tij “Prekja direkt e organit me dorë, qoftë para apo mbrapa, duke mos pasur asnjë pengesë”, dijetari i islamit Ibën Tejmije (Allahu e mëshiroftë!) thotë se është e pëlqyeshme marrja abdes për atë që prek organin, por nuk e ka detyrë.

**Përmbledhje e formës së abdesit
me anë të fotove**

-Kur personi bën nijetin për marrjen abdes, në fillim të përmendë Allahun e Lartësuar (thotë bismil-lah).

-Pastaj lanë shuplakat (pëllëmbët) tri herë.

-Pastaj me dorën e djathtë fut ujë në gojë duke bërë gargarë dhe e nxjerr atë. Pastaj lanë hundën duke e thithur ujin thellë me hundë dhe e nxjerr duke e shfryrë hundën me dorën e majtë. Këtë e përsëritë tri herë.

-Pastaj lanë fytyrën tri herë. Kufiri i fytyrë për së gjati është nga balluket deri te fundi i mjekrës dhe për së gjeri është nga veshi në vesh.

-Pastaj lanë duart deri te bërrylat tri herë. Në fillim fillon me dorën e djathtë e pastaj me dorën e majtë.

-Pastaj i jep mes'h kokës duke kaluar duart e lagura nga pjesa e përparme e kokës deri te zverku dhe pastaj i rikthen aty ku filloi.

-Pastaj lanë veshët. Me gishtin tregues lanë brendësinë e tyre dhe me gishtin e madh pjesën e pasme.

-Pastaj lanë këmbët deri te kyçet tri herë.







-Pas përfundimit të abdesit thotë: *“Esh’bedu en la ilabe il-LAllabu uabdebu la sherike leh, ue esh’bedu enne Mubameden abdubu ue rasulubut”*. Te Tirmidhiu gjendet: *“Allahumme xbealni minet-terrabine ue xbelani minel-mutetabhirine”*.

Gjykimi i shtesës mbi atë që është ligjësuar

Nuk lejohet të shtohet në abdes mbi atë që është ligjësuar, p.sh.: shtimi mbi larjen tri herë të gjymtyrëve, ose larja e duarve mbi bërryla, ose larja e këmbëve mbi kyçet e tyre, ose dhënia mes’h qafës.



Shtojcë rreth disa gjërave që lidhen me shtyllat e Islamit

Së pari: Pastërtia/tejmumi - pastrimi simbolik me dhe'

Ai zëvendëson pastrimin me ujë kur njeriu ka arsye për mospërdorimin e ujit, ose për shkak të mungesës së ujit, ose frikësohet për shëndetin nëse e përdor ujin. Kështu që, në këtë rast në vend të ujit përdoret dheu i pastër.

Forma e marrjes së tejmumit

Personi bën nijet (me zemër) marrjen e tejmumit, pastaj përmend Allahun (thotë *bismil-lah*), pastaj godet (lehtë) një herë të vetme me duart e tij tokën e pastër dhe fërkon fytyrën dhe pjesën e sipërme të pëllëmbës (duarve).



Nuk ligjësohet hapja e gishtërinjve kur godet dheun (tokën) dhe as futja e tyre te njëri-tjetri gjatë pastrimit.



Forma e larjes së tërësishme e trupit

Forma e larjes së trupit e cila është detyrë: Personi bën nijet (me zemër) largimin e papastërtisë, pastaj përmend Allahun (thotë *bismil-lah*), pastaj lanë me ujë të gjithë trupin, duke fërkuar mirë rrënjët e flokëve dhe duke përfshirë larjen e gojës dhe hundës.

Sunetet e larjes së tërësishme (gusulit)

Larja e organeve (para dhe mbrapa), pastaj larja e duarve, pastaj marrja abdes ashtu siç merr për namaz, pastaj larja e anës së djathtë, pastaj e anës së majtë dhe në fund larja e këmbëve.

Gjërat që e bëjnë detyrë larjen e tërësishme të trupit (gusulin)

1. **Xhunubllëku:** Kjo ndodh me daljen e spermës me kryerjen e marrëdhënieve intime apo me diçka tjetër (kur sheh ëndrra në gjumë),¹ ose kur organi mashkullit hyn te organi i femrës (edhe nëse s'del sperma).
2. **Dalja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë.**
3. **Vdekja.** Nga kjo (larje) përjashtohet dëshmori (shehidi).
4. **Kur jobesimtari pranon Islamin.**

Kushtet e dhënies mes'h mbi meste

Të vishen të pastra. Pra personi t'i ketë larë këmbët me ujë gjatë abdesit

Mestet ose çorapet të jenë të pastra.

Të mbulojnë pjesën më të madhe të gjymtyrëve.

T'u jepet mes'h nga papastërtia e vogël (urina, gazrat) dhe jo nga xhunubllëku apo nga ajo që e bën detyrë marrjen e gusulit.

Mes'hi të bëhet për një kohë të përcaktuar fetarish. Një ditë-natë për vendasin (24 orë) dhe tre ditë-netë për udhëtarin (72 orë). Koha fillon nga momenti kur i jep mes'h për herë të parë.

Forma e dhënies mes'h mesteve

Personi ta kalojë dorën e tij të lagur duke filluar nga majat e gishtërinjve deri tek kyçet, pra i jepet mes'h vetëm pjesës së sipërme të këmbës. Këmbëve u jepet njëkohësisht mes'h me dy duart, me dorën e djathtë i jep mes'h këmbës së majtë dhe me dorën e majtë i jep mes'h këmbës së majtë njëkohësisht, ashtu siç fërkon veshët kur merr abdes. Kjo formë është prej sunetit.

Çështje që lidhen me mes'hin

1. Kur mbaron koha e mes'hit ose hiqen mestet (çorapet), abdesi nuk priset.
2. Lejohet t'i jepet mes'h mestit të grisur dhe asaj nëpërmjet të së cilës shihet lëkura për shkak të hollësisë derisa është e mundshme ecja me to.

Edukata e kryerjes së nevojës

Nga veprimet që pëlqehen:

-Kur të hyjë në banjo me këmbën e majtë të thotë: *“Bismil-lah, Allahumme inni eudhu bike minel-kebubthi uel-kebabaith”*.

-Të dalë prej saj me këmbën e djathtë duke thënë *“Gufraneke”*.

Ka për detyrë që gjatë kryerjes së nevojave fiziologjike të fshihet pas ndonjë muri dhe gjërave të ngjashme dhe të largohet nga shikimi i njerëzve kur është në vend të hapur.

Nga veprimet që nuk lejohen:

-Kryerja e nevojave në rrugë, në vendet ku qëndrojnë njerëzit, poshtë pemëve me fruta, në ndonjë vend ku dëmtohen njerëzit dhe as në ujën e ndenjtur.

-Drejtimi kah Kibla dhe as kthimi i shpinës asaj gjatë kryerjes së nevojës.

-Prekja e organit me dorën e djathtë.

-Përmendja e Allahut të Lartësuar.

Pasi të përfundojë kryerjen e nevojës të pastrohet me ujë ose me gurë.

Kushtet e pastrimit me gurë:

-Të fshihet (pastrohet) me tri gurë e më shumë. Mos të fshihet në të njëjtin vend.

-Të jetë mjeti pastrues. Pastërtia e vendit njihet kur guri apo letra pas pastrimit të kthehet e thatë.

-Pastrimi të mos bëhet me diçka të ndytë apo me diçka të nderuar, siç është ushqimi, as me kocka e bajga. Lejohet urinimi në këmbë me kusht që personi të ruhet që pikat e urinës mos t'i bihen në trup e në rrobe dhe të ruhet nga shikimi i njerëzve, ngase *“Profeti sal-LAllahu alejhi ue sel-lem shkoi në një vend ku hidhesbin mbeturinat e një populli dhe urinoi në këmbë”*. Mutefekun alejhi.

Pyetje rreth pastërtisë/abdesit

1. Sa është numri i kushteve të abdesit? Nëntë. Dhjetë. Tetë.
2. Farzet e abdesit janë: Katër gjymtyrët. Katër gjymtyrët, radhitja dhe vazhdimësia.
3. Sa është numri i gjërave që e prishin abdesin? Gjashtë. Pesë. Tetë.
4. Sqaro se cilat nga gjërat e mëposhtme e prishë abdesin: Mishi i devesë. Mishi i sorkadhes. Zhurma e barkut. Gazrat. Dremitja. Larja e të vdekurit. Prekja e gruas.
5. Përmend formën e tejemumit:
.....
.....
.....
6. Përmend formën e larjes së tërësishme të trupit (gusulit):
.....
.....
.....
.....
7. Përmend gjykimin për secilën nga çështjet e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Shqiptimi i nijetit	
Bën nijet në marrjen e abdesit faljen e një namazi të vetëm, por pastaj fal më shumë se një namaz	
Merr abdes për leximin e Kuranit e pastaj u fal (me të njëjtin abdes)	
Ndërpret nijetin gjatë abdesit	
Ndërpret nijetin pas përfundimit të abdesit	
Merr abdes duke pasur brumë në kyçet e tij	
Merr abdes duke ngrënë mish deveje	
Merr abdes me ujë të vjedhur	
Merr abdes para pastrimit me ujë apo me gurë	
Merr ujë tjetër për larjen e veshëve	

I jep mes'h kokës tri herë	
Merr abdes duke i larë gjymtyrët nga një herë të vetme	
Merr abdes duke i larë gjymtyrët nga tri herë	
Larja e duarve në abdes	
Fërkimi mirë në brendësi të mjekrës	
I jep mes'h asaj që është obligim të lahet	
Larja e kokës	
Futja e duarve në enën me ujë	
Dhënia përparësi anës së djathtë në abdes	
Shtimi i larjes mbi tri herë në abdes	
Laja e kyçeve	
U fal pas notit	
U fal pas larjes së tërësishme të trupit (gusulit) dhe nuk merr abdes	

Së dyti: Zekati

Ai ndahet në dy pjesë:

Zekati i pasurisë:

Është shtylla e tretë e Islamit dhe është detyrë për çdo musliman të lirë dhe që posedon atë sasi pasurie tek e cila është detyrë zekati. Nuk nxirret zekat nga ajo pasuri që s'e ka kaluar vitin përveç asaj që nxirret nga toka, asaj që pason bazën siç është shtimi i nisabit dhe fitimit të nxjerrë nga tregtia. Koha e nxjerrjes së tyre është ajo e origjinës. Pra, pasi të jetë mbushur një vit nga pasuria bazë. Nuk është detyrë nxjerrja e zekatit përveç se nga katër kategori:

Zekati i trupit:

Ai është zekati i fitrit i cili është detyrë për çdo musliman, të madh e të vogël, mashkull apo femër, rob apo i lirë.

Ari dhe argjendi dhe çdo gjë që i zëvendëson ato. Nisabi i arit është 20 mithkal (85 gramë), kurse nisabi i argjendit është 200 dërhem (595 gramë).

Bagëtitë që kullotin: ato që kullosin tërë vitin apo pjesën më të madhe të tij, e jo që ushqehen nga pronari. Këtu futen devetë, lopët dhe bagëtitë e imëta.

Prodhimet bujqësore: drithërat dhe frutat.

Artikujt tregtarë: çdo gjë që është përgatitur për shit-blerje.

Njerëzit që meritojnë zekatin

1. Të varfrit: Janë ata të cilën nuk kanë asgjë apo nuk i plotësojnë nevojat e tyre.

2. Të ngratët: Janë atë që posedojnë më shumë sesa të varfrit. Nëse llogarisim se për një vit është e mjaftueshme 6000€, atëherë i varfër është ai që posedon më pak se 3000€ ose asgjë. Ndërsa, i ngrati është ai që posedon 3000€ ose më shumë, por që nuk e arrin shumën 6000€, ngase ne i japim të ngratit dhe të varfrit që t'u mjaftojë për një vit, sepse zekati është detyrë kur pasuria ka mbushur/kaluar një vit.

3. Punonjësit e zekatit: Janë atë të cilët shteti islam i autorizon për mbledhjen e zekatit, ruajtjen dhe përdorimin e tij atje ku është përcaktuar. Nuk kushtëzohen të jenë të varfër, përkundrazi u jepet prej zekatit edhe nëse janë të pasur.

4. Atyre që dëshiron t'ua përfitosh zemrat: Janë ata të cilët shpresohet të pranojnë Islamin dhe iu jepet për t'i shtyrë në këtë, apo për t'u ruajtur nga e keqja e tyre, apo për ta forcuar më shumë besimin e tyre.

5. Për lirim të robërve. E ata janë

- a) El-Mukateb El-Muslim. Është robi që dëshiron të blejë lirinë e tij prej zotërisë së tij.
- b) Për lirim të muslimanit rob.
- c) Për lirim të burgosurve muslimanë.

Në këtë grup nuk hyn robi të cilit zotëria e tij i jep lirinë duke e llogaritur këtë si zekat. Kjo formë nuk lejohet.

6. Borxhlinjtë:

- a) Ai që ka marrë borxh për të pajtuar dy muslimanë.
- b) Ai që ka marrë borxh për nevojat e tij.

Nuk lejohet që dikush i cili i ka dhënë borxh dikujt tjetër t'ia falë atë borxh duke e konsideruar këtë veprim si dhënie zekati.

7. Në rrugën e Allahut: Kjo përfshin luftëtarët dhe çfarë ata kanë nevojë prej armëve dhe gjërave të tjera.

8. Ata që kanë mbetur në rrugë: Ai është udhëtari të cilit i janë mbaruar shpenzimet. Atij i jepet aq sa të ketë mundësi të arrijë në vendin e tij.

Lejohet që zekati t'i jepet vetëm një grupi nga grupet e përmendura. Nuk lejohet që zekati t'i jepet të pasurit, atij që është i fortë fizikisht për punë, familjes së Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem që janë Benu Hashim dhe shërbyesve tyre, as atyre ndaj të cilëve e ke detyrë shpenzimin dhe as jobesimtarit. Ndërsa, sa i përket lëmoshës, lejohet t'u jepet këtyre kategorive (të sipërpërmendurve) dhe të tjerëve. Sa më e dobishme që është për nevojtarin, aq më e plotë është ajo (lëmosha).

Përkufizime të rëndësishme

-Bintul-mekhad prej deveve, ajo që ka plotësuar një vit. Është quajtur kështu ngase nëna e saj është barrsë.

-Bintul-lubun prej deveve, ajo që ka plotësuar dy vite. Është quajtur kështu ngase nëna e saj ka (akoma) qumësht të bollshëm.

-El-hikkah prej deveve, ajo që ka mbushur tri vite dhe është e aftë të mbesë barrsë.

-El xhedhaah prej deveve, ajo që ka mbushur katër vite (dhe ka hyrë në vitin e pestë). Është quajtur me këtë emër ngase asaj në këtë moshë i bien dhëmbët e përparmë.

-Et-tebiu ose tebiah prej lopëve që ka mbushur vitin.

-El-musineh prej lopëve që ka mbushur dy vite.

Sasitë e zekatit

Pasuritë	Plotësimi vitit	Nisabi	Sasia e zekatit
Bagëtitë (devetë, lopët, delet etj.)	Kushtëzohet	Shih tabelën e mëposhtme	Shih tabelën e mëposhtme
Ato që dalin nga toka	Nuk kushtëzohet	300 saa	<p>Për atë që ujitet nga qielli, nga burimet tokësore apo e thith ujin nga toka, jepet një e dhjeta</p> <p>Për atë që ujit me vaditje jepet gjysma e një të dhjetës</p> <p>Për atë që ujitet me të tria së bashku jepet tri e katërta e të dhjetës</p>
Gjërat me vlerë (ari dhe argjendi)	Kushtëzohet	85 gram ar ose 595 gram argjend	Jepet çereku i të dhjetës
Mallrat tregtare	Kushtëzohet	Pasuria vlerësohet në ar ose argjend për të varfrit	Jepet çereku i të dhjetës

**Nisabi i zekatit të bagëtive që kullotin
dhe sasia i tyre**

Nisabi i zekatit të bagëtive që kullotin								
Delet dhe Dhitë			Devetë që kanë një apo dy gungë			Lopët dhe bollicat		
Sasia		Zekati i saj	Sasia		Zekati i saj	Sasia		Zekati i saj
prej	deri		prej	deri		Prej	Deri	
40	120	Një dele	5	9	Një dele	30	39	Një tebiun ose tebiatun
			10	14	Dy dele			
120	200	Dy dele	15	19	Tre dele	40	59	Një Musenn eh
			20	24	Katër dele			
201	300	Tri dele	25	35	Një bintul-mekhad	60	69	Dy tebiun
Pastaj në çdo 100 shton një dele			36	45	Një bintul-lubun	Pastaj në çdo 30 shton një tebiun dhe në çdo 40 shton një musinneh		
Nuk mirret për zekat: cjapi, as e vjetra në moshë, as ajo që ka të meta fizike të dukshme, as mallrat me cilësi të keqe (të ulët, dobët). Nuk mirret për zekat: e dobëta, as ajo që është barsë, as ajo që është tepër e dhjamosur dhe as malli më i mirë i pasurisë.			46	60	Një hikkatun			
			61	75	Një xhedhatun			
			76	90	Dy bintul-lubun			
			91	120	Dy hikkatun			
			121	129	Tre bintul-lubun			

Pyetje rreth zekatit

1. Nuk ka zekat për pasurinë derisa të ketë mbushur një vit. Për qëllim me “vit” është:
 Kalendari hixhri (hënor). Kalendari diellor. Nuk ka dallim.
2. Nga kushti i plotësimit të vitit përjashtohet: Thesari. Çfarë del prej tokës. Të dyja.
3. Nisabi i arit është: 85 gramë. 595 gramë. 95 gramë.
4. Nisabi i argjendit është: 200 dërhem. 595 gramë. Të dyja.
5. Te bagëtitë përfshihen devetë, lopët, buajt dhe delet.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
6. Nuk ka zekat për frutat.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
7. ‘Es-Saimeh’ është: Ajo që ka çmimin e lartë. Ajo që kullotë tërë vitin apo pjesën më të madhe të tij.
8. Ajo që kullot në livadhe d.m.th.: Që ha gjëra të lejuara Që nuk ka pronar.
9. Nëse përmenden të ngratët tek ta përfshihen të varfrit.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
10. Të varfrit i jepet nga zekati sa t’i mjaftojë: Për një vit. Për një muaj.
11. Punonjësit e zekatit janë: Të gjithë ata që punojnë në të. Vetëm ata që i ka caktuar prijësi.
12. Llogaritë sasinë e zekatit për shumat e mëposhtme:

Pasuria	Sasia e zekatit	
100 dërhem		
300 dinar		
400 dinar		
80 gramë ar		
500 gramë argjend		

30 dele		
60 dele		
565 dele		
4 deve		
17 deve		
449 deve		
30 lop		
49 lop		
77 lop		
99 lop		
20 milion €		
40 €		
45679 €		
255 saa prej grurit.		

13. Te kategoria ‘**atyre që dëshiron t’ua përfitosh zemrat**’ hyn jobesimtari edhe nëse nuk shpresohet që të bëhet musliman.

1. E saktë.
2. E gabuar.

14. Nëse zotëria e liron robin e tij, atëherë atij (robit të liruar) i jepet nga zekati.

1. E saktë.
2. E gabuar.

15. I pasuri heq dorë nga borxhi që i ka dhënë të varfrit duke ia llogaritur këtë si zekat. A është i saktë veprimi i tij?

1. I saktë.
2. I gabuar.

16. Kategoria ‘**Në rrugën e Allahut**’ përfshinë çdo fushë të bamirësisë, si: ndërtimi i xhamive.

1. E saktë.
2. E gabuar.

17. Zekati i kartëmonedhave llogaritet duke e ndarë shumën në dyzet.

1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Zekati është detyrë te bagëtitë dhe nuk është detyrë të kafshët që shfrytëzohen për punë e as për bagëtitë që ushqehen në stallë.

1. E saktë.
2. E gabuar.

19. Zekati i drithërave dhe frutave është detyrë kur të mbushet (plotësohet) nisabi. Dhe kjo kur të kenë arritur pjekjen.

1. E saktë.
2. E gabuar.

20. Te frutat dhe drithërat është detyrë të nxirret zekat gjysma e një të dhjetës së tyre nëse ujiten me vaditje.

1. E saktë.
2. E gabuar.

21. Është detyrë nxjerrja e zekatit të arit kur arrin nisabin dhe sasinë 20 mithkale.¹

1. E saktë.
2. E gabuar.

22. Vendos shenjë tek ato që është detyrë nxjerrja e zekatit: Pulat. Dyqan tregtie. Bagëtitë që ushqehen në stallë. Devetë saimeh. Plantacioni me hurma (arabe). 25 mithkale prej arit.

23. Et-Tebiu prej lopëve është ajo që ka mbushur dy vite.

1. E saktë.
2. E gabuar.

24. Nisabi i kartëmonedhave bazohet te: Mallrat tregtare Vlera e nisabit të arit ose argjendit Vlera e nisabit të arit dhe argjendit

25. Detyrë në nxjerrjen e zekatit të kartëmonedhave (në para) është: Çereku i të dhjetës. Gjysma e një të dhjetës.

26. Për tetëdhjetë gramë ar nxirren zekat: Dy gramë Katër gramë. Nuk ka zekat në të.

27. Është detyrë nxjerrja e zekatit për shtëpitë që janë për qëllim strehimi.

1. E saktë.
2. E gabuar.

¹ Një mithkal është llogaritur dhe është e barabartë me 4.25 g ar, sasia e arit prej të cilit nxirret zekati është $4.25 \times 20 = 85$ g ar i pastër.

28. Secilit që udhëton i jepet nga zekati, sepse ai është 'ibnus-sebil-prej atyre që kanë mbetur rrugës'.

1. E saktë .
2. E gabuar.

Së treti: Agjërimi

Agjërim nga ana gjuhësore do të thotë *vetëpërmbajtje*. Në terminologjinë fetare do të thotë: “*Adburim i cili i përkushtohet Allahut të Lartësuar duke u përmbajtur nga ngrënia, pirja dhe çdo gjë që e prishë atë, prej lindjes së agimit të vërtetë deri në përfundimin e diellit*”.

Shtyllat e agjërit

1. Qëllimi (nijeti).

2. Vetëpërmbajtja në gjërat që e prishin atë.

Nijeti për agjërimin obligativ.

Duhet patjetër që nijeti për agjërimin obligativ të bëhet që me natë, pra para agimit; mjafton që të bëhet me hyrjen e muajit të Ramazanit. Vendi i nijetit është zemra dhe shqiptimi i tij me gojë është bidat.

Nijeti për agjërimin vullnetar (nafile)

lejohe të bëhet në çdo moment të ditës përderisa paraprakisht nuk ka vepruar diçka prej gjërave që e prishin. Porse, shpërblimi llogaritet nga momenti që bëhet nijeti.

Ndarja e agjërit

Agjërimi vaxhib: Ai është agjërimi i Ramazanit, agjërimi kefare dhe nudhur (agjërimi për zotimin).

Agjërimi vullnetar (nafile):

Kushtet që e bëjnë detyrë agjërimin

1. Islami. **2.** Logjika e shëndoshë. **3.** Arritja e moshës së pjekurisë. Ndërsa, ai që akoma s’e ka arritur moshën e pjekurisë nxitet që të agjërojë duke e urdhëruar kujdestari i tij. **4.** Të jetë vendas. Agjërimi nuk është detyrë për udhëtarin. Më primare është që udhëtarin të agjërojë derisa agjërimi nuk i sjell ndonjë vështirësi, bazuar në veprën e Profetit alejhis-selam, dhe kjo është rrugë më e shpejtë për të hequr përgjegjësinë nga vetja dhe gjithashtu e arrin mirësinë e muajit të Ramazanit. **5.** Të jetë i shëndetshëm fizikisht. **6.** Gruaja të jetë e pastër nga menstruacionet dhe lehonja.

Ndarja e të sëmurëve në raport me agjërimin

Të sëmurët për të cilët nuk shpresohet shërimi. Në të bën pjesë ai i cili është i pafuqishëm të agjërojë. Ky nuk e ka detyrë agjërimin, por për çdo ditë duhet të ushqejë një të varfër, kjo ose duke mbledhur të gjithë të varfrit në varësi të ditëve që ka dhe t'u japë ushqim (të gatuar), ose duke u ndarë ushqim atyre në varësi të ditëve që ka (p.sh. nëse ka dhjetë ditë atëherë e ndan ushqimin në dhjetë të varfër). Çdo të varfëri i takon një çerek *saa* profetike, pra 510 gramë prej ushqimit të vendit. Do të ishte mirë nëse kësaj do t'i shtonte dhe mish.

Të sëmurët të cilët shpresohet të shërohen, porse agjërimi është i rëndë për ta: Në këtë grup hyn gruaja me menstruacione, lehonja, gjdhënësia dhe udhëtari. Personi i tillë i kompenson më vonë ditët e lëna nëse shërohet. E nëse vdes para se të shërohet, bie nga ai obligueshmëria..

Si vërtetohet hyrja e muajit të Ramazanit?

Vërtetohet me shikimin e hënës së Ramazanit ose me plotësimin e tridhjetë ditëve të muajit Shaban.

Gjërat që e prishin agjërimin

1. Ngrënia ose pirja me vetëdije, ndërsa nëse që harron agjërimi është i saktë.
2. Marrëdhëniet intime bashkëshortore. Nëse kjo ndodh ditën gjatë agjërimit obligativ, atëherë është detyrë kefarja (shpagimi): lirimi i një robi e nëse nuk ka, atëherë agjërimi i dy muajve rresht e nëse nuk ka mundësi për këtë, atëherë ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve.
3. Nxjerrja e spermës.
4. Çdo gjë që merr kuptimin e ngrënies dhe pirjes, si: gjilpërat ushqyese, ndërsa gjilpërat jo ushqyese nuk e prishin agjërimin.
5. Nxjerrja e gjakut me anë të hixhames. Ndërsa, dalja e paktë e gjakut në rast analizave e të ngjashme, nuk e prishë agjërimin.
6. Vjellja qëllimisht.
7. Dalja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë.

Disa gjëra që i lejohen agjëruesit

Nga gjërat që i lejohen agjëruesit janë: gëlltitja e pështymës, provimi i ushqimit në rast nevoje (e pastaj e pështynë), larja, përdorimi i misvakut, pafumosja dhe freskimi me ujë (kur është i nxehtë i madh).

Gjërat e pëlqyeshme në agjërim

1. Ngrënia e syfyrit.
2. Vonimi i syfyrit.
3. Shpejtimi i iftarit.
4. Çelja e iftarit me hurma (arabe) të njoma (rutab). Nëse nuk gjen të tilla, atëherë me hurma të thata. Numri i tyre të jetë tek (nuk ka argument për këtë. Sh.p.). Nëse nuk gjen as hurma të thata, atëherë të pi disa gllënjka ujë. E nëse nuk gjen asgjë, atëherë të bëjë nijet me zemrën e tij për çeljen e iftarit.
5. Lutja gjatë agjërimin dhe kur çel iftarin.
6. Shtimi i dhënies së sadakasë (lëmoshës).
7. Falja e namazit të natës.
8. Leximi i Kuranit.
9. Fjala *'inni saiumun – unë jam i agjërueshëm'* kur dikush të ofendon.
10. Kryerja e umrës.
11. Itikafi (qëndrimi në xhami) në dhjetë ditët e fundit.
12. Kërkimi i natës së Kadrin (me vepra të mira).

Gjërat e urryera në agjërim

1. Teprimi në larjen e gojës dhe hundës (gjatë abdesit).
2. Shijimi (provimi) i ushqimit pa qenë kjo e nevojshme.

I ndalohet agjëruesit (por që nuk e prishin agjërimin)

1. Gëlltitja e gëlbazës. Kjo nuk e prishë agjërimin.
2. Puthja, për atë që s'e vetëpërmban dot veten nga prishja e agjërimin.
3. Fjalët e kota dhe veprat e pahijshme.
4. Sjellja e injorancës (si: ngritja e zërit, veprimet e ulëta, polemikat e kota etj.)
5. El-Visal: mos ta prishë agjërimin dy ditë rresht.

Agjërimi vullnetar

1. Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit për atë që e ka plotësuar agjërimin e Ramazanit. Më parësore është që këto të fillojnë nga dita e dytë (pas fitër Bajramit).
2. Agjërimi i ditës së Arafatit për atë që s'është në haxh.
3. Agjërimi i ditës së Ashuras (dita e dhjetë e muajit El-Muharram) duke e shoqëruar me agjërimin e ditës së nëntë dhe të njëmbëdhjetë.
4. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte. Agjërimi i ditës së hënë është më i fortë.
5. Agjërimi i tri ditëve në çdo muaj (arab). Më e mira është agjërimi i ditëve të bardha (13, 14 dhe 15).
6. Agjërimi një ditë po e një ditë jo.
7. Agjërimi i muajit të Allahut el Muharram.
8. Agjërimi i nëntë ditëve të muajit Dhulhixhe.
9. Agjërimi i muajit Shaban, por jo të plotë.

Agjërimi i urryer

Urrehet veçimi me agjërim i ditës së xhuma, ditës së shtunë dhe ditës së diele. Nëse e veçon me shkak, siç është agjërimi i ditës së Arafatit, kjo nuk ka problem.

Agjërimi i ndaluar

1. Veçimi i Rexhebit me agjërim.
2. Agjërimi i ditës së fitër dhe kurban Bajramit.
3. Agjërimi i ditës së dyshimtë. Për atë që e ka traditë agjërimin vazhdimisht, kjo nuk ka problem.
4. Agjërimi i ditëve të teshrikut, përveç atij që nuk gjen kurban.
5. Agjërimi i tërë vitit.

Dispozitat e kompensimit të ditëve të lëna

- Pëlqehet që ditët e lëna pa agjëruar të agjërohen rresht.
- Kërkohet që personi të shpejtojë me agjërimin e ditëve të lëna duke filluar menjëherë pas ditës së festës së fitër Bajramit.
- Nuk lejohet vonimi i kompensimit të ditëve të lëna deri në Ramazanin e ardhshëm.
- Nëse e vonon pa ndonjë arsye, ai nuk ka ndonjë detyrë të agjërojë më shumë sesa ditët që ka lënë, porse ngarkohet me gjynah.

Zekati i fitrit

Zekati i fitrit është detyrë për atë që e zë musliman perëndimi i diellit i ditës së fundit të Ramazanit, qoftë i madh apo i vogël, mashkull apo femër, rob apo njeri i lirë. Sasia që nxirret zekat i fitrit është një *saa* prej ushqimit të personit që posedon më shumë se nevoja e tij. Pëlqehet që të nxirret dhe për foshnjën në barkun e nënës.

Urtësia e ligjësimit të tij:

- Është pastrim për agjëruesin nga fjalët dhe veprat e pahijshme.
- Është ndihmesë për nevojtarët dhe të varfrit që mos të kenë nevojë t'u kërkojnë njerëzve ditën e festës së Bajramit.

Koha e nxjerrjes së zekatit të fitrit

Koha e lejuar:

Një ose dy ditë para ditës së fitër Bajramit.

Koha e pëlqyeshme:

Para namazit të Bajramit dhe pas sabahut.

Koha e ndaluar:

Pas namazit të Bajramit.

Sasia e zekatit të fitrit

Një *saa* prej ushqimit. Nuk lejohet të nxjerrët në vleftë monetare. Një *saa* është e barabartë me dy kg e dyzetë g.

Namazi i Bajramit

Namazi i Bajramit është farz ajn për çdokënd. Ai falet pas ngritjes së diellit një shtizë deri në zeval. Ky namaz nuk falet nëse i kalon koha. Suneti është që të falet në vend të hapur jashtë qytetit. Lejohet falja e tij në xhami.

Suneti është që personi para vajtjes në namazgja të hajë hurma arabe në numër tek, të pastrohet, të parfumohet, të vesh rrobat më të mira dhe të shkojë për faljen e namazit nga një rrugë e të kthehet nga një rrugë tjetër.

Nuk ka problem urimi me rastin e festës me fjalën *“tekabbelAllahu minna ue minkum”*.

Prej sunetit është bërja e tekbirit mutlak (të pakufizuar) natën e festës dhe pas namazeve deri në perëndimin e diellit të ditës së festës. Forma e tij është *“Allahu ekber, Allahu ekber, la ilabe il-lAllab, Allahu ekber, Allahu ekber, ue lilabil-hamd”*.

Ndërsa, forma e namazit të Bajramit është: dy rekate para hutbes, në rekatin e parë pas tekbirit fillestar thuhet gjashtë tekbire, kurse në rekatin e dytë para leximit (të sures El-Fatiha) thuhet pesë tekbire pa llogaritur tekbirin e ngritjes (kijamit).

Pyetje në lidhje me agjërimin

1. Sa është numri i shtyllave të agjërimit? Dy. Tre. Katër.

2. Për kë është detyrë agjërimi?

a).....

b).....

c).....

d).....

3. Çdo i sëmurë ndalohet të agjërojë.

1. E saktë.

2. E gabuar.

4. Përmend gjykimin për secilën nga veprat e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Bëri nijet për agjërimit pas agimit	
Agjërimit pa nijet	
Agjërimit i të voglit	
Agjërimit i udhëtarit	
Agjërimit i gruas lehone	
Agjërimit i të pafuqishmit	
Hëngri duke qenë i agjërueshmë	
Gjilpërat ushqyese për agjëruesin	
Pikat që hidhen në sy	
Gjilpëra analgjezike	
Bërja e hixhames	
Vjellja	
Gëlltitja e pështymës	
Provimi i ushqimit	
Gjumi	
Larja	
Freskimi me ujë	
Përdorimi i misvakut	
Përdorimi i temjanit	
Koha e syfyrit	
Çfarë duhet ngrënë në syfyr?	
Me çfarë çelet iftari?, nëse nuk gjen e çel, nëse nuk gjen as këto, e nëse nuk gjen as këtë
Namazi i teravive	
Kryerja e umrës në Ramazan	

Teprimi në larjen e gojës dhe hundës kur je i agjërueshëm	
Puthja për agjëruesin	
Agjërimi i dy ditëve rresht (pa ngrënë iftar)	
Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit	
Agjërimi i ditës së Arafatit	
Agjërimi i ditës së dyshimtë	
Agjërimi i ditës së Bajramit	
Agjërimi i ditëve të teshrikut	
Agjërimi i muajit el-Muharram	
Agjërimi i muajit Rexheb	
Agjërimi i gjithë vitit	
Agjërimi i ditës së xhuma	
Vonimi i kompensimit deri në Ramazanin tjetër	

E katërta: Haxhi

Haxhi është shtylla e pesë prej shtyllave të Islamit. Ai është detyrë (vaxhib) me këto kushte: Islami, logjika, arritja e moshës së pjekurisë, liria, të ketë mundësi (financiarisht) ta bëjë. Kurse për femrën shtohet një kusht tjetër: të jetë e shoqëruar nga mahremi. **Shtylla e haxhit janë katër:**

Ihrami:

Ai është nijeti për hyrjen në ritualin e haxhit. Pra, ihram nuk është thënia e telbijes dhe as veshja e rrobave të haxhit që janë: izari dhe rida.

Qëndrimi në Arafat:

Kur dielli e kalon kupën e qiellit në ditën e nëntë të muajit Dhulhixhe deri në lindjen e agimit të ditës së Bajramit. Profeti alejhis-selam ka thënë: *“Haxhi është Arafat?”*.

Tavafi

Ifadah:

Bëhet pas qëndrimit në Arafat dhe nuk është tavafi El-Kudum (i ardhjes).

El-

Es-Saji:

Bëhet mes Safës dhe Mervës. I Madhëruari thotë: **“Me të vërtetë Safa dhe Merva janë prej simboleve të Allahut”**.

Llojet e haxhit

El-Ifrad:

Personi të bëjë nijet vetëm kryerjen e haxhit.

El-Kiran:

Personi të bëjë nijet kryerjen e haxhit dhe umrës, e për secilin ritual veprimet i bën të ndara, dhe duhet të therë kurban.

Et-Temetu’:

Është bërja e nijetit për kryerjen e umras në muajt e haxhit. Pasi e përfundon atë, bën nijetin për kryerjen e haxhit, në të njëjtin vit, dhe duhet të therë kurban.

Detyrat e haxhit

Kush lë një vaxhib prej këtyre vaxhibeve, ka për detyrë ta plotësojë këtë me bërjen kurban, që është therja e një deleje në Qabe dhe mishi t'u ndahet banorëve të varfër të Mekës, ndërsa atij nuk i lejohet të hajë prej tij (kurbanit).

Veshja e ihramit te mikatet (vendet e përcaktuara).

Qëndrimi në Arafat deri në perëndimin e diellit për atë që ka qëndruar ditën.

Qëndrimi në Muzdelife.

Qëndrimi në Mina në netët e ditëve të teshrikut.

Gjuajtja e guralecëve.

Rruarja ose shkurtimi i flokëve të kokës.

Tavafi i lamtumirës, përjashto gruan lehone dhe me menstruacione, për atë që dëshiron të largohet nga Meka qoftë edhe pas muajve të haxhit.

Mikatet e haxhit dhe umrës

Kohore

E ato janë muajt e haxhit: Sheval, Dhulkadeh dhe Dhulhixheh. Këto janë posaçërisht për haxhin, kurse umra s'ka ndonjë kohë të caktuar (por kryet në çdo muaj e çdo kohë).

Vendore

- Dhulhulejfe: për banorët e Medines dhe për këdo që kalon pranë tyre.
- El-Xhuhfeh: për banorët e Shamit, Egjiptit dhe Marokut.
- Karnul-Menazil: për banorët e Nexhdit.
- Jelemlen: për banorët e Jemenit.
- Dhatu Irk: për banorët e Irakut.

Gjërat e pëlqyeshme në haxh

Larja për veshjen e ihramit dhe parfumosja.

Veshja e izarit dhe ridasë me ngjyrë të bardhë për burrat.

Prerja e thonjve dhe heqja e qimeve të nevojshme para bërjes së nijet për haxhin.

Bërja e telbijes nga momenti i hyrjes në ritual deri në gjuajtjen e guralecëve të Akabes.

Tavafi El-Kudum (i mbërritjes) për llojin e haxhit El-Mufrad dhe El-Karin.

Ecja me hapa të shpejtë në tri xhirot e para të tavafit të mbërritjes (El-Kudum) dhe tavafit për umra për atë që ka haxhin e llojit Et-Temetu.

Zbulimi i krahut të djathtë në tavafin e mbërritjes (El-Kudum) dhe në tavafin për umra për atë që ka haxhin Et-Temetu.

Bashkimi i namazit të akshamit me të jacisë në kohën e akshamit në Muzdelife në momentin që mbërrin aty.

Qëndrimi në Mina në natën e Arafatit.

Puthja e Gurit të Zi.

Qëndrimi në Muzdelife tek “El-Mesh’arul-Haram” nga agimi deri para perëndimit të diellit. E gjithë Muzdelifeja është vendqëndrim.

Ndalesat e Ihramit (hyrjes në ritual)

Ato janë nëntë: Rruajtja e flokëve të kokës dhe qimeve të trupit, prerja e thonjve, mbulimi i kokës për meshkujt, veshja e gjërave të qepura për meshkujt në formë të tërësishme të trupit, pra ajo që është e ndarë nga trupi apo nga një prej gjymtyrëve, vendosja e nikabit (mbulimi i fytyrës) dhe dorashkave për gruan, parfumosja (në të hynë dhe sapuni aromatik), gjuetia e kafshëve të tokës dhe ndihma për gjuetarin duke i treguar gjahun, lidhja e aktit martesor për veten e tij dhe për të tjerët, marrëdhënia intime, si dhe kënaqja me gruan por pa bërë marrëdhënie. Kush vepron ndonjë prej këtyre ndalesave nga harresa, apo nga padituria, apo detyrohet t'i bëjë, ai nuk ngarkohet me asgjë, përveç nëse vret ndonjë kafshë, në këtë rast ai duhet të japë fidje (shpagim). Ndërsa, gjykimi i bërjes së ndonjërës prej tyre me vetëdije ndahet në katër pjesë:

Ajo që s'ka fidje: është lidhja e aktit martesor për vete apo për dikë tjetër. Po ashtu kënaqja me gruan por pa kryer marrëdhënie, përderisa kjo nuk shoqërohet me daljen e spermës, nuk ka kefare porse personi duhet të pendohet sinqerisht.	Ajo që ka shpagim njëjtë si vepra e kryer: është vrasja e kafshës së tokës dhe ndihma për gjuetarin duke i treguar gjahun. Kush e vret atë, për dënim duhet të therë si kurban në Qabe një kafshë shtëpiake të ngjashme me kafshën e gjuajtur, sipas vlerësimit të njerëzve të drejtë.	Ato vepër e ndaluar shpagimi i së cilës është i rëndë: e ajo është kryerja e marrëdhënieve intime. Ndërsa, kush kryen marrëdhënie para lejimit të parë e ka prishur haxhin e tij. Ai e vazhdon (përfundon haxhin), por duhet ta përsërisë haxhin (kur t'i jepet mundësia përsëri) dhe ka detyrë të bëjë kurban një deve.	Ato gjëra shpagimi i të cilave është i njëjtë me shpagimin e rruarjes së kokës nga ndonjë mundim në kokë: ato janë pjesa e mbetur e ndalesave. Në këtë rast dëmshpërblimi është me të zgjedhur: agjërimin e tri ditëve, ose të ushqyerit e gjashtë nevojtarëve ku secilit prej tyre i takon gjysmë saa, ose bërjen kurban një dele dhe mishi i saj t'u ndahet të varfërve të Qabesë.
---	---	---	---

Emrat e ditëve të haxhit

Dita e Tervijes:	Dita e Arafatit ose dita e qëndrimit:	Dita e Bajramit dhe dita e Kurbanit;	Dita El-Karrij:	Dita En-Neferul-Evvel:	Dita En-Neferu Eth-Thanij:
ajo është dita e tetë, ditë në të cilën transporto hej uji për në Mina.	ajo është dita e 9	ajo është dita e 10	ajo është dita e 11	ajo është dita e 12	ajo është dita e 13

“Lejletu Xhemin – Nata e tubimit” është nata e Festës (së Kurban Bajramit). Është quajtur me këtë emër për shkak të tubimit të njerëzve në të pas qëndrimit në Arafat, ngase banorët e Mekës në kohën paraislame nuk shkonin në Arafat.

Pesë vendet ku bëhen lutjet në haxh

Në Arafat, ditën e nëntë, pasi dielli ka kaluar kupën e qiellit nga ana e perëndimit e deri në perëndim.	Në Muzdelife, ditën e nëntë, pas agimit deri në zverdhjen e diellit.	Pas gjuajtjes së guralecëve ‘El-Xhemratus-Sugra’ dhe ‘El-Usta’ nëditët e teshrikut.	Gjatë kryerjes së tavafit.	Gjatë kryerjes së sajit në Safa dhe Merva dhe gjatë ecjes ndërmjet tyre.
--	--	---	----------------------------	--

Forma e kryerjes së umrës dhe haxhit

Shejh Muhamed bin Salih El-Uthejmini (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë: “Kur të mbërrini te mikatet (vendet e përcaktuara) lahuni dhe parfumohuni në trupat tuaj, në kokë dhe te mjekra, e pastaj vishni ihramin duke bërë nijetin për umra dhe haxhin Et-Temetu’. Nisuni drejt Mekës duke thënë telbijen. Kur të mbërrini në Shtëpinë e Shenjtë (Qabe) kryeni tavafin shtatë xhiro për umrën. Dhe dijeni se e gjithë xhamia është vend për kryerjen e tavafit, si pranë Qabesë ashtu dhe larg saj. Porse, bërja e tavafit pranë saj është më e mirë përderisa nuk lëndohesh apo nuk lëndon të tjerët për shkak të mbipopullimit (ngjeshjes). Nëse ka shumë njerëz, atëherë kryeje tavafin duke qenë më larg Qabesë. Çështja është shumë e lehtë (e kryen tavafin aty ku ndjehesh më mirë) dhe për këtë falënderimet janë për Allahun. Pasi të keni mbaruar tavafin, falni dy rekate pas vendit ‘**Mekamu Ibrahim alejhis-selam**’, qoftë pranë tij, nëse të lehtësohet një gjë e tillë, në të kundërt (kur ka shumë njerëz) fali qoftë dhe larg tij. E rëndësishme është që ‘**Mekamu Ibrahim**’ të jetë mes teje dhe Qabesë.

Më pas dilni dhe shkoni për të kryer *sajin* e umrës duke filluar me Safën. Pasi t’i keni plotësuar shtatë ecjet ndërmjet Safës dhe Mervës, shkurtoni flokët e kokës duke përfshirë të gjithë pjesën e kokës. Nuk pranohet (lejohet) që flokët të shkurtohen vetëm në një anë të kokës. Mos u mashtroni nga ajo që veprojnë shumica e njerëzve. Ditën e tetë të Dhulhixhes lahuni, pafumosuni dhe vishni ihramin duke bërë nijetin nga vendi ku jeni. Shkoni për në Mina dhe falni në të namazin e drekës, të ikindisë, të akshamit, të jacisë dhe të sabahut, të shkurtuar por pa i bashkuar, ngase Profeti juaj sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e shkurtonte namazin në Mina dhe në Meke porse nuk i bashkonte.

Kur të lindë dielli ditën e Arafatit nisuni duke thënë telbijen dhe të përulur ndaj Allahut për në Arafat. Në të (Arafat) bashkoni namazin e drekës me të ikindisë në kohën e drekës duke i falur secilen nga dy rekate, pastaj angazhohuni me lutje dhe përgjërim tek Allahu. Mundohuni që të jeni me abdes, drejtohuni kah kibla edhe nëse mali (Arafatit) është pas jush, sepse legjitime është drejtimi kah kibla. Jeni të vëmendshëm ndaj kufijve të Arafatit dhe shenjave të tij, në mënyrë që të jeni (qëndroni) brenda kufijve të tij, ngase shumë prej hanxhinjve qëndrojnë jashtë kufijve të Arafatit. Kush nuk qëndron në Arafat, ai nuk ka haxh, bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: *“Haxhi është Arafati”*. I gjithë Arafati, lindja dhe perëndimi i tij, jugu dhe veriu i tij, janë vendqëndrim, përveç luginës El-Uadij, bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: *“Unë qëndrova këtu, por i gjithë Arafati është vendqëndrim.”*

Kur të perëndoje dielli dhe të jeni të sigurt në këtë, nisuni për në Muzdelife duke thënë telbijen, të përulur dhe me qetësi sa të mundeni, ashtu siç ju ka urdhëruar për këtë Profeti juaj sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem u largua nga Arafati, tërhoqi frerët e devesë me aq forcë, sa koka e saj preku samarin, ndërsa ai thoshte duke bërë shenjë me dorën e tij: *“O njerëz! Me qetësi, me qetësi!”* Kur të mbërrini në Muzdelife falni në të namazin e akshamit dhe të jacisë dhe qëndroni aty deri në agim. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka lejuar vetëm të dobët të largohen nga Muzdelifeja para agimit. Ai alejhi-selam i lejoi ata të largohen nga fundi i natës. Pasi të falni namazin e sabahut, drejtohuni kah Kibla dhe madhërojeni Allahun, falënderojeni dhe luteni Atë, e pastaj nisuni për në Mina para lindjes së diellit. Merrni shtatë guralecë dhe shkoni te **‘Xhemeratul-Akabe’**, e cila është e fundit (rrugës) për në Meke dhe gjuani në të shtatë guralecët pas lindjes së diellit; për çdo guralec të hedhur thuhet ‘Allahu ekber’ të nënshtruar ndaj Tij dhe duke e madhëruar Atë.

Dijeni se qëllimi me gjuajtjen e guralecëve është madhërimi i Allahut dhe përmendja e Tij. Prandaj, është detyrë që guralecët të bien në gropë dhe nuk është kusht që të goditet shtylla. Pasi të mbaroni hedhjen e guralecëve thorni kurbanin, ndërsa në të lejohet vetëm se ajo (ato kushte) që lejohet edhe për kurbanin.

Nuk ka problem të caktosh dikë që të bëjë therjen për ty. Pastaj, pas bërjes kurban, rruani kokat tuaja. Është detyrë që të rruhet e gjithë pjesa e kokës dhe nuk lejohet të rruhet një pjesë e saj e të lihet pjesa tjetër. Femra i shkurton flokët sa maja e gishtit (jo më shumë). Pas kësaj jeni futur në lejimin e parë. Prandaj, vishuni, prisni thonjtë tuaj, parfumohuni dhe mos iu afroni bashkëshorteve tuaja.

Pastaj zbrisni për në Meke para namazit të drekës, kryeni tavafin dhe sajjin për haxh, pastaj kthehuni për në Mina. Me kryerjen e tavafit, sajit, gjuajtjes së guralecëve dhe rruajtjes së kokës, jeni futur në lejimin e dytë. Dhe me këtë (lejimin e dytë) iu lejohet gjithçka. Madje dhe bashkëshortet tuaja.

O njerëz! Haxhiu ditën e Kurban Bajramit vepron katër gjëra prej ritualit të haxhit: gjuajtjen e guralecëve, pastaj therjen e kurbanit, pastaj rruajtjen e kokës dhe pastaj tavafin dhe sajjin. Kjo është radhitja më e plotë. Por, nëse disa gjëra i bëni para disa të tjerave, p.sh.: rruani kokën para therjes së kurbanit, atëherë kjo s'ka problem.

Nëse e vononi kryerjen e tavafit dhe të sajit derisa të zbrisni nga Minaja, kjo s'përbën problem. E nëse e vononi therjen e kurbanit dhe e thorni në Meke në ditën e trembëdhjetë, kjo përsëri s'ka problem, aq më shumë kur kjo bëhet për shkak të nevojës dhe të ndonjë dobie.

Natën e njëmbëdhjetë e kaloni në Mina. Kur dielli ta kalojë kupën e qiellit shkoni dhe gjuani guralecët në të tri gropat, duke filluar me të parën, pastaj me të mesmen dhe pastaj me të akabes. Në secilën prej tyre hidhen shtatë guralecë dhe në çdo gurë thoni 'Allahu ekber'.

Koha e hedhjes së guralecëve ditën e Kurban Bajramit për atë që ka mundësi është prej lindjes së diellit, ndërsa për të dobëtin është nga fundi i natës, ndërsa afati i fundi i hedhjes së tyre (për të dy kategoritë) është deri në perëndimin e diellit. Ndërsa koha e tij pas festës së Kurban Bajramit është pasi dielli të ketë kaluar kupën e diellit deri në perëndimin e diellit. Nuk lejohet para se dielli të ketë kaluar kupën e qiellit.

Lejohet hedhja e guralecëve natën nëse ditën ka shumë njerëz. Ai që s'ka mundësi t'i gjuajë vetë guralecët, si: i vogli, i moshuari, apo i sëmuri, atëherë i lejohet të ngarkojë dikë që t'i gjuajë guralecët për të. S'ka problem që personi i ngarkuar për hedhjen e guralecëve t'i hedhë nga i njëjti vend (pra, i gjuan te gropa e parë guralecët e tij, pastaj të atij i cili e ka ngarkuar, pastaj shkon te gropa tjetër) për veten e tij dhe për tjetrin. Por, së pari të fillojë me hedhjen e guralecëve të tij.

Pasi t'i keni gjuajtur guralecët në ditën e dymbëdhjetë, haxhi përfundon, ndërsa ju jeni të lirë të zgjidhni: nëse doni, e shpejtoni qëndrimin në Mina e nëse doni, qëndroni në natën e trembëdhjetë dhe i gjuani guralecët në të tri gropat pasi dielli e ka kaluar kupën e qiellit. Kjo është më e mira, sepse kështu ka vepruar Profeti sal-Allah u alejhi ue sel-lem.

Nëse doni të dilni nga Meka, atëherë kryeni tavafin e lamtumirës. Gruaja me menstruacione dhe lehone s'kanë tavaf lamtumirës dhe nuk ligjësohet që ato të vijnë te dera e xhamisë e të qëndrojnë në të.

Pyetje rreth haxhit

1. Për kë është detyrë haxhi?

a).....

b).....

c).....

d).....

e) Për gruan shtohet dhe kushti.....

2. Sa është numri i shtyllave të haxhit? O Dy. O Tre. O Katër.

3. Ihrami është shtyllë prej shtyllave të haxhit dhe ai është veshja e izarit dhe ridasë te vendet e përcaktuara.

1. E saktë.

2. E gabuar.

4. Tafavi Ifada është tjetër nga tavafi E-Zijarah. I pari është shtyllë, kurse i dyti është sunet.

1. E saktë.

2. E gabuar.

5. Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka bërë tri herë haxhin.

1. E saktë.

2. E gabuar.

6. Është detyrë kryerja menjëherë e haxhit.

1. E saktë.

2. E gabuar.

7. Banorët e Medinës e bëjnë nijetin për haxh në Jelmelem.

1. E saktë

2. E gabuar

8. Vendpërcaktim kohorë për umrën është muaji i Ramazanit.

1. E saktë.

2. E gabuar.

9. Plotëso vendet bosh: Haxhi dhe umra herë në jetë. Kush kryen haxhin dhe nuk dhe as, del prej mëkateve si dita që e ka lindur nëna e tij. Haxhi i pranuar nuk ka shpërblim tjetër përveç

10. Banorët e Mekës e bëjnë nijetin për haxh tek Teni'm.
1. E saktë.
2. E gabuar.
11. Gruaja vesh rrobë të bardhë për haxh dhe umra.
1. E saktë
2. E gabuar
12. Pëlqehet për atë që do të veshë ihramin të parfumosem , por të mos e parfumojë
13. Femrës nuk i lejohet të veshë rrobë të qepur.
1. E saktë.
2. E gabuar.
14. Muhrimin nuk i lejohet të vendosë rrip.
1. E saktë.
2. E gabuar.
15. Femra muhrime nuk vesh dhe as
16. Është e pëlqyeshme zbulimi i krahut të djathtë në: O Tavafin e umrës. O Tavafin Kudum (tavafi i mbërritjes). O Tavafi Zijjarah. O E para dhe e dyta. O Të gjitha që u përmendën.
17. Është e pëlqyeshme ecja me nxitim gjatë bërjes së sajit.
1. E saktë.
2. E gabuar.
18. Saji fillon nga dhe përfundon te
19. Hanxhinjtë largohen nga Arafati para akshamit.
1. E saktë.
2. E gabuar.
20. Qëndrimi në Arafat është detyrë prej detyrave të haxhit.
1. E saktë.
2. E gabuar.
21. Veprimet e haxhit fillojnë ditën e dhe vazhdojnë deri në përfundimin e ditës së
22. Nuk ligjësohet ngjitja në malin e Arafatit.
1. E saktë.
2. E gabuar.

23. Hedju është detyrë për atë që kryen haxhin e llojit Temetu dhe El-Karin dhe është sunet për El-Murad-in.

1. E saktë.
2. E gabuar.

24. Thënia e telbijes ndërpritet me gjuajtjen e guralecëve të akabes ditën e Bajramit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

25. Haxhiu ditën e dhjetë i gjuan guralecët tek të tri gropat.

1. E saktë.
2. E gabuar.

26. Gjuajtja e guralecëve fillon ditët e teshrikut pas zevalit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

27. Ligjësohet bërja e lutjes pas gjuajtjes te xhemeratul-akabeh.

1. E saktë.
2. E gabuar.

28. Nëse haxhiu e vonon tavafin Ifada deri në kohën që del prej Mekës, kjo vlen (e zëvendëson) dhe për tavafin e lamtumirës. Tavafi Ifada është si tavafi i umrës, përveç në dhe

29. Personi që kryen haxhin e llojit El-Karin dhe El-Mufrad ka për detyrë të bëjë sajin (Safa-Merva), kurse ai që kryen haxhin e llojit Et-Temetu bën sajin

30. Përmend gjykimin për veprimet e mëposhtme:

Cështje	Gjykimi
Haxhi i fëmijës	
Haxhi i gruas pa mahrem	
Haxhi i atij që ka borxhe	

Mësimi i pesëmbëdhjetë

Stolisja me moralet fetare është detyrë për çdo musliman

Stolisja me moralet fetare është detyrë për çdo musliman. Prej moraleve janë: sinqeriteti në të folur, mbajtja e amanetit, dëlirësia, turpi, trimëria, bujaria, përmbushja e premtimit, largimi nga çdo gjë që Allahu ka ndaluar, fqinjësia e mirë, ndihmesa ndaj nevojtarëve sipas mundësive etj., për të cilat tregon Kurani apo Suneti për ligjshmërinë e tyre.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij “**Es-Sidk**” d.m.th. të jetë i sinqertë me Allahun në fjalët, veprat dhe në besimin e tij. Po ashtu të jetë i sinqertë me robërit e Allahut. E kundërta e sinqeritetit është gënjeshtria.
- Fjala e tij “**El-Emaneh**”: është obligim madhor të cilin njeriu e ka marr përsipër. Kjo është e kundërta e tradhtisë.
- Fjala e tij “**El-Afafu**”: është vetëpërmbajtja (largimi) nga harami.
- Fjala e tij “**El-Hajau**”: është moral që të shtynë për kryerjen e veprave të lavdëruara dhe të largon nga të shëmtuarat.
- Fjala e tij “**Husnul-Xhiuari**”: prej detyrave (në fqinjësi) është ulja e shikimit dhe mos përgjimi (gjurmimi) i të metave të fqinjëve.
- Fjala e tij “**Musaa’detu Dheuil-Haxheh**”, Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Kush ia largon besimtarit një brengë nga brengat e kësaj bote, Allahu do ia largojë atij një brengë nga brengat e ditës së Gjykimit. Kush ia lehtëson atij i cili është në vështirësi, Allahu do t’ia lehtësojë atij në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Kush ia mbulon një të metë muslimanit, Allahu do t’ia mbulojë atij në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër. Allahu është në ndihmë të robit përderisa rob i është në ndihmë të vëllait të vet.”* Shënon Muslimi

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë

Pajisja me edukatën Islame

Pajisja me edukatën Islame, si: dhënia e selamit, buzëqeshja, ngrënia dhe pirja me dorën e djathtë, thënia ‘bismil-lah’ në fillim dhe ‘elhamdulillah’ pasi mbaron (ngrënie ose pirjen), thënia ‘elhamdulillah’ kur teshtinë, thënia ‘jerhamukAllah’ kur teshtinë dikush dhe e falënderon Allahun, vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes për faljen e namazit dhe varrosjen, edukata kur hyn në xhami dhe në shtëpi dhe dalja prej tyre, edukata në udhëtim, me prindërit, me të afërmit, me fqinjët, me të mëdhenjtë dhe të vegjlit, urimi për të porsalindurin, urimi për martesë që Allahu t’u dhurojë begati të sapomartuarve, ngushëllimi në rast fatkeqësie etj. Po ashtu, të tjera prej edukatës islame që lidhen me veshjen e rrobave dhe heqjen e tyre, me veshjen e këpucëve, sandaleve, shapkave dhe nallaneve.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij: “**Es-Selamu**” d.m.th. përshëndetja me selam. Forma më e plotë e tij është ‘*Es-Selamu alejkum ue rahmetullahi ue berakatuhu*’. Përshëndetja me selam atë që njeh dhe atë që s’e njeh. Po ashtu kthimi i selamit atij që të përshëndetë.
- Fjala e tij “**El-Eklu biljemini uesh-Shurbi biha**” është detyrë. Persona ha me tre gishta, ndërsa marrja (e diçkaje) dhe dhënia me dorën e djathtë është e pëlqyeshme.
- Fjala e tij “**Et-Tesmijetu i’ndel-Ibtidai**” d.m.th. thënia ‘bismil-lah’.
- Fjala e tij “**Elhamdulillah i’ndel-Firag**”, nga ajo që transmetohet nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, siç është thënia: “*Elhamdulillah el-ledhi etameni hadha ue razekanibi min gajri haulin minni ue la kuvvetin*”. Ligjësohet që personi të hajë nga ushqimi që ka para dhe mos ta përbuzë ushqimin.
- Fjala e tij “**Elhamdulillah ba’del-Utase**” d.m.th. thënia ‘elhamdulillah’.
- Fjala e tij “**Teshmijtul-Atisi idha hamidallah**” d.m.th. thënia ‘jerhamukAllah’ atij që teshtinë, pastaj ky ta kthejë: ‘jehdikumullah ue juslihu balikum’.

- Fjala e tij “**Ijadetul-merid**” d.m.th. ta vizitojë shpesh herë në kohët e duhura e mos ta zgjasë qëndrimin tek ai dhe t’i japë kurajo që mos ta humbet shpresën në mëshirën e Allahut.
- Fjala e tij “**Uet-tibau’l-xhenaizi lis-salati ued-defn**”¹, vlen për burrat dhe jo për gratë.
- Fjala e tij “**El-Adabush-sherijjetu i’nde dukhulil-mesxhid uel-menzili uel-khuruxhi minhuma**”, të futet me këmbën e djathtë në xhami dhe të thotë ‘*Bismil-lah ues-salatu ues-selam ala rasulilah, Allahumme iftah li ebvabe rahmetike*’ dhe të dalë me këmbën e majtë prej saj duke thënë: ‘*Bismil-lah ues-salatu ues-selam ala rasulilah, Allahumme inni eseluke min fadlike*’. Sa i përket shtëpisë, hyn dhe del me këmbën e djathtë; kur del thotë: ‘*Bismil-lah teuekeltu alallah ue la haule ue la kuvete il-la bil-lah. Allahumme inni endhu bike en edil-lu en udal-le ue ezil-le en uzal-le en edblime eu udhaleme eu exb’hel en juxb’hel alejje*’. Dhe kur hyn thotë: ‘*Allahumme inni eseluke kbajrat-meulixhi ue kbajrat-makbraxhi, bismil-lah uelexhna ue bismil-lah kbaraxhna ue alallahi rabbina teuek-kelna*’¹, pastaj përshëndet me selam familjen e tij.
- Fjala e tij “**Et-Tebriku biz-zeuaxh**”, të thotë: ‘*Barak.Allahu lekuma ue barake alejkuma ue xhemea bejnekkuma fi kbajr*’.
- Fjala e tij “**Et-Ta’zijetu fil-musab**”, duhet të jetë brenda kufijve të tri ditëve dhe mos të shtojë mbi to.

Mësimi i shtatëmbëdhjetë

Paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve

Prej mësimeve të rëndësishme është dhe kujdesi e paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve. Prej tyre: shtatë mëkatet shkatërruese, që janë: shirku, magjia, vrasja e njeriut gjë të cilën Allahu e ka ndaluar përveçse me të drejtë, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, dezertimi nga lufta dhe akuzimi i grave të ndershme besimtare. Gjithashtu: mosrespektimi i prindërve, shkëputja e lidhjeve farefisnore, dëshmia e rrejshme, betimi i rrejshëm, dëmtimi i fqinjit, padrejtësia ndaj njerëzve në gjak, në pasuri dhe në nderë, pirja e alkoolit, kumari, përgojimi, thashethemet etj., prej atyre (veprave) të cilat i ka ndaluar Allahu i lartësuar ose i Dërguari i Tij sal-Allahu alejhi ue sel-lem.

Shënime të rëndësishme

- Fjala e tij “**Esh-Shirku bil-lah**” përfshin shirkun e madh dhe të vogël.
- Fjala e tij “**Es-Sihru**”, prej kësaj është edhe sihri që e bën (e shtyn) njeriun të urrejë dikë ose ta dojë atë. Kush e bën këtë vepër ose është i kënaqur me të, ai ka bërë kufër. Po ashtu ndalohet të shkosh te magjistari apo të hysh në adresat e tyre (te faqjet e internetit), apo të shohësh kanalet televizive që transmetojnë magji dhe të lexosh gazetatat që kanë horoskopin. Magjia nuk zgjidhet me magji. Përkundrazi, ajo zgjidhet me rukje fetare legjitime, me lutje dhe me mjekime të lejuara siç është bërja e hixhames.
- Fjala e tij “**Katlun-nefsi el-leti harramallah**”, qoftë ai musliman, ose muahid, ose dhimmij, ose muste'min.
- Fjala e tij “**il-la bil-hakki**”, janë tri raste: ai që ka vrarë dikë, gruaja e martuar që ka bërë zina dhe ai që dezerton nga feja e tij dhe ndahet nga bashkësia Islame.

- Fjala e tij “**El-Jetim**”, jetim është ai të cilit i ka vdekur babai duke qenë ende pa hyrë në moshën e pjekurisë.
- Fjala e tij “**Et-Teuel-lij jeumez-zahfi**” ka për qëllim ushtrinë që lufton në rrugë të Allahut.
- Fjala e tij “**kadhful-muhsanati**” d.m.th. gratë e lira dhe nuk janë për qëllim të martuarat.
- Fjala e tij “**El-Ejmanul-Kadhibeh**”, po ashtu dhe betimi në dikë tjetër përveç Allahut, siç është betimi në Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ose për nderin, ose për jetën, ose për varret, ose për prindërit, ose për fëmijën etj.
- Fjala e tij “**Lei’bul-Kimar**” është çdo transaksion që sillet rreth humbjes dhe fitores, siç është lotaria.
- Fjala e tij “**El-Gibeh**” të cilën Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka përkufizuar me fjalën e tij: “*Përmendja e vëllait tënd me atë që ai e urren*”.
- Fjala e tij “**En-Nemimeh**” është përcjellja e bisedave midis njerëzve me qëllim për të futur armiqësi ndërmjet tyre.

Gjykimi për garat dhe çmimet

Lejohen garat me shpërblime, siç janë garat me kuaj, me deve dhe gjuajtjen me hark. Bazuar në fjalën e Profetit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “*Nuk lejohet garimi (me shpërblim/bast) përveçse në garat me deve, me kuaj dhe gjuajtjen me hark*”.

Garat (në lojërat) që janë absolutisht të ndaluara, siç është loja me tavull, loja me shah, e të ngjashme me to.

Lejohen garat pa shpërblim/bast dhe nuk lejohen me shpërblim/bast: janë të gjitha garat përveç atyre që përmendëm më sipër.

Mësimi i tetëmbëdhjetë

Përgatitja e të vdekurit, falja e namazit të xhenazes dhe varrimi i tij

Sqarimi i kësaj është si më poshtë:

E para: Ligjësohet që personit i cili është në momentet e fundit t'i përkujtohet fjala 'La ilahe il-Allah', bazuar në fjalën e Profetit sal-Allah u alejhi ue sel-lem: "*Ua përkujtoni të vdekurve tuaj fjalën 'La ilahe il-Allah'*". Me fjalën 'el-meuta' e ardhur në hadit, janë për qëllim ata që janë në prag të vdekjes, atyre që u janë shfaqur shenjat e vdekjes.

E dyta: Pasi sigurohesh për vdekjen e tij, atij i mbyllet sytë dhe mjekra i lidhet me kokën që mos t'i depërtojë diçka në fyt dhe që mos t'i shtrembërohet fytyra; ky veprim ndaj të vdekurit ka ardhur në Sunet.

E treta: Është detyrë larja e të vdekurit musliman, përveç dëshmorit (shehidit) që ka vdekur në fushëbetejë, ngase ai nuk lahet dhe nuk i falet namazi i xhenazes, por varroset me rrobat e tij. Profeti sal-Allah u alejhi ue sel-lem nuk i lau të vranët e betejës së Uhudit dhe nuk ua fali namazin e xhenazes.

E katërta: Forma e larjes së të vdekurit: i mbulohen pjesët e turpshme të tij (auretit), pastaj ngrihet pak dhe i shtypet barku lehtë, pastaj personi që do ta lajë e mbështjell dorën e tij me një rrobë apo diçka të ngjashme me të dhe e lan (pastron) me ujë duke i dhënë abdes ashtu siç merret për namaz, pastaj ia lanë kokën dhe mjekrën me ujë dhe sidër, ose me diçka të ngjashme me të, pastaj ia lanë anën e djathtë e pastaj anën e majtë. Kështu e lanë dhe herën e dytë dhe të tretë. Për çdo herë, dorën e tij e kalon sipër barkut të të vdekurit, në mënyrë që nëse del diçka prej barkut, ta lajë atë. Para dhe mbrapa organeve të tij, le të vendosë pambuk ose diçka tjetër. Nëse nuk mbyllet me vendosjen e tyre, atëherë me mjete të mjekësisë bashkëkohore, si: leukoplast (ngjitës) dhe të ngjashëm me të, dhe ia përsëritë abdesin.

Nëse nuk pastrohet me tri herë, atëherë shton duke e larë pesë ose shtatë herë. Pastaj e fshinë me rrobë dhe i vendos parfum në vendet që kanë më së shumti nevojë (te sqetullat dhe në brendësinë e kofshëve) dhe në gjymtyrët me të cilat binte në sexhde. Nëse e parfumosë të gjithin, kjo është më e mira. Qefinin e tij e tymos me temjan dhe ia shkurton mustaqet dhe thonjtë nëse i ka të gjatë. E nëse ia lë, s'ka problem. Flokët nuk i krihen, nuk i hiqen (pastrohen) qimet nën sqetulla dhe rreth organit dhe nuk bëhet synet, sepse nuk ka argument për diçka të tillë. Gruas i ndahen flokët në tri gërsheta dhe i lëshon nga pas (trupit).

E pesta: Qefinosja e të vdekurit; më e mira është që burri të qefinoset me tri rroba të bardha duke mos pasur këmishë apo çallmë, ashtu siç u veprua dhe me Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të cilin e mbuluan me tri pëlhura. Nëse qefinoset me këmishë, izar dhe fasho, kjo s'përbën asnjë problem. Ndërsa, gruaja qefinoset me pesë rroba: mbulesë për trupin, mbulesë për kokën, izar dhe dy fasho. Fëmija mashkull qefinoset me një deri në tre rroba, ndërsa fëmija femër me këmishë dhe dy fasho. Detyrë është që të gjithë të mbulohen me një rrobe e cila e mbulon të gjithë të vdekurin. Nëse i vdekuri është muhrim (haxhi apo umraxhi) lahet me ujë dhe sidër, qefinoset me rrobën e tij (izarin dhe ridain) ose me diçka tjetër. Nuk i mbulohet koka e fytyra dhe nuk parfumoset, sepse ai do të ringjallet ditën e Kiametit duke thënë telbijen, siç saktësohet kjo prej hadithit profetik. Nëse muhrimi është grua, ajo qefinoset si gratë e tjera, porse nuk parfumoset, nuk i mbulohet fytyra me nikab, nuk i mbulohen duart me dorashka, porse i mbulohet fytyra dhe duart me rrobën e qefinit, siç e kemi sqaruar më herët këtë në formën e qefinosjes së gruas.

E gjashta: Njeriu që më së shumti ka të drejtë ta lajë të vdekurin, t'ia falë namazin e xhenazes dhe ta varrosë atë, është ai për të cilin ka lënë porosi i vdekuri (që ta bëjë këtë), pastaj babai, pastaj gjyshi, pastaj më i afërmi i tij nga trashëgimtarët. Kjo për sa i përket burrit. Ndërsa, për gruan më shumë të drejtë ka ajo për të cilën e vdekura ka lënë porosi, pastaj nëna, pastaj gjyshja dhe pastaj më e afërmja tek ajo prej grave.

U lejohet bashkëshortëve që ta lajnë njëri-tjetrin, sepse Es-Siddiku (Ebu Bekri) radijAllahu anhu lau bashkëshorten e tij e gjithashtu dhe Aliu radijAllahu anhu lau bashkëshorten e tij, Fatimen radijAllahu anha.

E shtata: Forma e namazit të xhenazes: merren katër tekbiere, pas tekbitit të parë lexohet surja El-Fatiha, por nëse bashkë me të lexohet një sure e shkurtër, ose një apo dy ajete, kjo është gjë e mirë, bazuar në hadithin autentik që transmetohet në lidhje me këtë nga Ibën Abasi radijAllahu anhumu. Pastaj thuhet tekbi i dytë dhe dërgohen salavate për Profetin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, në atë formë siç thuhet në teshehud. Pastaj thuhet tekbi i tretë dhe bëhet lutje *“Allabumme gfir libajjina ue mejjitina ue shahidina ua gaibina ue sagirina ue kebirina ue dbeckerina ue unthana. Allabumme men abjejtehu minna feahjibi alal-islam ue men teueffejtehu minna fetueeffebu alal-ijman. Allabumme gfir lebu uerbambu ue afibi ua’fu anhu ue ekrim nuzulehu ue uessi’ mudkhabebu uegsilbu bil-mai ueth-thelxhi uel-berad ue nekkibi minel-khataja kema junekki eth-theubel-ebjedu mined-denes ue ebdilbu daran khajran min darihi ue ehlen khajran min eblibi ue edkhibul-xhenneh ue ei’dh’hu min adhabil-kabr ue adhabin-nar uefsab lebu fi kabrihi ue nuvvir lebu fibi. Allabumme la tahrinna exrabu ue la tudil-lena ba’dehu”*. Pastaj merr tekbitin e katër dhe jep vetëm një selam nga ana e djathtë. Pëlqehet që duart të ngrihen për çdo tekbit. Nëse i vdekuri është grua thuhet: *“Allabumme gfir leha...”* Nëse janë dy të vdekur thuhet: *“Allabumme gfir lehuma...”* Nëse janë më shumë se dy xhenaze thuhet: *“Allabumme gfir lehum...”* Nëse i vdekuri është fëmijë, atëherë në vend të lutjes për kërkimin e faljes, për të thuhet: *“Allabumme ixhalbu feratan ue dbukebran li ualidejbi ue shefian muxhaban. Allabumme thekkil bibi menazinehuma ue eadhime bibi uxhurahuma ue elhiku bi salibin selefil-mu’minin ue xhealhu fi kefaleti Ibrahim alejhis-salatu ues-selam uekibi birahmetike adhabel-xhehim”*. Suneti është që imami të qëndrojë në drejtëm të kokës së burrit, ndërsa kur i vdekuri është grua, ai qëndron në mes të saj. E nëse janë shumë xhenaze, atëherë burri i vdekur (xhenazja e tij) duhet të jetë para imamit, ndërsa gruaja e vdekur (xhenazja e saj) të qëndrojë në anën e kibles.

Nëse në mesin e tyre ka ndonjë fëmijë të vogël (djalë), ai vendoset para gruas, pastaj gruaja dhe pastaj fëmija vajzë. Koka e fëmijës vendoset në drejtim të kokës së burrit dhe në mes të trupit të gruas. Po kështu edhe vajza e vogël, koka e saj vendoset në drejtim të kokës së gruas e ndërsa mesi i saj në drejtim të kokës së burrit. Kurse, të gjithë njerëzit (xhemati) qëndrojnë pas imamit, përveç rastit kur ndonjëri nuk gjen vend, atëherë ai qëndron nga e djathta e imamit.

E teta: Forma e varrosjes: legjitime është që varri të hapet thellë deri në mesin e burrit. Brenda tij të hapet lahdë në anën e kibles dhe i vdekuri të vendoset në të (lahd) në krahun e djathtë. Zgjidhet nyja e qefinit, nuk i hiqet, por lihet ashtu, dhe nuk i zbulohet fytyra, qoftë i vdekuri burrë apo grua. Pastaj vendosen mbi të plithar/qerpiçë derisa të zërë vend mirë dhe ta mbajë dheun. Nëse nuk gjenden plithar, le të mbyllet me diçka tjetër, si: pllaka, gurë apo dërrasë, që ta mbajë baltën. Pastaj hidhet mbi të dhe', pëlqehet të thuhet 'bismil-lah ue ala mil-leti rasulilah'. Varri ngrihet një pëllëmbë nga toka dhe mbi të vendosen gurë të vegjël nëse është e mundshme, dhe spërkatet me ujë. Ligjësohet për shoqëruesit e xhenazes që të qëndrojnë te varri dhe të luten për të vdekurin, sepse Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kur mbaronte varrimin qëndronte tek ai dhe thoshte: *“Kërkoni falje për vëllain tuaj dhe lutuni për të që Allahu ta forcojë, ngase ai tani po pyetet!”*

E nënta: Lejohet për atë që s'e ka falur namazin e xhenazes që ta falë pas varrimit, ngase Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kështu ka vepruar. Porse, kjo të jetë brenda kufijve të një muaji ose më pak. Nëse koha që prej varrimit është më e gjatë se kaq, nuk ligjësohet që personi ta falë namazin e xhenazes te varri i të vdekurit, sepse nuk është përcjellë nga Profeti sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ai është falur te varri pasi ka kaluar një muaj nga varrimi i të vdekurit.

E dhjeta: Nuk lejohet për familjen e të vdekurit që të përgatisin ushqim për njerëzit, bazuar në fjalën e Xherir bin Abdullah El-Bexhelijji, sahabi i nderuar, radijAllahu anhu: *“Ne e konsideronim vajtim (en-nijahah) tubimin (mbledhjen) te familja e të vdekurit dhe përgatitjen e ushqimit”*.

Ndërsa, të përgatisin ushqim për vete apo për mysafirët e tyre, kjo s'ka problem. Të afërmeve dhe fqinjëve u lejohet që të përgatisin ushqim për ta, ngase Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem, kur i erdhi lajmi për vdekjen e Xhaferr bin Ebi Talib në Sham, e urdhëroi familjen e vet që të përgatisin ushqim për familjen e Xhaferrit dhe tha: *“Atyre u ka ardhur (u ka rënë) diçka preokupuese.”* S'ka problem që familja e të vdekurit të ftojë fqinjët e tyre apo të tjerët për të ngrënë nga ushqimi që u është dhuruar atyre. Me sa e dimë, një gjë e tillë s'ka një kohë të përcaktuar në legjislacionin Islam.

E njëmbëdhjeta: Nuk i lejohet gruas të mbajë zi për të vdekurin më shumë se tri ditë, me përjashtim për bashkëshortin e saj, për të cilin mban zi katër muaj e dhjetë ditë, përveç rastit kur është shtatzënë atëherë ajo mban zi derisa të lindë, sepse kjo saktësohet në sunetin e saktë nga Profeti sal-IAllahu alejhi ue sel-lem. Kurse, burrit nuk i lejohet të mbajë zi për askënd për të afërmit e tij apo për të tjerët.

E dymbëdhjeta: I lejohet burrave që herë pas herë t'i vizitojnë varrezat dhe të bëjnë lutje për të vdekurit, që Allahut t'i mëshirojë, dhe të përkujojnë vdekjen dhe atë që vjen pas saj, bazuar në fjalën e Profetit sal-IAllahu alejhi ue sel-lem: *“Vizitoni varret, sepse ato ua përkujojnë botën tjetër!”* Ai sal-IAllahu alejhi ue sel-lem i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varrezat të thonë: *“Es-Selamu alejkum ehled-dijari minel-mu'minine uel-muslimine ue inna in sha Allah bikum labikum nes'elullabe lena ue lekumul-afijeh jerhamullahi el-mustekdimine minna uel-muste'khairine”*. Ndërsa, gratë nuk i vizitojnë varrezat, sepse i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Mallkuar qofshin vizitueset e varreve!”*, ngase nga vizita e tyre ekziston frika e rënies në fitne dhe nuk janë të durueshme. Po ashtu, nuk u lejohet atyre të përcjellin xhenazen deri te varrezat, sepse i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ue sel-lem i ka ndaluar ato nga ky veprim. Falja e namazit të xhenazes në xhami apo në namazgia është vepër legjitime për burrat dhe për gratë. Ky është i fundi i asaj që mu mundësua të mbledh. Salavatet dhe selamet e Allahut qofshin për Profetin tonë Muhamedin, për familjen e tij dhe shokët e tij!

**Vizita e varreve
ndahet në:**

Vizitë e lejuar: kur personi ka qëllim me të përkujtimin e botës tjetër dhe të lutet për të vdekurit me atë që transmetohet nga Profeti sal-Allahu alejhi ue sel-lem dhe mosveprimi i diçkaje që bie ndesh me legjislacionin Islam.

Vizitë që është bidat: kur personi ka qëllim që t'i lutet Allahut te varret.

Vizitë që është shirk: kur personi ka qëllim që t'i lutet të vdekurit.

Pyetje rreth temave të mësipërmeve

1. Ruajtja e rendit dhe edukata fetare janë prej moraleve të muslimanit.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
2. Feja ime më urdhëron të shoqërohem me të këqijtë dhe të largohem nga njerëzit e mirë.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
3. Islami na ka mësuar që të sillemi mirë me shërbyesin, hamallin dhe të tjerët.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
4. Shoqërohem me atë që i dëmton të tjerët me gjuhën dhe dorën e tij.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
5. Nëse më shan dikush unë ia kthej dhe me këtë duke ndjerë kënaqësi në këtë
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
6. Islami më ka mësuar që t'i ndihmojë nevojtarët dhe të dobëtit.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
7. E drejta e muslimanit ndaj muslimanit është vizita kur sëmuret dhe lutja për të për shërim.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
8. Gjurmimi i të fshehtave të fqinjëve është prej cilësive të besimtarëve.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
9. Njerëzit më të dashur tek Allahu janë atë që janë më të dobishëm për njerëzit.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.
10. Lutja e daljes nga shtëpia është: *'Bismil-lah uelexbna ue bismil-lah kbaraxbna ue ala rabbina teuekkelna'*.
 1. E saktë.
 2. E gabuar.

11. Atij që teshtinë i thuhet: *'Jehdikumullah ue juslibu balekum'*.

1. E saktë.
2. E gabuar.

12. Dhikri e ruan muslimanin dhe e afron tek Allahu i Lartësuar.

1. E saktë.
2. E gabuar.

13. Cila është shenja e dashurisë karshi vëllait musliman?

.....

14. Prej gjërave që tregon për pakësimin e besimit është zilia ndaj vëllait musliman.

1. E saktë.
2. E gabuar.

15. Cilat janë shkaqet që sjellin (shkaktojnë) dashurinë?

.....

16. Urrehet t'i fryhet ushqimit dhe ujit.

1. E saktë.
2. E gabuar.

17. Pëlqehet lëpirja e gishtave pasi mbaron ngrënien para larjes së tyre.

1. E saktë.
2. E gabuar.

18. Mesatarja në ngrënie, veshje dhe zbukurim është rruga e kërkuar.

1. E saktë.
2. E gabuar.

19. Njeriu që ka më shumë të drejtë ta lajë të vdekurin, t'ia falë namazin dhe ta varrosë është, pastaj, pastaj....., pastaj

20. Shlyerja e borxhit të të vdekurit është: Detyrë. Sunet. E lejuar.

21. Gjykimi për varrosjen e të vdekurit është: Sunet. Detyrë. Farz kifaje.

22. Gjykimi thënien e telkinit të vdekurit (në momentet e vdekjes) është: Detyrë. Sunet. E ndaluar.

23. Prania e personave në larjen e të vdekurit e të cilët nuk ndihmojnë është: E ndaluar. E lejuar. E urryer.

24. Nyjat e qefinit zgjidhen atëherë kur i vdekuri futet në varr.

1. E saktë.

2. E gabuar.

25. Bashkëshortët nuk lajnë njëri-tjetrin, sepse akti i martesës ndërpritet (shfuqizohet) me vdekjen.

1. E saktë

2. E gabuar

26. Burri dhe gruaja lahen nga ai

27. Kush s'e arrin dot namazin e xhenazes, e fal brenda kufirit të

28. Vajtimi për të vdekurin është absolutisht gjë e lejueshme.

1. E saktë.

2. E gabuar.

29. I vdekuri vendoset në lahdin e tij i drejtuar kah kibla.

1. E saktë.

2. E gabuar.

Përmbajtja

Shpjegimi i parathënies

Shpjegimi i mësimt të parë: Surja El-Fatiha dhe suret e shkurta

Fragmente nga “Tejsiru El-Kerim Er-Rrahman”

Pyetje rreth parathënies së librit dhe tefsirit

Shpjegimi i mësimt të dytë: Shtyllat e Islamit

Shpjegimi i mësimt të tretë: Shtyllat e Besimit

Shpjegimi i mësimt të katërt: Ndarja e teuhidit dhe shirkut

Shpjegimi i mësimt të pestë: Ihsani

Pyetje rreth teuhidit

Shpjegimi i mësimt të gjashtë: Kushtet e namazit

Shpjegimi i mësimt të shtatë: Shtyllat e namazit

Shpjegimi i mësimt të tetë: Vaxhibet e namazit

Shpjegimi i mësimt të nëntë: Sqarimi i teshehudit

Shpjegimi i mësimt të dhjetë

Shpjegimi i mësimt të njëmbëdhjetë: Sunetet e namazit

Dispozitat e sexhdes së harresës

Përmbledhja e formës së namazit e shoqëruar me foto

Përmbledhje rreth namazit dhe dispozitave të tij

Pyetje rreth namazit

Shpjegimi i mësimt të dymbëdhjetë: Kushtet e abdesit

Shpjegimi i mësimt të trembëdhjetë: Farzet e abdesit

Shpjegimi i mësimt të katërbëdhjetë: Gjërat që e prishin abdesin

Përmbledhje e formës së abdesit me anë të fotove

Gjëra që kanë të bëjnë me pastërtinë

Pyetje rreth pastërtisë/abdesit

Zekati

Pyetje rreth zekatit

Agjërimi

Pyetje rreth agjërimit

Haxhi dhe Umra

Pyetje rreth haxhit

Shpjegimi i mësimt të pesëmbëdhjetë: Stolisja me moralet fetare

Shpjegimi i mësimt të gjashtëmbëdhjetë: Pajisja me edukatën Islame

Shpjegimi i mësimt të shtatëmbëdhjetë: Paralajmërimi nga shirku dhe llojet e mëkateve

Shpjegimi i mësimt të tetëmbëdhjetë: Përgatitja e të vdekurit

Pyetje rreth edukatës dhe xhenazes